

koncesionet  
**ppp**

Manual për përdoruesit

Termet e përdorimit të këtij materiali

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) është një institucion shtetëror që ka si mision të nxisë dhe asistojë Autoritetet Kontraktore në shqyrtimin e vlerësimit të projekteve koncesionare /partneriteteve publike private, si propozime të kërkuara ose të pakërkuara; hartimin e kërkesës për propozim, dokumenteve të garës, si dhe vijon me procedurën për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private. Për më tepër informacion mbi ATRAKO ju lutem vizitoni faqen ueb [www.atrako.gov.al](http://www.atrako.gov.al).

Ky material është përgatitur për të ndihmuar përdoruesit për zbatimin e procedurave të koncesioneve dhe partneritetit publik privat gjithashtu për të garantuar zbatimin e praktikave me të mira evropiane të koncesioneve dhe PPP-ve në Shqipëri.

Kërkimet, analizat, interpretimet dhe konkluzionet në përmbajtje të këtij materiali, jo domosdoshmërisht reflektojnë këndvështrimin dhe politikën e ATRAKO apo Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Përdorimi i këtij materiali është plotësisht përgjegjësi e përdoruesit dhe ATRAKO nuk ka asnjë përgjegjësi.

Për përgatitjen e këtij materiali punoi grupi i përbashkët i punës me përfaqësues nga :

ATRAKO

Rovena Beqiraj, Gazmir Vehbi

HM&M

Andi Memi, Eljon Shkodrani

# koncesionet ppp



Agjencia e Trajtimit të  
Koncesioneve/PPP

HM&H



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

GIZ is not responsible for the content

## TABELA E PËRMBAJTJES

**Kapitulli 1. Hyrje: qëllimi i manualit dhe metodologjia e përdorur**

- a) qëllimi i manualit
- b) metodologjia e përdorur

**Kapitulli 2. Kuadri ligjor dhe institucional i partneriteteve publike private**

- a) kuadri ligjor mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat
- b) kuadri institucional: roli dhe përgjegjësitë e organeve shtetërore

**Kapitulli 3. Analizë krahasuese e koncesioneve dhe ppp**

- a) koncesionet
- b) format e tjera të partneriteteve publike private
- c) aspekte të përbashkëta të koncesioneve dhe ppp
- d) sektorët ekonomikë dhe socialë të koncesioneve/ppp
- e) rastet përjashtimore të koncesioneve/ppp

**Kapitulli 4. Arsyet për zbatimin e koncesioneve dhe/ose ppp**

- a) fondet e pamjaftueshme
- b) mungesa e planifikimit
- c) menaxhimi i dobët dhe mirëmbajtja e papërshtatshme

**Kapitulli 5. Parimet dhe procedurat administrative**

- a) parimet e përgjithshme
- b) procedurat ligjore

**Kapitulli 6. Identifikimi i projekteve**

- a) subjektet propozues
- b) propozimet e identifikuara nga dokumentet e planifikimit apo studimet

**Kapitulli 7. Vlerësimi i projekteve**

- a) ngritja e komisionit të koncesionit/ppp
- b) procedurat e vlerësimit të propozimeve nga komisioni

**Kapitulli 8. Propozimet e pakërkuara të koncesioneve/ppp**

- a) paraqitja e propozimeve të pakërkuara
- b) procedura e vlerësimit të propozimeve të pakërkuara

**Kapitulli 9. Projektet që kërkojnë mbështetje financiare**

- a) miratimi paraprak i ministrisë së financave
- b) procedura e vlerësimit të kërkesave
- c) afatet për vlerësimin e kërkesave
- d) vendimet e ministrisë së financave

**Kapitulli 10. Procedurat konkurruese për partneritetet publike dhe private**

- a) procedurat e tenderit
- b) dokumentet e tenderit
- c) vlerësimi i ofertave

**Kapitulli 11. Veprimet e nevosjhme përpara lidhjes së kontratës**

- a) garancia e kontratës
- b) subjekti për qëllime të veçanta (spv)
- c) negocimi dhe lidhja e kontratës së koncesionit/ppp

**Kapitulli 12. Përbajtja e kontratës së koncesionit/ppp**

- a) hartimi i kontratës
- b) përbajtja e kontratës
- c) kontrata të tjera të lidhur me kontratën e ppp

**Kapitulli 13. Zbatimi i kontratës së ppp**

**Kapitulli 14. Vlerësimi i rezultateve të kontratës pas përfundimit të saj**

Aneksi 1: Model kontrate koncesioni/PPP

Aneksi 2: Model i Studimit të fizibilitetit

Aneksi 3: Udhëzimet për hartimin e Raportit Përmbledhës dhe të Studimit të Fizibilitetit

Aneksi 4: Lista e Shkurtimeve



## KAPITULLI 1

## HYRJE: QËLLIMI I MANUALIT DHE METODOLOGJIA E PËRDORUR

## a) Qëllimi i manualit

Ky manual udhëzues mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat në Republikën e Shqipërisë, synon të jetë një dokument informues, i cili lehtëson përjasjen e organeve shtetërore dhe të sipërmarrësve privatë të cilët angazhohen në procedurat e koncesioneve dhe të partneritetit publik privat (PPP). Për këtë qëllim, ky manual përpiket të ofrojë një analizë të detajuar të proceseve përbërës dhe të aspekteve të lidhura me koncesionet dhe PPP, si edhe udhëzimet e nevojshme për vlerësimin dhe vendimmarrjen në lidhje me zbatimin e formave të ndryshme të partneritetit publik privat. Gjithashtu manuali përshkruan hapat procedurale të nevojshëm për vlerësimin e projekteve, hartimin e kontratave përkatëse si edhe përgjatë fazës së zbatimit të kontratave, përfshirë monitorimin dhe rishikimin e tyre.

Ky manual është bazuar kryesisht në legjislacionin ekzistues shqiptar mbi koncesionet dhe PPP, si edhe në legjislacionin për prokurimet publike, dispozitat e të cilit ndikojnë edhe përgjatë zhvillimit të procedurave konkurruese për dhënien e koncesioneve dhe PPP. Analiza e ofruar nga ky manual bazohet dhe përfshin pashmangshmërisht edhe dispozita të tjera të legjislacionit të përgjithshëm shqiptar, të cilat janë të lidhura me procedurat e PPP, veprimtarinë e organeve publike si edhe me aktivitetin tregtar të sipërmarrësve privatë.

Për të patur një rezultat sa më të mirë të këtij dokumenti, është analizuar edhe legjislacioni i Bashkimit European, dokumente udhëzues të përdorur nga organizmat ndërkombëtarë, si dhe janë përdorur disa modele dhe praktika pozitive të zbatuara në vendet e zhvilluara në fushën e PPP.

Së fundmi, në mënyrë që ky dokument të mos rezultojë thjesht në një analizë të ngurtë të legjislacionit ekzistues, janë marrë dhe përdorur edhe mendimet dhe eksperiencia e organeve ligj zbatuese në Republikën e Shqipërisë. Kjo përfshin në veçanti opinionet e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), si dhe ankesat, vërejtjet dhe paqartësitë e shprehura prej disa prej sipërmarrësve privatë të cilët kanë patur eksperiencia të mëparshme, duke qenë të përfshirë në procedura Koncesionare dhe PPP.

Për pasojë, përveç analizës së procedurave dhe të kuadrit ligjor, ky manual përfshin gjithashtu edhe elementë ndihmues për interpretimin e situatave të caktuara përgjatë, zhvillimit të procedurave të PPP.



## Metodologjia e përdorur

Metodologjia e përdorur në këtë manual bazohet mbi një analizë të detajuar të kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e koncesioneve dhe PPP, duke identifikuar organet kompetente, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e partnerit publik dhe privat. Manuali ofron edhe një përshkrim krahasues të dy koncepteve “Koncesion” dhe “PPP”, duke evidentuar rastet kur ato aplikohen nga organet publike, sëbashku me informacionin mbi dispozitat në lidhje me qëllimin e koncesioneve dhe PPP, përfshirë përcaktimet e sektorëve ekonomikë dhe sociale, llojet e kontratave dhe arsyet për përzgjedhjen e tyre.

Në vijim, manuali kryen një analizë dhe një përshkrim të gjithë procesit dhe procedurave që lidhen me dhënien e koncesioneve dhe PPP, duke filluar që nga identifikimi i projektit dhe duke vijuar me vlerësimin, përgatitjen dhe zbatimin e veprimeve të nevojshme të procedurës konkurruese, hartimin dhe lidhjen e kontratave si edhe menaxhimin dhe monitorimin e tyre deri në finalizimin me sukses të projekteve.

Në formën e shtojcave, i janë bashkëlidhur këtij manuali edhe një model kontrate Koncesioni dhe PPP, udhëzimet për hartimin e dokumenteve të fazës së vlerësimit, Raportit Përmbledhës dhe të Studimit të Fizibilitetit si edhe një model i Studimit të Fizibilitetit, të cilat këshillohet të përdoren nga ana e autoriteteve kontraktuese (më tej referuar si “AK”) përgjatë procedurave të dhënies së Koncesioneve dhe PPP.

Përkufizimet, terminologjia dhe emërtimet dhe shkurtime të përdorur në këtë manual, janë të njëjtë me ato të përcaktuara në legjislacionin për koncesionet dhe PPP. Një listë e shkurtimeve të përdoruara i është bashkëlidhur si shtojcë këtij Manuali.

## KAPITULLI 2

## KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL I PARTNERITETEVE PUBLIKE PRIVATE

## a) Kuadri ligjor mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat

Kuadri ligjor i koncesioneve dhe PPP në Republikën e Shqipërisë mbështetet kryesisht në legjislacionin e mëposhtëm:

- Ligji nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, i ndryshuar (më tej referuar si Ligji 125/2013);
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat”, i ndryshuar (më tej referuar si VKM 575);
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 130, datë 12.03.2014 “Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të Koncesionit/Partneritetit Publik Privat”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 634 datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 211, datë 16.3.2016, “Për krijimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të koncesionit/partneritetit publik privat”:

Në datën e sotme, vijojnë të mbeten në fuqi, sipas përcaktimeve ligjore edhe aktet e mëposhtme:

- Ligji nr. 9663 datë 18.12.2006, “Për koncesionet”, i ndryshuar<sup>1</sup>;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150 datë 22.3.2007 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)”, i ndryshuar:

Ndërkohë që në fazën e prokurimit publik, procedurat bazohen sipas përcaktimeve ligjore, edhe në legjislacionin e prokurimit publik, si më poshtë:

- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

<sup>1</sup> Neni 48 i ligjit nr 125/2013 “Për koncesionet dhe PPP” shfuqizon ligjin 9663 dhe ne dispozitat kalimtare citon: “Dispozitat e ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, zbatohen për procedurat e dhënies së kontratave të koncesionit dhe për procedurat e shqyrtimit të filluara, si dhe kontratat e lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 918, datë 29.12.2014, “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”.

Këto akte ligjore dhe nënligjore mund të aksesohen lehtësisht në faqet zyrtare të institucioneve ligjzbatuese, në veçanti të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve [www.atrako.gov.al](http://www.atrako.gov.al) dhe të Agjencisë së Prokurimit Publik <https://app.gov.al>.

Përveç kuadrit ligjor të mësipërm, janë të zbatueshme dhe i është bërë referim, edhe legjislacionit shqiptar në fuqi i cili rregullon veprimtarinë e administratës publike (në veçanti Kodi i Procedurave Administrative) dhe legjislacionit që rregullon marrëdhëniet kontraktore midis palëve (në veçanti Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë).

Legjislacioni mbi koncesionet dhe PPP, zbatohet së pari nga autoritetet kontraktuese, të cilat konsiderohen ato organe të cilave legjislacioni u jep kompetencën për të ndërmarrë dhe zbatuar procedura për dhënien e koncesioneve dhe partneriteteve publike private.

Në bazë të kuadrit ligjor ekzistues, autoritete kontraktuese konsiderohen ministritë e kinjës të qeverisjes qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Aktualisht, kabineti qeveritar i Këshillit të Ministrave përbëhet nga 19 ministri të linjës.

Bazuar në reformën administrative dhe territoriale të zbatuar së fundmi, në veçanti nëpërmjet Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, njësitë e qeverisjes vendore janë bashkitë (aktualisht 61 të tilla) dhe qarqet (aktualisht 12 të tilla).

Pra ministritë, bashkitë dhe qarqet janë organet e identifikuara nga legjislacioni si autoritete kontraktuese të cilat mund të ndërmarrin procedurat për realizimin e koncesioneve dhe partneriteteve publik privat.

Në rastet kur sipas përcaktimeve të legjislacionit, objektit të kontratës dhe kompetencave specifike, kompetenca për një projekt koncesioni apo PPP, mund ti përkasë më shumë se një organi publik i cili plotëson kushtet për të qenë autoritet kontraktor, atëherë është Këshilli i Ministrave i cili me anë të një vendimi të posaçëm, përcakton autoritetin apo autoritetet kontraktuese, rast pas rasti.

Përveç autoriteteve kontraktuese, legjislacioni përfshin edhe organe të tjera publike, të cilat si pasojë e fushës së veprimit të tyre, kanë kompetenca të lidhura me proceset e koncesioneve dhe PPP. Përkatësisht përfshihen në mënyrë të posaçme në këtë proces, Këshilli i Ministrave, ministria përgjegjëse për ekonominë, ministria përgjegjëse për financat, Agjencia e Prokurimit

Publik, Komisioni i Prokurimit Publik dhe Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve. Rol dhe kompetenca të tërthorta në këtë proces, kanë edhe disa organe të tjera, si për shembull Avokatura e Shtetit<sup>2</sup>, Autoriteti i Konkurrencës dhe gjykatat administrative.

Mbetet për tu përmendur, që në përputhje me legjislacionin në fuqi, procedurat për dhënien me koncesion ose PPP, mund të propozohen edhe nga subjektet private, të cilët kërkojnë të përfshihen në këto procedura në formën e propozimeve të pakërkuara.

Në seksionet e mëposhtme, vijon një përshkrim i përgjithshëm i këtyre organeve dhe kompetencave përkatëse të tyre në procesin e Koncesioneve dhe PPP. Funksionet dhe veprimtaritë e tyre detajohen më tej edhe në kapitujt vijues, në veçanti në kapitujt që përshkruajnë veprimet paraprake, procedurat e tenderit dhe zbatimin e kontratave.

## **b) Kuadri institucional: roli dhe përgjegjësitë e organeve shtetërore**

### **i. Këshilli i Ministrave**

Këshilli i Ministrave ka një sërë kompetencash në lidhje me procedurat e dhënies së Koncesioneve dhe PPP, të përcaktuara nga ligji 125/2013.

Së pari, Këshilli i Ministrave është organi kompetent për miratimin e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjit 125/2013. Për këtë qëllim Këshilli i Ministrave ka miratuar deri më sot vendimet e përmendura në seksionin e mësipërm të kuadrit ligjor.

Gjithashtu Këshilli i Ministrave ka kompetencën që të miratojë dispozitat e stabilizimit të kontratave koncesionare/PPP, me vendim të posaçëm, në rastet kur i kërkohet nga autoritetet kontraktuese, në zbatim të përcaktimeve të nenit 41 të ligjit 125/2013. Dispozita stabilizuese konsiderohen angazhimet detyruese që autoritetet kontraktuese marrin përsipër në emër të shtetit shqiptar, me qëllim sigurimin e garancive të përshtatshme në favor të partnerit privat. Këto angazhime kanë për qëllim mbrojtjen e partnerit privat ndaj ndryshimeve të ardhshme të legjislacionit, të cilat mund të sjellin pasoja financiare mbi projektin konkret.

### **ii. Ministria e Ekonomisë**

Ministria përgjegjëse për ekonominë, në këtë sektor është përcaktuar si një organ i cili monitoron, orienton dhe koordinon veprimtaritë e lidhura me zhvillimin e koncesioneve dhe PPP. Ministria e Ekonomisë është gjithashtu organi epror i Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, kompetencat e të cilës detajohen më tej.

---

<sup>2</sup> Referuar Ligjit nr 10018 date 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", neni 15, pika 4, "Për hartimin dhe nënshkrimin e kontratave administrative, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, këshillimi i organit përkatës të administratës publike me Avokaturën e Shtetit është i detyrueshëm. Në këto raste, këshillimi i organeve të administratës publike me Avokaturën e Shtetit zgjat deri në përmbushjen e detyrimeve të kontratave nga palët nënshkruese."

### iii. Ministria e Financave

Ministria e Financave, ka disa kompetenca specifike në fushën e koncesioneve dhe PPP, të lidhura veçanërisht me aspektet financiare të kontratave dhe ndikimet buxhetore të tyre.

Kështu Ministria e Financave përfshihet në procesin e vlerësimit të projekteve koncesionare/PPP, dhe kërkohet miratimi saj, në rastet kur këto kontrata kërkojnë mbështetje financiare. Miratimi i ministrisë nevojitet në të gjitha rastet kur efektet e kontratave ndikojnë ose krijojnë rrezikun e ndikimit direkt ose indirekt në Buxhetin e Shtetit ose në buxhetin e organeve vendore.

Ministria e Financave përcakton rregullat për pagesat e tarifave të koncesioneve dhe PPP dhe në rastet kur kjo tarifë nuk paguhet, kjo ministri lëshon urdhërin e arkëtimit të tarifës, i cili përbën titull ekzekutiv sipas legjislacionit shqiptar.

Ministria e Financave mbledh rregullisht, pasqyrat financiare vjetore të shoqërive koncesionare, të cilat bazuar në detyrimet e përcaktuara në ligj, i dërgohen kësaj ministrie nga autoritetet kontraktuese, brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti. Këto dokumente hidhen në regjistrin kombëtar elektronik të koncesioneve dhe PPP i cili administrohet nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve.

Gjithashtu autoritetet kontraktuese, dërgojnë në Ministrinë e Financave kopje të kontratave dhe të ekstraktit të regjistrimit të shoqërisë koncesionare në regjistrin tregtar.

Ministria e Financave njoftohet paraprakisht në rastet kur autoritetet kontraktuese lidhin kontrata shtesë dhe/ose të kushtëzuara me subjektet private që zbatojnë koncesionet dhe PPP. Kontrata shtesë dhe/ose të kushtëzuara, konsiderohen në veçanti, kontratat e lidhura për të siguruar financimin e nevojshëm për zbatimin e kontratës.

Gjithashtu, autoritetet kontraktues kërkojnë miratimin paraprak nga Ministria e Financave për ndryshimet e kontratave të nënshkruara, të cilat ndikojnë ose krijojnë rrezikun e ndikimit direkt ose indirekt në Buxhetin e Shtetit ose në buxhetin e organeve vendore, apo të cilat mund të ndryshojnë në ndonjë mënyrë mbështetjen financiare të projekteve.

Miratimi paraprak i Ministrisë së Financave kërkohet edhe në rastet e transferimit të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, në rastet e ndryshimit të drejtave të pronësisë apo të menaxhimit të subjektit për qëllime të veçanta (SPV), si rezultat i transferimit të kapitaleve ose të aksioneve të shoqërisë, përveçse në rastet kur transferimi vjen si rezultat i tregtimit të rregullt të aksioneve në një treg të rregulluar të kapitalit. Ky miratim është i nevojshëm kur transferimet e planifikuara të kontratës, ndikojnë ose krijojnë rrezikun e ndikimit në ndonjë mënyrë në Buxhetin e Shtetit ose në buxhetin e

njësive të qeverisjes vendore, apo të cilat mund të ndryshojnë në ndonjë mënyrë mbështetjen financiare të projekteve.

Ministria e Financave njoftohet nga autoritetet kontraktuese, edhe në rastet kur subjektit privat i jepen punë dhe/ose shërbime shtesë, të cilat nuk janë të përfshira në kontratën bazë, por që, për shkak të rrethanave të paparashikuara, bëhen të nevojshme, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni.

Autoritetet kontraktuese kërkojnë mendimin e Ministrisë së Financave, në të gjitha rastet e zgjidhjes së kontratave të nënshkuara, sipas rasteve të përcaktuara nga legjislacioni.

Ministri i Financave, në rastet e shkeljeve të dispozitave ligjore nga personat përgjegjës të autoriteteve kontraktuese, ka kompetencën që të propozojë marrjen e masave disiplinore.

#### iv. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve dhe partneriteteve publike private (ATRAKO), është një organ i veçantë i cili ka për qëllim të asistojë autoritetet kontraktuese përgjatë procedurave të dhënies së koncesioneve dhe PPP, kryesisht për vlerësimin e projekteve, përgatitjen e dokumenteve të tenderit, negocimin e kontratave dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

ATRAKO asiston autoritetet kontraktuese veçanërisht në lidhje me kryerjen e veprimeve të mëposhtme: Përgatitjen e studimit të fizibilitetit;

- Përgatitjen e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe kriterëve të vlerësimit;
- Vlerësimin e propozimeve dhe përcaktimin e ofertuesit më të mirë;
- Negocimet dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit/PPP.
- Monitorimin e kontratave të koncesionit/PPP;
- ATRAKO gjithashtu ushtron kompetencat e mëposhtme:
- propozon pranë ministrit përgjegjës për ekonominë, ndryshimet e legjislacionit në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, si dhe në udhëzimet për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;
- monitoron, analizon dhe studion tendencat aktuale evropiane dhe globale, të njohurive dhe përvojës në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private;
- bashkëpunon me Agjencinë e Prokurimit Publik për hartimin dhe

#### v. Agjencia e Prokurimit Publik

Agjencia e Prokurimit Publik (APP) është organ qendror, person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që financohet nga Buxheti i Shtetit. Agjencia e Prokurimit Publik ka disa kompetenca specifike përgjatë kryerjes së procedurave konkurruese, në përputhje edhe me kompetencat që i jep kësaj agjencie legjislatoni për prokurimin publik.

Për sa i përket kompetencave në lidhje me koncesionet dhe PPP, APP ushtron këto detyra:

- monitoron respektimin e procedurave konkurruese të koncesioneve/PPP sipas legjislatoni për prokurimet publike pas nënshkrimit të kontratës dhe në rast të shkeljeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, vendos gjoha ose propozon marrjen e masave administrative;
- përjashton një operator ekonomik sipas dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik nga pjesëmarrja në procedurat e koncesioneve/PPP;
- publikon dokumentet standarde të tenderit për procedurat e koncesioneve/PPP në faqen e saj zyrtare [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

#### vi. Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është një organ publik qendror, në varësi të Kryeministrit, i cili raporton çdo vit pranë Këshillit të Ministrave.

Komisioni i Prokurimit Publik është organi i ngarkuar për të shqyrtuar ankimet kundrejt procedurave dhe rezultateve të procedurave tenderuese. Pas marrjes së një ankese nga KPP, autoriteti kontraktor duhet të pezullojë vazhdimin e procedurës konkurruese deri në marrjen e një vendimi nga KPP, sipas afateve kohore të përcaktuara në ligj.

Në përfundim të gjykimit administrativ, KPP merr vendime përfundimtare në lidhje me ankimet e paraqitura, përfshirë pezullimin, rishikimin apo anulimin e procedurave të prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, në rastet e shkeljeve të dispozitave ligjore nga personat përgjegjës të autoriteteve kontraktuese, ka kompetencën që të propozojë marrjen e masave disiplinore.

#### vii. Organe dhe institucione të tjera

Përgjatë procedurave të dhënies së koncesioneve/PPP, kanë kompetenca të ndërthurura edhe disa organe të tjera, sipas kompetencave specifike që u njeh legjislatoni sipas fushave të tyre të veprimtarisë.

Kështu, autoritetet kontraktuese kanë detyrimin, përgjatë procesit të hartimit dhe të nënshkrimit të kontratave administrative, në kuptimin e Kodit të

Procedurës Administrative, që të këshillohen me Avokaturën e Shtetit. Ky detyrim zgjat deri në momentin e përmbushjes së detyrimeve nga palët e këtyre kontratave, referuar Ligjit nr. 10018 date 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit".

Po kështu autoritetet kontraktuese, janë të detyruara që të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës, në rastet kur, si pasojë e projekteve të koncesionit/PPP, miratojnë akte normative të cilat vendosin kufizojnë aksesin në treg apo tregtimin, japin të drejta ekskluzive ose të veçanta, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara ose imponojnë praktika të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

Së fundmi, një rol të rëndësishëm në procesin e koncesioneve/PPP, mund të luajnë edhe institucionet gjyqësore apo të arbitrazhit.

Ligji 125/2013 i njuh palëve të një kontrate koncesioni/PPP, mundësinë që mosmarrëveshjet ndërmjet autoriteteve kontraktuese dhe partnerëve private, ti zgjidhin përmes sistemit gjyqësor apo edhe përmes mekanizmave alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të pranuar nga palët në kontratën e lidhur midis tyre, përfshirë edhe procedurat e arbitrazhit ndërkombëtar.

Përgjatë procedurave të vendimmarrjes në lidhje me dhënien e një koncesioni/PPP, ankimuesit mund ti adresohen gjykatës përkatëse që shqyrton mosmarrëveshjet administrative, edhe në rastin kur kundërshtojnë vendimet e autoriteteve kontraktuese apo edhe kundër vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik. Gjithashtu, palët mund ti adresohen gjykatës, edhe për çdo mosmarrëveshje në lidhje me kontratat e koncesionit/PPP, përveçse në rastet kur në kontratë palët kanë rënë dakord dhe kanë parashikuar zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve.



## KAPITULLI 3

## ANALIZË KRAHASUESE E KONCESIONEVE DHE PPP

Ky kapitull i dedikohet një analizë krahasuese të partneriteteve publik privat kundrejt koncesioneve, e cila fokusohet tek mirë përcaktimi dhe përkufizimi i këtyre koncepteve.

Qëllimi i kësaj analize specifike është që të ndihmojë autoritetet kontraktuese në identifikimin e formës dhe llojit më të përshtatshëm të kontratave që duhet të përzgjedhin, në rastet kur zbatojnë projekte konkrete, koncesioni apo PPP. Kjo duhet ti shërbeje autoriteteve kontraktuese për t'i dhënë përgjigje pyetjes: “Çfarë lloji kontrate duhet të zbatohet për një projekt konkret, një kontratë koncesioni apo një kontratë partneriteti publik privat?”

Në Republikën e Shqipërisë koncepti i koncesioneve është disi më i njohur se ai i partneriteteve publike private, duke qenë se ka qenë i parashikuar më herët nga legjislacioni, ndërkohë që koncepti i PPP ka hyrë së fundmi në legjislacionin shqiptar. Për këtë arsye, kontratat e koncesionit kanë një historik më të konsoliduar dhe janë përdorur më shpesh nga administrata publike . Legjislacioni shqiptar i post komunizmit i ka trajtuar koncesionet fillimisht me anë të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", cili më pas është zëvendësuar nga ligji nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për Koncesionet”. Përgjatë viteve të fundit, bazuar edhe praktikën e biznesit si edhe në përshtatje të legjislacionit, është miratuar një koncept më i gjerë i partneritetit publik privat, i përcaktuar tashmë edhe në dispozitat ligjore të ligjit aktual që rregullon këtë fushë, përkatësisht ligji 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

Nuk ka një përkufizim universalisht të pranuar të partneritetit publik-privat dhe qeveritë në të gjithë botën, i përshkruajnë ato në mënyra të ndryshme. Megjithatë, ajo që zakonisht është e kuptueshme është fakti se termi partneriteti publiko-privat i referohet rasteve kur sektori publik dhe privat veprojnë bashkërisht për sigurimin e investimeve dhe/ose financimit të punëve apo shërbimeve publike dhe/ose projektimin, operimin dhe menaxhimin e punëve ose të shërbimeve publike. Një kontribut i dobishëm mund të jetë përcaktimi i Bankës Botërore, i cili pasqyron disa aspekte të pranuar botërisht dhe i përshkruan PPP si "një mekanizëm për qeverinë për të prokuruar dhe zbatuar projekte të infrastrukturës dhe/ose shërbimeve publike duke përdorur burimet dhe ekspertizën e sektorit privat ... PPP kombinon aftësitë dhe burimet e të dy sektorëve; publik dhe privat nëpërmjet ndarjes së rreziqeve dhe përgjegjësi".

Aspekti i përbashkët i partneritetit publik privat është përcaktimi i të drejtave, detyrimeve dhe rreziqeve që do të ndahen midis të dy palëve brenda një partneriteti. Si koncesionet ashtu edhe PPP me pagesa nga Autoritetet kontraktuese apo PPP me kontrata të bazuar mbi disponueshmërinë, janë format kryesore të partneritetit publik-privat të cilat përmbushin tre parametra të rëndësishme; ndarja e të drejtave, detyrimeve dhe rreziqeve në lidhje me qëllimin, funksionin dhe strukturën e pagesave për realizimin e kontratës midis sektorit privat dhe autoriteteve kontraktuese të sektorit publik.

Format e ndryshme të partnerit publik privat, përfshirë edhe koncesionet, realizohen nëpërmjet lidhjes së kontratave midis autoriteteve kontraktuese dhe partnerëve privatë. Për lidhjen e këtyre kontratave, autoritet kontraktuese duhet të kenë parasysh fillimisht, dispozitat e përgjithshme të kontratave, sipas Kodit Civil. Sipas këtij Kodi, kontrata konsiderohet si veprimi juridik me anë të së cilës palët krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike. Palët në kontratë mund të përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni. Kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e një kontrate lidhen me elementët vijues: pëlqimi i palëve për marrjen përsipër të detyrimeve, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështeten detyrimet, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji.

Sipas përkufizimeve dhe përcaktimeve që ofron ligji 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", mund të analizohen karakteristikat dalluese të koncesioneve krahasuar me partneritetet publike private.

#### a) Koncesionet

##### i. Koncesionet si forma partneriteti publik privat

Fillimisht është e rëndësishme të evidentohet se koncesionet janë forma të partneritetit publik privat. E thënë ndryshe, projektet e partneritetit publik privat mund të realizohen nëpërmjet disa llojeve të ndryshme kontratash, ndër të cilat përfshihen edhe kontratat e koncesioneve.

Neni 8 i ligjit 125/2013 përcakton shprehimisht se: “Varësisht nga mjetet e shpërblimit, si dhe ndarja e rreziqeve kryesore të natyrshme, një partneritet publik privat mund të realizohet në një nga format e mëposhtme:

- koncesion i punëve publike;
- koncesion i shërbimeve publike;
- kontratë e punëve publike;
- kontratë e shërbimit publik”.

Për pasojë, mund të arrijmë në përfundimin se një projekt partneriteti publik privat mund të realizohet nga autoritetet kontraktuese me anë të katër tipologji kontratash.

Elementët dallues të këtyre 4 llojeve të kontratave të PPP identifikohen nga dispozitat e sipërcituara të ligjit 125/2013. Pika 4 e nenit 8 të ligjit 125/2013 përcakton se dallimi midis tyre, varet nga mjetet e shpërblimit të partnerit privat si dhe nga ndarja e rreziqeve kryesore të natyrshme.

*ii.* Elementët dallues të llojeve të kontratave të koncesionit

Brenda tipologjisë së gjerë të formave të partneritetit publik privat, nga një lexim i kombinuar i dispozitave ligjore, kontratat e koncesionit kanë disa tipare dalluese të përcaktuara nga legjislacioni, të cilat lidhen me mjetet e shpërblimit të partnerit privat dhe me modalitetet e ndarjes së rreziqeve të kontratës midis palëve.

Për këtë qëllim, është i dobishëm një lexim i kombinuar i dispozitave ligjore të legjislacionit. Përveç dispozitave të sipërcituara të pikës 4 të nenit 8, duhen analizuar edhe dispozitat e pikave 2, 3, 4 dhe 5 të nenit 3 të ligjit 125/2013, të cilat përkufizojnë koncesionet dhe evidentojnë elementët e tyre dallues .

- Mekanizmat e shpërblimit të partnerit privat në kontratat e koncesionit

Natyrisht që përfshirja e një partneri privat në realizimin e një koncesioni i cili ka për objekt kryerjen e një vepre publike apo sigurimin e një shërbimi publik, justifikohet nga qëllimi i përfitimit ekonomik nga ana e partnerit privat, i cili synon gjenerimin e të ardhurave dhe shpërblimit të përshtatshëm për punën apo shërbimin e kryer prej tij.

Për sa i përket mjeteve të shpërblimit të partnerit privat në kontratat e koncesionit, dispozitat e legjislacionit që trajtojnë koncesionet përcaktojnë se kontratat e koncesionit të punëve publike mund të parashikojnë të drejtën e partnerit privat për të shfrytëzuar veprat që janë objekt i kontratës, si edhe

mundësinë që kësaj të drejte, ti shtohet edhe e drejta e përfitimit të pagesave nga përdoruesit/përfituesit e veprës. Analogjikisht edhe kontratat e koncesionit të shërbimeve publike, parashikojnë të drejtën e partnerit privat për të përfituar të drejtën e shfrytëzimit të shërbimeve, së cilës mund ti shtohet edhe e drejta për të përfituar pagesa nga përdoruesit/përfituesit e shërbimeve.

Pra shpërblimi i partnerit privat në kontratat e koncesionit mund të realizohet nëpërmjet këtyre dy mekanizmave:

- e drejta për të shfrytëzuar veprat dhe/ose shërbimet publike e cila mundëson lindjen e të drejtës për të gjeneruar të ardhura;
- e drejta për të shfrytëzuar veprat dhe/ose shërbimet publike së bashku me të drejtën për të përfituar pagesa nga përdoruesit/përfituesit e veprës/shërbimit.
- Ndarja e rrezikut operacional midis palëve në kontratën e koncesionit

Në bazë të përkufizimit të ofruar nga pika 5 e nenit 3 të ligjit 125/2013, në kontratat e koncesionit, partneri privat koncesionar, duhet të ndërmarrë një pjesë të konsiderueshme të rrezikut operacional që lidhet me objektin e kontratës.

Rreziku operacional lidhet me përdorimin e veprave ose ofrimin e shërbimeve ose rrezikun që lidhet me disponueshmërinë e objektit të infrastrukturës që ndërtohet ose përdoret për të siguruar shërbime për përfituesit fundorë, në përputhje me kontratën e koncesionit.

Si përfundim, autoritetet kontraktuese mund të identifikojnë **elementët dallues të kontratave të koncesionit**, bazuar mbi përcaktimet e mëposhtme:

- Në kontratat e koncesionit, koncesionari ka të drejtën që të shfrytëzojë veprat dhe/ose shërbimet publike, të cilat realizohen prej tij, përgjatë kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit, me qëllim nxjerrjen e të ardhurave ekonomike;
- Në raste të caktuara, përveç të drejtës për të shfrytëzuar veprat dhe/ose shërbimet publike, të cilat realizohen prej tij, koncesionari mund të përfitojë edhe pagesa; Pagesat e partnerit privat mund të përfitohen nga autoriteti kontraktor, nga përdoruesit fundorë dhe konsumatorët, ose në bazë të një modeli të përzier.
- Për realizimin e veprave dhe/ose shërbimeve sipas objektit të kontratës, koncesionari merr përsipër një pjesë të konsiderueshme të rrezikut operacional të kontratës.

*iii.* Objekti i kontratave të koncesionit

Në bazë të analizës së dispozitave ligjore, objekt i kontratave të koncesionit mund të jetë realizimi i punëve apo i shërbimeve publike. Koncesioni i punëve publike, ka për objekt të tij, kryerjen e punimeve për realizimin e një vepre publike, ndërsa koncesioni i shërbimeve ofrimin e një shërbimi publik. Por kontratat e koncesionit mund të jenë edhe të përziera, pra të përfshijnë si objekt të tyre kryerjen nga ana e partnerit privat jo vetëm të punimeve, por njëkohësisht edhe ofrimin e shërbimeve publike. Në këto raste, autoritetet kontraktuese duhet të vlerësojnë se cili është elementi më i rëndësishëm që ka për qëllim kontrata e koncesionit, pra nëse objekti kryesor i kontratës janë punimet e kryera apo shërbimet e ofruara nga ana e partnerit privat, për të përcaktuar nëse një kontratë e tillë kategorizohet si koncesion i punësh apo koncesion i shërbimeve.

#### **b) Format e tjera të Partneriteteve Publike Private**

Përveçse nëpërmjet kontratave të koncesionit, partneritetet publike private mund të realizohen edhe nëpërmjet formave dhe llojeve të tjera kontratash. Siç u theksua më lart, neni 8 i ligjit 125/2013 përcakton se përveç koncesioneve, PPP mund të realizohen edhe nëpërmjet kontratave të punëve apo shërbimeve publike. Për sa i përket llojeve të kontratave të PPP, legjislacioni i fushës mbetet i hapur, duke e lënë diskrecion autoriteteve kontraktuese në përzgjedhjen e llojeve të ndryshme të kontratave dhe në përcaktimin e përmbajtjes së tyre.

Liria kontraktore e palëve është një parim i përgjithshëm i cili rrjedh nga Kodi Civil, sipas të cilit palët janë të lira të rregullojnë marrëdhëniet e tyre në kontratë brenda kufijve të përcaktuara me ligj.

Pra, partneritetet publike private mund të rregullohen nëpërmjet kontratave me struktura të ndryshme, sipas nevojave të autoriteteve kontraktuese dhe të partnerëve private, në përputhje me specifikat e projekteve konkrete të bashkëpunimit midis tyre.

Parimi i përgjithshëm është që autoritetet kontraktuese duhet të përpiqen të realizojnë nevojat e tyre, për realizimin e projekteve publike, në formën më të frytshme dhe më të përshtatshme për arritjen e qëllimeve të tyre të interesit publik dhe natyrisht, në respektim të dispozitave detyruese të legjislacionit në fuqi.

Bazuar në praktikat më të mira dhe në shembujt e zbatuar në vendet e zhvilluara, partneritetet publike private mund të realizohen nëpërmjet një shumëllojshmërie kontratash, të cilat variojnë nga njëra tjetra, kanë përmbajtje të ndryshme, sipas nevojave të autoriteteve kontraktuese dhe të partnerëve private, në përputhje me specifikat e projekteve konkrete të bashkëpunimit midis tyre.

Tabela e mëposhtme përmban një përmbledhje të llojeve të kontratave të partneritetit publik privat të cilat përdoren në treg si dhe specifikon tiparet kryesore të tyre.

Pavarësisht llojit të tyre, karakteristika kryesore është se kontratat e partneriteteve publike private duhet të respektojnë elementët e detyrueshëm, të parashikuara nga legjislacioni shqiptar. Në vijim përshkruhen më hollësisht elementët, kriteret dhe karakteristikat e identifikueshme nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

### Lloje Kontratash ku përfshihet Sektori Privat

<b>Ofertë Projekti m- ndërtim</b>	<b>Projektim Ndërtim</b>	<b>Projektim- Ndërtim- Operim- Mirëmbajtje</b>	<b>Projektim- Ndërtim- Financim</b>	<b>Projektim- Ndërtim- Financim- Operim- Mirëmbajtje</b>	<b>Ndërtim- Transferim -Operim</b>	<b>Ndërtim (zotërim) - Operim - Transferim</b>	<b>Ndërtim- Zotërim- Operim</b>
<b>Design Bid - Build (DBB)</b>	Design Build (DB)	Design - Build - Operate - Maintain (DBOM)	Design - Build - Finance (DBF)	Design- Build- Finance- Operate- Maintain (DBFOM)	Build Transfer Operate (BDO)	Build- (Own)- Operate- Transfer (BOT or BOOT)	<b>Build- Own- Operate (BOO)</b>
	<i>Operim&amp;M irëmbajtje</i>  Operations & Maintenan ce (O&M) Contract		<i>Financim e të tjera private</i>  Other Private Financing	<i>Projektim- Ndërtim- Financim- Operim</i>  Design- Build- Finance- Operate (DBFO)	<i>Qira- Ndërtim- Operim</i>  Lease- Build- Operate (LBO)		<b>Sektori Privat zotëron dhe operon</b>  <b>Private Sector Owns and Operates</b>
				<i>Koncesione me qira afatgjatë</i>  Long-Term Lease Concessions			<b>Shitje e Aseteve</b>  <b>Asset Sale</b>

											<i>Blerje- Ndërtim- Operim</i>	
											<b>Buy- Build- Operate (BBO)</b>	
<b>Përjasje Tradicion ale (nuk është PPP)</b>			<b>Partneritet Publik - Privat (PPP)</b>									<b>Privatizim i Plotë (nuk është PPP)</b>

Pra, partneritetet publike private parashikojnë kryerjen e disa funksioneve të partnerit publik nga ana e partnerit privat, përkundërt përfitimit të pagesave përkatëse, përgjatë gjithë ciklit të punimeve të kryera dhe/ose shërbimeve të ofruara. Efektshmëria e PPP varet nga transferimi dhe alokimi i rreziqeve tek pala e cila mund ti përballojë më mirë.

Për të qenë të qartë, partneriteti publik privat përfshin forma të ndryshme kontraktore, të tilla, si BOT (ndërtim, operim dhe transferim), DBFO (projektim, ndërtim, financim dhe operim) apo kontrata të ngjashme afatgjata. Këto kontrata mund të parashikojnë struktura të ndryshme pagesash për partnerin privat, të cilat janë zakonisht tarifa të paguara nga përdoruesit, tarifatat e paguara nga shteti ose një kombinim i tyre. PPP përjashtojnë një seri të gjerë marrëveshesh, të tilla si për shembull administrimi afatshkurtër, kontratat e shërbimit dhe të gjithë ato marrëveshje në të cilat organizata jo fitim prurëse ose shoqëria civile, kryejnë shërbime publike.

Neni 8 i ligjit 125/2013, identifikon disa nga karakteristikat bazë të partneriteteve publike private dhe rastet kur projektet duhet të përmbushin kërkesat vijuese, për tu kualifikuar si partneritete publike private:

*i.* Forma bashkëpunimi afatgjata;

Partneritetet Publike Private si rregull kanë si objekt projekte, realizimi i të cilave kërkon marrëdhënie afatgjata midis palëve. Për pasojë, PPP disiplinohen nga kontrata me kohëzgjatje të konsiderueshme, për shembull 20 vjet e sipër.

Projektet e partneritetit publik privat kërkojnë një bashkëpunim afatgjatë, midis partnerit publik si autoritet kontraktues dhe partnerit privat, sipas përcaktimeve të kontratës. Në bazë të dispozitave të nenit 30 të ligjit 125/2013, kontratat e partneritetit publik privat mund të lidhen për një periudhë maksimale deri në 35 vjet. Afatet e kontratave mund të zgjaten vetëm në rastet e veçanta të përcaktuara shprehimisht nga ligji 125/2013.

Për të përcaktuar kohëzgjatjen e këtyre kontratave, autoritetet kontraktuese duhet të vlerësojnë disa elementë, në veçanti objektin e kontratës, llojin, kompleksitetin, kohën dhe vlerën e nevojshme për kryerjen e punimeve apo ofrimin e shërbimeve tyre etj. Kohëzgjatja e përcaktuar e kontratës duhet të

jetë e tillë që të garantojë periudhën e nevojshme për realizimin e punëve dhe shërbimeve të kërkuara, si edhe nga ana tjetër ti garantojë një periudhë kohore të arsyeshme partnerit privat, privatë mënyrë që të mbulojë kostot financiare të përballuara, si dhe ti mundësojë arritjen e një fitimi të arsyeshëm për investimin e kryer prej tij.

*ii.* Ofrim i shërbimeve publike;

Objekti i PPP është ofrimi i shërbimeve publike apo sigurimi i parakushteve të nevojshme për ofrimin e shërbimeve publike. Në këto raste, shërbimet publike mund të ofrohen jo vetëm nga një organ publik (autoriteti kontraktor), por edhe nga partneri privat, për llogari dhe sipas kërkesave të partnerit publik. PPP si rregull krijohen në fushën e një sektori publik, ndaj për këtë qëllim është e dobishme ose e nevojshme që autoritet kontraktuese të mbajnë përgjegjësinë finale. Ky është një ndryshim i rëndësishëm i PPP, krahasuar me privatizimin.

Fillimisht, duhet konsideruar se kontratat e PPP mund të kenë si objekt të tyre, kryerjen e punëve publike, shërbimeve publike ose një kombinim të tyre.

Në kontratat e PPP, partneri privat merr përsipër detyrimin për të ofruar ai vetë shërbime publike të cilat i përkasin fushës së kompetencave të partnerit publik dhe/ose detyrimin për t'i siguruar partnerit publik parakushtet e nevojshme për të ofruar shërbimet publike.

Pra shërbimet publike mund t'u ofrohen përdoruesve fundorë të shërbimeve ose konsumatorëve, nga vetë autoriteti kontraktues ose nga partneri privat, në varësi dhe sipas përcaktimeve të objektit të kontratës së PPP.

*iii.* Detyrimet e partnerit privat;

Për të ofruar shërbimet publike, partneri privat mund të marrë përsipër detyrime të ndryshme, në varësi të kërkesave të partnerit publik dhe të nevojave të lidhura me realizimin e punëve apo shërbimeve publike. Këto detyrime mund të përfshijnë detyrimet vijuese;

- të financojë, të projektojë, të ndërtojë, të rindërtojë ose rinovojë objekte të infrastrukturës publike;
- të përdorë, operojë dhe të mirëmbajë objektet e infrastrukturës publike ekzistues, të ndërtuar ose të rindërtuar;
- kombinime të detyrimeve të sipërpërmendura, për qëllimet e përmbushjes së objektivave të kontratës.

Partneritetet publike private bazohen mbi kryerjen një seri funksionesh apo detyrimesh prej këtyre të përmendura më sipër, nëpërmjet mekanizmave për realizimin e projekteve, të cilat synojnë krijimin e disa përfitimeve, siç janë për shembull promovimi i inovacionit teknologjik të përdorur, efienca e kostove



të projektit dhe ekonomia e shkallës në dhënien e rezultateve të pritshme si dhe për realizimin efikas të objektivave të kontratës

*iv.* Transferim i rrezikut:

Në kontratat e PPP partneri privat merr përsipër një pjesë të rreziqeve të lidhura me zbatimin e kontratës. Ndarja e rreziqeve midis partnerëve të kontratës, bazohet mbi parimin që rreziqet duhet ti ngarkohen palës e cila objektivist i përballon më mirë ato. Gjithashtu, zakonisht në këto kontrata, çdo partner merr përgjegjësinë për rastet e rrezikut që janë nën sferën e ndikimit të tij.

Ndarja e rreziqeve midis palëve dhe niveli përkatës i rrezikut të marrë përsipër nga partneri privat përcaktohen rast pas rasti, në varësi të formës së partneritetit publik privat dhe duke marrë në konsideratë rreziqet që lidhen me të gjitha aspektet kontraktore, të tilla si angazhimet kontraktore në lidhje me punimet, shërbimet, operimin, mirëmbajtjen, detyrimet financiare dhe rreziqet teknike.

Alokimi i duhur i rrezikut tek pala e cila mund ta përballojë më mirë atë, është një faktorët kyç të partneriteteve publike private dhe të Vlerës së Parasë. Ky alokim mund të arrihet më mirë nëse realizohet një proces konkurrues tenderimi transparent dhe jo - diskriminues, i cili mundëson konkurrencën e operatorëve ekonomikë.

Transferimi i rreziqeve është një nga sfidat kryesore për mirë funksionimin e projekteve që bazohen në përfshirjen e sektorit privat, dhe një alokim i duhur i rrezikut është një faktor i rëndësishëm i cili kontribuon në qëndrueshmërinë dhe suksesin e projekteve të partneritetit publik privat.

Duhet patur parasysh që ndërsa transferimi i rrezikut është elementi kryesor për përcaktimin e efikasitetit dhe të Vlerës së Parasë, nga na tjetër garantimi i konkurrencës dhe mos kontestimi i procedurave tenderuese të projekteve janë faktorë të cilët shtojnë garancitë për transferimin efektiv të rrezikut.

*v.* Shpërblimi i partnerit privat:

Për kryerjen e punëve apo shërbimeve të kërkuara nga partneri publik, partneri privat shpërblehet financiarisht, në përputhje me përcaktimet e kontratës. Partneri privat mund të shpërblehet:

- duke ju dhënë e drejta për të shfrytëzuar veprat dhe/ose shërbimet publike duke vendosur tarifa ose pagesa të cilat përballohen nga përdoruesit fundorë të shërbimeve apo nga konsumatorët;
- duke ju dhënë e drejta për të shfrytëzuar veprat dhe/ose shërbimet publike së bashku me përfitimin e mbështetjes financiare nga autoriteti kontraktor;
- nga pagesat e kryera nga autoriteti kontraktor ose të përfituara në emër të tij, zakonisht kundrejt disponueshmërisë së objektit dhe/ose shërbimit të ofruar;
- me forma të tjera të mbështetjes financiare, përfshirë transferimin e të drejtave materiale dhe të drejtave të tjera reale;
- një kombinim i mjeteve të shpërblimit të sipërpërmendura.

Bazuar në përkufizimin ligjor, mbështetje financiare konsiderohet çdo lloj i mbështetjes monetare ose jo monetare dhe/ose financimi i dhënë nga sektori publik, duke përfshirë, por pa u kufizuar, subvencionet, garancitë financiare apo të tjera, kontribute kapitale dhe transferim të të drejtave të pronësisë.

Kontratat e PPP duhet të kenë një shpërndarje të ndershme të të drejtave dhe detyrimeve të palëve, në respekt të interesit publik, por duke marrë në konsideratë edhe interesin ekonomik të partnerit privat për të marrë një shpërblim të drejtë financiar. Suksesi i një kontrate PPP, varet shpesh herë, nga balancimi i duhur i detyrimeve dhe përfitimeve të të dy palëve të kontratës.

- Subjekti për qëllime të veçanta (SPV)

Një formë tjetër alternative për realizimin e partneritetit publik privat e njohur nga legjislacioni është edhe mundësia që autoriteti kontraktues të krijojë sëbashku me partnerin privat, një shoqëri të posaçme, apo siç përkufizohet nga ligji, një subjekt për qëllime të veçanta (SPV), i cili realizon punët apo shërbimet, në bazë të një kontrate PPP.

Në këtë rast, SPV mund të zotërohet bashkërisht nga partneri publik dhe privat dhe ka kapital të përzier, të përbërë nga kontributet përkatëse të partnerëve, sipas dispozitave të nenit 8, paragrafi 2 i ligjit 125/2013..

Kontributi i partnerit privat nuk konsiston vetëm në dhënien e kontributit në kapital apo asete, por edhe në pjesëmarrje aktive në menaxhimin e kontratës. Injektimet e thjeshta të kapitalit nga investitorët privatë në kompanitë shtetërore nuk konsiderohen SPV.

Nga ana tjetër, kontributet e partnerit publik në SPV, nuk duhet të jenë në vlera të tilla të cilat eliminojnë apo rrezikojnë të eliminojnë rrezikun operacional në ngarkim të partnerit privat, përndryshe ligji përcakton se një kontratë apo një ndërmarrje e tillë, nuk do të konsiderohet si një partneritet publik privat.

Duhet patur parasysh se ky lloj i SPV është i ndryshëm dhe nuk duhet të ngatërrohet me rastin e shoqërive të reja koncesionare (SPV koncesionare) të cilat duhet të themelohen nga operatorët ekonomikë të cilët kanë fituar procedurat konkurruese të tenderit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktues

### c) Aspekte të përbashkëta të koncesioneve dhe PPP

Me qëllimin për të ndihmuar autoritetet kontraktuese për të identifikuar aspektet dallues të dy koncepteve, pra të koncesionit dhe të PPP, me qëllim përzgjedhjen e formës dhe llojit më të përshtatshëm të kontratave që duhet të zbatohen, deri më tani u analizuan dhe theksuan aspektet dhe diferencat midis tyre. Por konceptet dhe kontratat e koncesionit dhe të PPP i përkasin të njëjtës kategori, janë relativisht të ngjashme dhe kanë shumë elementë dhe karakteristika të përbashkëta. Këto elementë të përbashkët të tyre do të jenë objekt i seksionit në vijim.

#### i. Kohëzgjatja e kontratave

Partneritetet publik privat, përfshirë pra edhe koncesionet, rregullojnë forma të bashkëpunimit afatgjatë midis organeve publike dhe partnerit privat. Legjislacioni përkatës parashikon se këto kontrata mund të lidhen për një periudhë deri në 35 vjet, e cila mund të zgjatet në raste të veçanta. Për pasojë, bashkëpunimi midis palëve rregullohet nëpërmjet kontratave përkatëse të cilat kanë një kohëzgjatje më të lartë se sa kontratat e zakonshme që lidhin organet e administratës publike. Ky afat justifikohet nga vetë natyra e këtyre kontratave si edhe nga vlerat e larta të investimeve, të cilat kërkojnë kohë për të prodhuar përfitime ekonomike.

#### ii. Partneri publik në kontratat e PPP

Në kontratat e koncesionit apo kontratat e tjera të PPP, partneri publik identifikohet me autoritetin kontraktues. Zakonisht, partneri publik është një autoritet kontraktues i vetëm, i cili kërkon realizimin nga ana e partnerit privat të veprimtarive të cilat janë brenda fushës së tij të kompetencave.

Sipas kuadrit ligjor ekzistues, autoritete kontraktuese konsiderohen ministritë, bashkitë dhe qarqet.

Në raste të veçanta dhe në përputhje më kriteret ligjore, nënshkrues të kontratave të partneritetit publik mund të jenë disa autoritete kontraktues, në rastet kur objekti i kontratës është fushë e veprimtarisë së më shumë se një autoriteti kontraktues. Në këto raste është Këshilli i Ministrave, i cili me

vendim të posaçëm, rast pas rasti, përcakton se cili organ do të konsiderohet si autoritet kontraktues.

Prania e disa autoriteteve kontraktuese në një partneritet publik privat, mund të realizohet edhe nëpërmjet marrëveshjeve të cilat mund të lidhen vullnetarisht midis disa autoriteteve kontraktuese të ndryshme. Në disa raste specifike, sidomos njësitë e qeverisjes vendore, mund të kenë interes në ushtrimin e përbashkët të disa kompetencave, duke qenë se në rastet e bashkimit të tyre, mund të arrijnë të lidhin kontrata për përfitimin e shërbimeve, të cilat nuk mund ti përballonin dot veçmas, duke reduktuar shpenzimet dhe detyrimet si dhe duke ndarë rrezikun operacional.

### iii. Partneri privat në kontratat e PPP

Partneri privat i cili lidh një kontratë koncesioni/PPP me autoritetin kontraktues është operatori ekonomik, i cili në përfundim të procedurave konkurruese është përzgjedhur si fitues, meqenëse ka paraqitur pranë autoritetit kontraktues ofertën më të mirë.

Fitues të procedurave konkurruese mund të jenë edhe disa partnerë privatë, të cilat kanë krijuar një bashkim të përkohshëm të shoqërive, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni për koncesionet dhe PPP si edhe ai i prokurimit publik.

Legjislacioni parashikon se një shoqëri tregtare mund të konkurrojë e vetme apo si pjesë e një grupi shoqërisht të cilët konkurrojnë sëbashku, duke paraqitur një ofertë të vetme. Në ofertën e paraqitur nga grupi i shoqërive, duhet të përcaktohen përkatësisht pjesët e punëve apo të shërbimeve që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi. Grupi i operatorëve ekonomikë duhet të zgjedhë një përfaqësues të tij përgjatë procedurave konkurruese dhe zbatimit të kontratës. Bashkimi i përkohshëm i shoqërive duhet të krijohet zyrtarisht, nëpërmjet një marrëveshje të posaçme, me shkrim dhe në formë noteriale. Kjo marrëveshje duhet të përcaktojë përfaqësuesin e grupit, përqindjet e pjesëmarrjes së punës/shërbimit si dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi. Në rastet kur bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata e koncesionit/PPP duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e grupit të shoqërive, të cilët do të jenë individualisht dhe bashkërisht, përgjegjës për detyrimet kontraktore.

Në disa raste të veçanta, legjislacioni i njeh të drejtën autoritetit kontraktues që të kërkojë nga operatori ose operatorët ekonomikë fitues, krijimin e një shoqërie të re, e cila do të ngarkohet për realizimin e kontratës. Kjo shoqëri e re konsiderohet nga legjislacioni si subjekt për qëllime të veçanta, shkurt SPV (special purpose vehicle).

SPV themelohet nga partneri ose partnerët privatë, të cilët rezultojnë fitues të procedurave konkurruese dhe duhet të regjistrohet në regjistrin tregtar shqiptar. Kjo shoqëri e re duhet të ketë si objekt ekskluziv të veprimtarisë së saj, objektin e kontratës së PPP. Autoritetet kontraktuese duhet të përcaktojnë

në dokumentet e tenderit dhe në kontratat përkatëse detyrimet që mbeten në ngarkim të shoqërive mëmë, të cilat kanë rezultuar fituese të procedurave të tenderit dhe të cilat, në cilësinë e ortakëve apo aksionarëve, kanë krijuar shoqërinë e re SPV. Gjithashtu autoritetet kontraktuese mund të vendosin kushte apo të kërkojnë miratim paraprak, në lidhje me rastet e ndryshimit të pronësisë apo të administrimit të SPV, sipas përcaktimeve specifike ligjore.

#### d) Sektorët ekonomikë dhe socialë të koncesioneve/PPP

Koncesionet/PPP zbatohen për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve përgjatë disa sektorëve ekonomikë dhe socialë, në bazë të përcaktimeve të nenit 4 të ligjit 125/2013. Sektorët ekonomikë dhe socialë në të cilat mund të zbatohen projektet e koncesionit dhe PPP, identifikohen si më poshtë;

- Transport;
- Energji;
- Ujëra;
- Mbeturina;
- Telekomunikim;
- Shkencë
- Arsim;
- Turizëm;
- Kulturë;
- Shëndetësi;
- Sport;
- Shërbime sociale;
- Burgje dhe infrastrukturë gjyqësore;
- Rehabilitim i tokës dhe pyjeve;
- Parqe industriale dhe infrastrukturë për mbështetjen e biznesit;
- Miniera;
- Strehim;
- Godina të administratës publike;
- teknologji e informacionit dhe infrastrukturë e bazës së të dhënave;
- Gaz natyror;
- Rehabilitim dhe zhvillim urban dhe suburban;
- Ndriçim publik;
- Bujqësi

Përveç këtyre rasteve ligji i njetë drejtën Këshillit të Ministrave, që bazuar në propozimet e ministrave, bashkive, qarqeve apo të organeve qendrore të përfshira në politikat e koncesioneve/PPP, të vendosë edhe për koncesione/PPP që zbatohen në sektorë të tjerë.

**e) Rastet përjashtimore të koncesioneve/PPP**

Kontratat e koncesioneve dhe PPP nuk zbatohen në disa fusha të caktuara, të cilat përjashtohen shprehimisht nga ligji 125/2013. Këto përjashtime zbatohen në rastet e mëposhtme;

- Kontratat nën kufirin e ulët monetar. Kufiri i ulët monetar për koncesionet dhe PPP përcaktohet nga neni 2 i VKM 575/2013 dhe aktualisht, kufiri i ulët monetar është përcaktuar në vlerën prej 5 milion Lekë.
- kur realizimi i tyre duhet të shoqërohet me masa të veçanta të sigurisë;
- për blerjen ose marrjen me qira, me çfarëdo mjetesh financiare, të pasurisë së paluajtshme ose të të drejtave të lidhura me to;
- për blerjen, zhvillimin, prodhimin ose bashkëprodhimin e materialeve të programit apo reklamave të destinuara për transmetim nga transmetuesit ose për publikimin në media dhe kontratat për kohën e transmetimit;
- për koncesionet, të cilat u nënshtrohen rregullave të ndryshme dhe që jepen në përputhje me rregullat procedurale të veçanta të organizatave ndërkombëtare;
- për shërbimet e arbitrazhit dhe të pajtimit;
- për shërbimet financiare, në lidhje me nxjerrjen, shitjen, blerjen, apo transferimin e titujve ose instrumenteve të tjera financiare;
- për të gjitha shërbimet e përmendura në procedurat për dhënien e kontratave sektoriale në ligjin e prokurimit publik;
- për shërbimet e transportit ajror;
- për koncesione/partneritete publike private që u nënshtrohen rregullave të ndryshme dhe që janë dhënë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe që përfshijnë punë, mallra apo shërbime të destinuara për zbatimin e përbashkët ose përdorimin e projekteve nga ana e vendeve nënshkruese;

#### KAPITULLI 4 ARSYET PËR ZBATIMIN E KONCESIONEVE DHE/OSE PPP

Arsyet të cilat çojnë autoritetet kontraktues në përzgjedhjen dhe zbatimin e kontratave koncesionare dhe të partneritetit publik privat mund të jenë të shumta. Emëruesi i përbashkët i tyre, në të gjitha rastet, është fakti që, realizimi i një projekti i cili përfshin realizimin e punëve apo shërbimeve publike, mund të kryhet në mënyrë më efektive, efikase, me profesionalizëm të lartë dhe me më pak kosto për administratën publike, nëpërmjet përfshirjes së një partneri privat.

Në vijim analizohen disa nga arsyet kryesore që justifikojnë zbatimin e këtyre formave bashkëpunimi të partnerit publik me partnerin privat.

Partneritetet publike private, si marrëdhënie me përfitim të përbashkët si për sektorin publik edhe për atë privat, janë një mënyrë e efektshme për të zgjidhur nga njëra anë rastet e mungesave të fondeve buxhetore apo resurseve ekonomike në dispozicion dhe nga ana tjetër për plotësimin e kërkesave për punë apo shërbime publike, dhe ofrimin e tyre në kohën e duhur. Kjo sjell edhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike të ofruara dhe rrit nivelin e aksesit të publikut në to. Zotësia për të transferuar një pjesë të rreziqeve, për të përdorur burime financiare të jashtme dhe përfitimet nga investimet dhe kapitali intelektual e sektorit privat i ofron politikbërësve të sektorit publik fleksibilitet në alokimin e burimeve njerëzore dhe financiare.

Megjithatë, ekzistojnë dhe rreziqe të mbartura nga sektori publik, të lidhura me partneritetet publike private, të cilat mund të përfshijnë edhe kosto financiare më të larta, kryesisht si pasojë e rritjes së kostove të huamarrjes apo të mosrealizimit të pritshmërive mbi kthimin e kapitalit. Procesi i përgatitjes dhe kryerjes së procedurave konkurruese të tenderimit, marrin kohë, përdorin shumë burime njerëzore si dhe kërkojnë një planifikim të mirë të procedurave. Për këto arsye, kostot e transaksioneve për realizimin e një PPP janë zakonisht më të larta se se kostot e përballuara nga sektori publik për realizimin e projekteve publike nëpërmjet procesit tradicional të prokurimit publik.

Për më tepër, PPP mund të ketë kosto të fshehura financiare, të cilat mund të shkaktohen nga ngjarje të paparashikuara, të cilat mund të mos jenë pasur parasysh gjatë fazës së planifikimit të kontratës.

Gjithashtu, projektet e partneritetit publik privat mund të përdoren nga autoritetet kontraktuese si mekanizma për të shmangur tejkalimin e kufijve të tyre të huamarrjes, duke marrë parasysh natyrën jashtë buxhetore të PPP.

PPP nuk parashikojnë kryerjen e parapagesave nga organet publike, por megjithatë përmbajnë një fluks shpenzimesh të këtyre organeve, përgjatë gjithë ciklit të jetës së projektit. Sipas rregullave ndërkombëtare të kontabilitetit, për shumicën e PPP nuk kërkohet që këto projekte të përfshihen në bilancet e sektorit publik. Për më tepër, Vlera e Parasë mund të arrihet vetëm nëpërmjet një planifikimi të mirë dhe përzgjedhje të kujdesshme të

projektit. Mangësitë në procesin e planifikimit apo çështje të caktuara, të tilla si ndërhyrjet politike apo rastet e “përfitimeve personale” përmenden nga Banka Botërore si faktorë të cilët ndikojnë në planifikimin e kujdesshëm të projekteve. Shpesh herë, autoritetet kontraktuese kanë tendencën të pranojnë nivele të tepërta rreziqesh financiare, në rastet kur marrin përsipër këto lloj projektesh. Dhe së fundmi, por jo e fundit për nga rëndësia, PPP prodhojnë Vlerë të Parasë, vetëm në rastet kur garantohej efektivisht konkurrenca në procedurat konkurruese të tenderit. Për këtë arsye, proceset efikase dhe transparente të tenderimit përbëjnë një parakusht për arritjen e rezultateve të mira për sa i përket alokimit të rreziqeve dhe Vlerës së Parasë në kontratën përfundimtare.

Në tabelën në vijim, identifikohen në mënyrë të përmblodhur përfitimet dhe rreziqet kryesore të cilat lidhen me realizimin projekteve të PPP.

Përfitimet nga PPP	Rreziqet e PPP
<p>Mbyllja e Boshllëqeve të Financimit</p> <p>PPP përdoren për thithjen e kapitalit privat si një burim shtesë financimi në drejtim të ofrimit të shërbimeve dhe prokurimin e aseteve</p>	<p>Kosto më të Larta Financiare</p> <p>Megjithëse sektori privat mund ta ketë më të lehtë marrjen e financimit, financimet do të jepen vetëm në rast se projekti do të sigurojë jo vetëm kthimin e investimit por edhe një fitim të arsyeshëm. Kjo shkakton rritjen e kostove të financimit</p>
<p>Inovacion &amp; Efektshmëri</p> <p>PPP përdoren për të futur teknologjinë dhe inovacionin e sektorit privat në drejtim të ofrimit të shërbimeve më të mira publike dhe të përmirësimit të efektshmërisë operacionale</p>	<p>Kosto më të Larta të Transaksioneve</p> <p>Ka gjasa që kostot e vazhdueshme dhe të detyrueshme të zhvillimit në projektet PPP, të jenë më të mëdha se për projektet tradicionale të prokurimit – prandaj autoritetet duhet të vendosin nëse kostot më të larta që përfshihen janë apo jo të justifikuara.</p>
<p>Ofrimi në Kohë &amp; Incentivat Buxhetore</p> <p>Stimulimi i sektorit privat për kryerjen e projekteve në kohë dhe brenda limiteve buxhetore</p>	<p>Kosto Fiskale Potencialisht më të Larta</p> <p>Për shkak të natyrës afatgjatë dhe kompleksitetit të PPP, nuk mund të parashikohen të gjithë të papriturat përgjatë projektit. Mund të lindin ngjarje të paparashikueshme të cilat nuk njiheshin në momentin e</p>



	Mbylljes Financiare.
<p>Vlera e Parasë</p> <p>Përfitimi afatgjatë nga Vlera e Parasë nëpërmjet transferimit të përshtatshëm të rrezikut tek sektori privat gjatë kohëzgjatjes së projektit – nga projektimi/ndërtimi tek kryerja e veprimtarive/mirëmbajtja.</p>	<p>Planifikimi jo i mirë dhe Përzgjedhja e Projektit</p> <p>PPP nuk zëvendësojnë planifikimin dhe procesin e përzgjedhjes së projekteve. Prandaj planifikimi jo i mirë dhe përzgjedhja e projektit mbeten akoma një rrezik për sektorin publik.</p>
<p>Ngritja e Kapaciteteve</p> <p>Plotësimi i kapaciteteve të kufizuara të sektorit publik për tu përgjigjur kërkesës për zhvillim të infrastrukturës.</p>	<p>Mos arritja e Konkurrencës për PPP</p> <p>PPP-të prodhojnë Vlerën e Investimit dhe përfitimet e parashtruara vetëm nëse procedurat e tenderimit janë kryer rregullisht si rruga bazë drejt përfundimit të një strukture optimale dhe alokimit të rreziqeve.</p>
<p>Rritja e Konkurrencës</p> <p>Krijimi i shumëllojshmërisë në ekonomi duke e bërë vendin më konkurrues duke ju referuar bazës së infrastrukturës si dhe duke i dhënë një shtysë industrisë</p>	<p>PPP përdoren për të anashkaluar kufijtë e huamarrjes.</p> <p>Për shkak të natyrës jashtë-buxhetore të PPP, nëse nuk administrohen me kujdes, autoritetet mund të përdorin PPP për të anashkaluar kufijtë e huamarrjes së kujdesshme.</p>

Në vijim analizohen disa nga arsyet kryesore të cilat justifikojnë zbatimin projekteve nga autoritetet kontraktore, nëpërmjet formave të ndryshme të PPP.

#### a) Fondet e pamjaftueshme

Situata financiare e autoriteteve kontraktuese, të ardhurat e të cilave bazohen kryesisht mbi prurjet nga Buxheti i Shtetit, nuk lejon gjithnjë realizimin në kohë dhe me efikasitet të punëve apo shërbimeve publike, në dobi të qytetarëve. Fondet buxhetore të alokuara për ministritë e qeverisjes qendrore apo për njësitë e qeverisjes vendore, shpesh herë nuk janë të mjaftueshme për përbalimin e kostove për realizimin e të gjitha projekteve të nevojshme, të cilat paraqesin interes publik.

Pamjaftueshmëria e fondeve verifikohet në mënyrë të veçantë, për projektet e mëdha infrastrukturore, kombëtare, rajonale apo vendore të cilat kërkojnë investime të konsiderueshme dhe afatgjata, të cilat tejkalojnë aftësitë financiare dhe parashikimet afatshkurtra të të ardhurave të autoriteteve kontraktues. Në të vërtetë kjo situatë prek në veçanti organet e qeverisjes vendore, të cilat kanë si burim kryesor të të ardhurave të tyre, financimin nëpërmjet granteve të pakushtëzuara vjetore, të dhëna nga qeverisja qendrore. Për më tepër që projektet e mëdha të infrastrukturës, kanë nevojë jo vetëm për ristrukturim dhe mirëmbajtje konstante, por edhe për shtim, rinovim, modernizim dhe përshtatje në përputhje me ritmet e zhvillimit ekonomik të vendit.

Partneritetet publike private janë metoda efektive prokurimi për të mbushur boshllëqet e financimit. Megjithatë, ka edhe rreziqe të lidhura me këto lloje projektesh, duke përfshirë rreziqet financiare për shkak të kostove më të larta të huamarrjes, verifikimit të kostove më të larta të transaksioneve apo përfshirja e kostove financiare të paparashikuara fillimisht.

Autoritetet kontraktuese të cilat nuk kanë mundësi që të përballojnë kostot për realizimin e projekteve nëpërmjet prokurimit publik tradicional, kanë një mundësi shtesë duke përdorur PPP. Partneritetet publike private mund të realizohen nga autoriteti kontraktues në një larmi formash kontraktore, të financuara plotësisht apo pjesërisht nga partneri privat, i cili mund të ofrojë mekanizma financues të cilat mund të jenë më të përshtatshëm, krahasuar me modelin klasik të prokurimeve publike.

Financimi nga partneri privat, mundëson realizimin e shpejtë të atyre projekteve, të cilat nëse do të bazoheshin vetëm tek fondet e pakta publike, do të realizoheshin në afate kohore më të gjata, si pasojë e kufizimit të fondeve vjetore të dhëna nga pushteti qendror. Duke qenë se projektet e partneritetit publik privat nuk parashikojnë pagesa paraprake nga shteti, por përfshijnë një sërë shpenzimesh nga ana e shtetit përgjatë ciklit të jetës së projektit, ekziston një lehtësim i perceptueshëm i barrës fiskale të paktën gjatë fazave fillestare të zbatimit të projekteve. Kryerja në një kohë të shkurtër e punëve apo shërbimeve publike, sjell një avantazh të menjëhershëm si për përdoruesit fundorë ashtu edhe për autoritetet kontraktuese.

Gjithashtu, përdorimi i financimit nga ana e partnerit privat, eliminon rrezikun e lidhur me shtimin e borxhit publik, meqenëse organet publike, shpesh herë, për realizimin e projekteve publike dhe në pamundësi të fondeve të mjaftueshme në dispozicion të tyre, përdorin mekanizmat e kredimarrjes në tregjet financiare. Për shumicën e projekteve të partneritetit publik privat, sipas rregullave ndërkombëtare të kontabilitetit, nuk kërkohet që këto lloj projektesh të përfshihen në bilanci e sektorit publik.

## **b) Mungesa e planifikimit**

Shpeshherë burimet e kufizuara të autoriteteve kontraktuese përdoren për një pakicë projektesh, duke mos arritur të prodhojnë përfitime kundrejt kostove të tyre.

Këto situata mund të shkaktohen nga mungesa e planifikimit dhe koordinimi jo i mirë ndërmjet planeve, strategjive dhe projekteve të institucioneve shtetërore. Koordinimi është i nevojshëm në mënyrë që të përzgjidhen projektet më të mira kundrejt vlerës së shpenzuar dhe që mundësojnë zhvillim të integruar.

Një rrezik tjetër vjen edhe nga ndryshimi i shpeshtë i planeve dhe strategjive të planifikimit të zhvillimit të organeve të administratës publike, si pasojë e ndryshimeve të shpeshta politike.

Gjithashtu, planifikimi jo i mirë ka shkaktuar rezultate çorientuese në lidhje me vlerësimin e projekteve. Për rrjedhojë, përfitimet shpesh herë mbivlerësohen, duke rezultuar në projekte të cilat janë më të mëdha e më komplekse seç justifikohet nga kërkesa reale për shërbime, ndërkohë që shpesh herë kostot shpeshherë nënvleftësohen.

Një shkak tjetër i planifikimit jo të mirë lidhet me ndërhyrjet politike, interesat personale dhe korrupsionin. Kjo mund të sjellë situata në të cilat për qëllime politike apo përfitime personale, përzgjidhen disa projekte jo efikase, me parashikime të gabuara të kostove dhe përfitimeve.

### **c) Menaxhimi i dobët dhe mirëmbajtja e papërshtatshme**

Në shumë raste, autoritetet kontraktuese administrojnë vetë, objekte, vepra, infrastruktura publike apo kryejnë vetë punë apo shërbime publike, të cilat janë objekt i kompetencave të tyre.

Është një fakt i njohur, që administrimi në mënyrë direkte i punëve apo shërbimeve publike nga ana e institucioneve shtetërore, në një treg të lirë dhe konkurrues, në shumë raste nuk ka rezultuar mënyra më e mirë për të arritur rezultate të kënaqshme. Menaxhimi publik shfaq shpesh herë dobësi të theksuara, të cilat vijnë si pasojë e shumë elementëve, të cilët mund të jenë mosrealizimi i të ardhurave maksimale, mungesa e profesionalizmit në administrim, efica e ulët ekonomike, cilësia e dobët e shërbimit, mungesa e një kontrolli efektiv, konkurrenca e dobët, mungesa e stimujve të menaxherëve, etj. Menaxhimi publik, me defektet sistematike të ndikuara nga mungesa e stabilitetit të burimeve njerëzore, ndërhyrjet e faktorëve politikë, mungesa e stimujve direkte për punonjësit, ka qenë shpesh inferior për sa i përket rezultateve, krahasuar me menaxhimin e partnerëve privatë, të cilët veprojnë si sipërmarrës ekonomikë të mirëfilltë të cilët kanë për qëllim rritjen e cilësisë, maksimalizimin e përfitimeve dhe administrimin e kujdesshëm ekonomik. Sipërmarrësit privatë ofrojnë avantazhe edhe për sa i përket specializimit specifik në veprimtari ekonomike të caktuara, të cilat i vendosin ata në një pozitë më të mirë krahasuar me autoritetet kontraktuese.

Në tregjet ndërkombëtare ky përfundim është pranuar prej kohësh dhe trendi i autoriteteve publike, ka qenë gjithmonë e më shumë në drejtimin që kryerja e punëve publike apo ofrimi i shërbimeve, të administrohet në bashkëpunim me partnerët privatë, duke sjellë rezultate shumë herë më të kënaqshme, me eficiencë më të lartë dhe kosto më të reduktuara për publikun.

Një tjetër arsye, lidhet me mirëmbajtjen. Objektet, strukturat, infrastrukturat, mjetet dhe shërbimet publike kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme dhe në nivele të kënaqshme. Në shumë raste, niveli i mirëmbajtjes së tyre nga sektori publik, rezulton i papërshtatshëm, duke sjellë si pasojë uljen e cilësisë së ofruar. Mirëmbajtja e pa planifikuar dhe e pa zbatuar në mënyrë efektive, rrit gjithashtu kostot ekonomike dhe amortizon dhe shkurton jetëgjatësinë e aseteve publike, duke sjellë nevojën e ndërtimit të aseteve të reja, të cilat kërkojnë përballimin e shpenzimeve nga e para.

Mungesa e fondeve, vizionit dhe planifikimit të përshtatshëm në lidhje me nevojat e ndërhyrjeve konstante me qëllim mirëmbajtjen në nivele të kënaqshme, të punëve dhe shërbimeve publike është një nga problematikat e sektorit publik.

Edhe në këtë rast, ndërhyrja e partnerëve privatë, të cilët kanë kapacitetet ekonomike dhe profesionale të nevojshme, kur kryhet në mënyrë të studiuar dhe me mekanizmat e duhur të monitorimit publik, përmirëson ndjeshëm situatën në lidhje me mirëmbajtjen cilësore dhe me kosto të ulëta të aseteve dhe shërbimeve publike.

## KAPITULLI 5

## PARIMET DHE PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

Procesi administrativ për vlerësimin dhe dhënien e një koncesioni apo një partneriteti publik privat, kryhet duke u bazuar në parimet e përgjithshme dhe në procedurat ligjore të detajuara, të përcaktuara nga legjislacioni sektorial mbi koncesionet dhe PPP.

Gjithashtu, Ligji 125/2013, përcakton se përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga legjislacioni për PPP, në veçanti për sa i përket kryerjes së procedurave konkurruese të tenderit, zbatohen edhe dispozitat e legjislacionit për prokurimin publik.

**a) Parimet e përgjithshme**

Parimet e përgjithshme të cilat duhet të zbatohen nga autoritetet kontraktuese dhe administrata publike në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre, përgjatë procesit të identifikimit, vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve/PPP, përfshijnë transparencën, mosdiskriminimin, proporcionalitetin, efikasitetin, trajtimin e barabartë, reciprocitetin dhe sigurinë ligjore.

Parimi i transparencës, është një parim i cili lidhet ngushtësisht me parimet e informimit, publikimit dhe aksesit të publikut. Ky parim i detyron të gjitha organet publike që të ushtrojnë veprimtarinë e tyre administrative në mënyrë transparente, në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë që përfshihen në këto veprimtari. Transparenca lidhet me kryerjen e procedurave në mënyrë të hapur, duke garantuar të drejtën e informimit, aksesin dhe publikimin e informacioneve dhe të dhënave në favor të personave, të drejtat dhe interesat e të cilëve preken ose mund të preken nga një veprim i administratës publike. Transparenca e administratës publike përgjatë procedurave të koncesionit dhe PPP, sjell disa rezultate pozitive, pasi tërheq në procesin e konkurrimit dhe të përzgjedhjes më shumë operatorë ekonomikë, duke ndikuar në rritjen e oportuniteteve, konkurrencën e ndershme, uljen e kostove dhe rritjen e cilësisë së punëve dhe shërbimeve publike. Po kështu transparenca rrit angazhimin dhe besimin e publikut si dhe garanton zbatimin e mekanizmave të verifikimit dhe mbikëqyrjes. Parimi i transparencës gjithsesi kufizohet dhe ndërthuret me respektimin e parimeve të tjerë, siç janë detyrimi për ruajtjen e sekretit shtetëror, interesat e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, mbrojtja e të dhënave personale dhe ruajtja e sekretit tregtar apo pronësisë industriale.

Parimi i mosdiskriminimit lidhet ngushtësisht me parimin e barazisë dhe nënkupton që organet publike duhet të trajtojnë të gjithë palët e përfshira, në mënyrë të barabartë, të drejtë dhe të paanshme. Në asnjë rast administrata publike nuk duhet ti trajtojë ata në mënyrë të diferencuar, veçanërisht për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike,

arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër diferencues.

Parimi i proporcionalitetit përcakton se çdo veprim administrativ, i cili, për shkak të nevojave të interesit publik apo si pasojë e garantimit të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale ose mund të cenojë interesa legjitime, duhet të jetë i përshtatshëm për të arritur qëllimin, deri në masën e nevojshme për të arritur qëllimin, duke u përpjekur të cenojë sa më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës, dhe në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e dikton atë.

Parimi i efikasitetit lidhet me arritjen e rezultateve të suksesshme nga ana e administratës publike. Sipas këtij parimi, procedurat duhet të kryhen sa më mirë, sa më shpejt që të jetë e mundur, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm. Efikasiteti i administratës varet kryesisht nga mënyra e organizimit të punës, duke përfshirë funksionimin e brendshëm, ndarjen e qartë të kompetencave, profesionalizimin e burimeve njerëzore dhe modernizimin e sistemeve të punës.

Parimi i reciprocitetit presupozon një raport midis palëve i cili rregullohet nga marrëdhënie të ndërsjellta dhe ligjore midis tyre. Reciprociteti në marrëdhëniet e partneritetit publik privat lidhet me shkëmbimin në një masë të njëjtë, të barabartë dhe në përpjesëtim të drejtë, të të drejtave dhe detyrimeve, angazhimeve dhe përfitimeve përkatëse.

Parimi i sigurisë ligjore garanton zbatimin korrekt të ligjit nga ana e administratës publike. Sipas këtij parimi, rregullat e vendosura nga ligjet, duhet të jenë të qarta dhe të sakta në mënyrë që individët mund të konstatojnë qartazi dhe pa ekuivok, të drejtat dhe detyrimet që përcaktohen në legjislacion, në mënyrë që të veprojnë në mënyrë korrekte dhe në përputhje me to. Parimi i sigurisë ligjore kërkon një shkallë të mjaftueshme të parashikueshmërisë së dispozitave ligjore, në mënyrë që personat të jenë të mbrojtur nga zbatimi arbitrar i sistemit ligjor nga ana e administratës publike.

## **b) Procedurat ligjore**


Procesi dhe i gjithë cikli i veprimeve të nevojshme në rastet e projekteve të koncesionit dhe të PPP, duhet të kryhet në përputhje me hapat dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni, të cilat duhet të zbatohen përpikmërisht nga aktorët e përfshirë në këtë proces.

E gjithë procedura administrative e zbatueshme në rastet e koncesioneve dhe PPP, ndahet në disa faza, për të cilat zbatohen veprimet konkrete, sipas përcaktimeve ligjore.

Kronologjikisht procesi nis me fazën e identifikimit të një projekti, fazë e cila nis duke u bazuar në një propozim konkret në lidhje me mundësinë e realizimit të një projekti.

Më tej vijohet me fazën e vlerësimit të projektit të propozuar, fazë në të cilën shqyrtohet projekti konkret si dhe kryhet një vlerësim oportuniteti në lidhje me mundësinë e realizimit të projektit të paraqitur. Në rastet kur ka një vlerësim pozitiv të projektit, vijohet me procedurat e dhënies së koncesionit/PPP, të cilat përfshijnë disa faza procedurale, të cilat fillojnë me kryerjen e procedurave konkurruese nëpërmjet tenderit publik dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura nga subjektet private. Në rastet e përfundimit të suksesshëm të procedurave konkurruese, vijohet me lidhjen e kontratës së koncesionit apo PPP. Procedura nuk përfundon me lidhjen e kontratës por përfshin, si një pjesë tejet të rëndësishme, edhe fazën e menaxhimit të kontratës, duke monitoruar zbatimin efektiv të kontratës deri në zbatimin e suksesshëm të projektit. Pas përfundimit të një projekti koncesioni apo PPP, autoriteti kontraktor, në përfundim të kontratës përkatëse, mund të kryejë edhe një vlerësim të mëpasëm ex post, i cili fokusohet tek analiza e rezultateve pozitive dhe negative që ka sjellë zbatimi i kontratës.

Tabela e mëposhtme përshkruan fazat kryesore të procedurës:



Në kapitujt në vijim analizohen në mënyrë kronologjike dhe të detajuar, të gjithë hapat procedurale të cilat duhet të ndiqen, si edhe kompetencat, të drejtat dhe detyrimet përkatëse të cilat janë në ngarkim të autoriteteve kontraktuese, organeve të tjera shtetërore të përfshira dhe të subjekteve private pjesëmarrës në një projekt koncesioni apo PPP.



## KAPITULLI 6

## IDENTIFIKIMI I PROJEKTEVE

I gjithë procesi i procedurave administrative që zbatohen në lidhje me një projekt koncesioni apo PPP, fillon me fazën e identifikimit, e cila nis nëpërmjet paraqitjes tek autoriteti kontraktor, të një propozimi konkret, në lidhje me mundësinë e realizimit të një kontrate koncesioni apo PPP.

**a) Subjektet propozues**

Iniciativa për paraqitjen e një propozimi në lidhje me mundësinë e dhënies së një koncesioni apo PPP, mund të ndërmerret nga disa subjekte. Elementi i përbashkët në të gjitha këto raste është se propozimi duhet të vlerësohet gjithnjë nga autoriteti kontraktor i cili është kompetent për fushën përkatëse.

Së pari, propozimet mund të formulohen nga vetë autoritetet kontraktuese, brenda sferës së tyre të kompetencave. Autoritetet kontraktuese mund të identifikojnë vetë ato projekte, të cilat i konsiderojnë të nevojshme për ti realizuar nëpërmjet kontratave të koncesionit dhe PPP.

Gjithashtu një autoritet kontraktor, mund të marrë në shqyrtim edhe propozime të cilat i përcillen nga organe dhe institucione të tjera publike. Sipas ligjit 125/2013, propozimet mund ti paraqiten një autoriteti kontraktor edhe nga Kryeministria, nga ministritë, qarqet, bashkitë apo nga organe të tjera shtetërore.

Po kështu, projekte koncesioni apo PPP mund ti propozohen autoritetit kontraktor kompetent edhe nga kategori të tjera subjektësh të cilat nuk i përkasin administratës publike. Kështu propozimet mund të vijnë edhe nga institucione apo organizata, vendase apo të huaja, të cilat kanë si objekt të aktivitetit të tyre, veprimtari financiare, zhvillimore apo shkencore.

Së fundmi por jo më pak të rëndësishëm, janë rastet kur propozimet e projekteve të koncesionit apo PPP, i paraqiten autoriteteve kontraktuese nga investitorë të interesuar për të zbatuar një projekt të tillë, në formën e propozimeve të pakërkuara. Këto raste do të trajtohen në vijim, në një seksion të posaçëm.

Në të gjitha rastet e mësipërme, pavarësisht se cili është subjekti propozues, i takon autoritetit kontraktor i cili ka kompetencë ligjore mbi projektin specifik të propozuar, që të kryejë të gjitha veprimet procedurale në lidhje me identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e një koncesioni apo PPP.

**b) Propozimet e identifikuara nga dokumentet e planifikimit apo studimet e organeve publike**

Pavarësisht se cilët mund të jenë subjektet propozues, projekt ideja e një koncesioni apo PPP, mund të vijë si nevojë e përmbushjes së një nevoje,

mangësie apo problematike e cila është identifikuar nga dokumentet e planifikimit në nivel kombëtar, rajonal, vendor apo sektorial. Këto dokumente planifikimi përfshijnë politikat, strategjitë, prioritetet apo planet e miratuara, në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe që i përkasin sektorëve dhe fushave të veprimtarisë në të cilat parashikohet zbatimi i koncesioneve dhe PPP.

Gjithashtu, një projekt i mundshëm mund të identifikohet edhe duke u bazuar në nevojat për zgjidhjen e problematikave të hasura nga autoritetet kontraktuese, të cilat janë evidentuara nga studimet apo analizat e kryera nga vetë organet publike, kryesisht në lidhje me situatën e infrastrukturave, mungesat e shërbimeve ose nevojave për investime.

Prandaj është e domosdoshme që të sigurohet që propozimet e pakërkua janë në përputhje me interesin publik, objektivat afatgjatë të zhvillimit dhe parashikimet ekonomike të sektorit publik dhe për këtë arsye janë subjekt i shqyrtimit të kujdeshëm nga autoriteti kontraktues në fazën e identifikimit, njësoj me propozimet e kërkuara.

Është thelbësore që personat dhe organet që do të preken nga projekti duhet të konsultohen në një fazë të hershme dhe pikëpamjet e tyre të reflektohen në dokumentet e vlerësimit të PPP.

## KAPITULLI 7

## VLERËSIMI I PROJEKTEVE

Në këtë kapitull përshkruhen procedurat që zbatohen nga autoritetet kontraktore, përgjatë fazës së shqyrtimit të projekteve të paraqitura.

**a) Ngritja e komisionit të koncesionit/PPP**

Organi përgjegjës për kryerjen e të gjitha veprimeve në lidhje me identifikimin, vlerësimin dhe dhënien e një projekti koncesioni/PPP, është autoriteti kontraktor i cili rezulton kompetent për objektin e koncesionit/PPP, në përputhje me dispozitat ligjore të përshkruara nga Ligji 125/2013 dhe VKM 575.

Për kryerjen e të gjitha këtyre veprimeve dhe procedurave të sipërpërmendura, autoriteti kontraktor, në bashkëpunim me ATRAKO, emëron një komision të posaçëm dhe të specializuar. Kryerja e veprimeve nëpërmjet një komisioni të posaçëm të autoritetit kontraktor, synon të realizojë dy qëllime kryesore.

Qëllimi i parë lidhet me aspektin procedural, meqenëse synohet që të gjitha procedurat e koncesionit/PPP, qofshin ato të identifikimit, shqyrtimit, analizës dhe të vlerësimit të kryhen nga një strukturë e posaçme, pra nëpërmjet një komisioni të vetëm.

Ky komision duhet të kryejë veprimet për dhënien e koncesionit/PPP, në përputhje me procedurat dhe brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni. Ndryshimet e fundit të legjislacionit, kanë synuar mirë përcaktimin dhe shkurtimin e afateve për kryerjen e procedurave nga ana e komisionit.

Qëllimi tjetër lidhet me synimin që vlerësimi i projekteve të mundshme të kryhet nga një staf i specializuar i cili zotëron ekspertizën e duhur për vlerësimin e koncesioneve dhe PPP. Për këtë arsye, dispozitat ligjore kërkojnë që ky komision të ketë në përbërjen e tij, ekspertët e fushës, në varësi të objektit dhe karakteristikave koncesionit/PPP së propozuar, përfshirë anëtarë që janë me profesion jurist, ekonomist apo teknikë të specializuar.

Për të garantuar një standard të lartë profesionalizmi të komisionit të koncesionit/PPP, autoriteti kontraktues duhet që, përgjatë kryerjes së procedurave për vlerësimin dhe dhënien e koncesionit/PPP, të përfshijë dhe të bashkëpunojë ngushtësisht me ATRAKO, i cili është organi i specializuar për trajtimin e koncesioneve dhe PPP. Për këtë arsye, legjislacioni imponon që komisioni të ketë detyrimisht në përbërjen e tij, jo më pak se dy anëtarë të cilët i përkasin stafit të ATRAKO. Në rastet e ngritjes së një komisioni, autoriteti kontraktues i adreson ATRAKO një kërkesë për caktimin e anëtarëve të saj, e cila duhet të përmbajë edhe informacionin e detajuar për projektin.

Për lehtësim të vendimmarrjes dhe organizimit të brendshëm të komisionit, komisioni duhet të ketë një numër tek anëtarësh dhe të ketë në total një

numër prej jo më pak se 5 anëtarësh. Në rastet e projekteve të ngjashme, në objekt dhe në natyrë, shqyrtimi i tyre mund të kryhet nga një komision i vetëm.

Autoriteti kontraktues duhet të tregojë një kujdes të posaçëm gjatë përcaktimit të anëtareve të komisionit dhe kryetarit pasi ky proces kërkon nivel të lartë profesionalizmi dhe përfaqësimi në hierarkinë e administratës publike. Për këtë arsye këshillohet që të përfshihen si anëtarë komisioni funksionarë të lartë të institucionit dhe gjithashtu specialiste të fushave në të cilat do të zhvillohet projekti.

Dokumentimi i të gjithë veprimtarive të komisionit duhet të pasqyrohet në procesverbalet përkatëse, në të cilat përshkruhen aktivitetet dhe detyrat e kryera, të cilat duhet të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Me qëllim shmangjen e konflikteve të mundshme të interesit, duhet që si anëtarë të komisionit të përzgjidhen persona të cilët nuk kanë asnjë lloj interesi të lidhur me ushtrimin e detyrave të komisionit në lidhje me projektin, subjektet dhe veprimtaritë e lidhura me të. Për këtë arsye, anëtarët e komisionit duhet që, në përputhje me detyrimet ligjore të parashikuara nga legjislacioni për shmangjen e konfliktit të interesit, duhet të nënshkruajnë paraprakisht, nën përgjegjësinë e tyre të plotë ligjore, një deklaratë që garanton se ata nuk kanë konflikt interesi<sup>3</sup> në lidhje me projektin e shqyrtuar.

Në rastet e shqyrtimit të projekteve të cilat kërkojnë një nivel të lartë ekspertize në fusha të caktuara, sipas karakteristikave të projekteve specifike legjislacioni i njeh mundësinë autoritetit kontraktor që të angazhojë edhe konsulentë dhe ekspertë të jashtëm.

#### **b) Procedurat e shqyrtimit të propozimeve nga komisioni**

Paraprakisht, komisioni duhet të verifikojë që projekti i propozuar plotëson kriteret minimale të kërkuara nga ligji, pra që;

---

<sup>3</sup> Sipas parashikimeve në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar

- ti përkasë njërit prej sektorëve të përcaktuar nga legjislacioni për koncesionet dhe PPP;
- të ketë një vlerë investimi e cila e tejkalon kufirin e ulët monetar;
- të verifikojë se projekti nuk përfshihet në një nga rastet përjashtimore sipas ligjit, si dhe:
- të verifikojë që projekti nuk mbivendoset me projekte që janë realizuar apo janë në zbatim.

Në rastet kur propozimet i plotësojnë këto kritere minimale, vijohet me shqyrtimin e projekteve nga ana e këtij komisioni.

Për ushtrimin e kompetencave që i jep ligji, komisioni kryen detyrat e mëposhtme;

- i. përgatit një raport përmbledhës në lidhje me idenë e projektit;
- ii. harton studimin e fizibilitetit;
- iii. përcakton llojin e procedurës së zbatueshme përgjatë tenderit;
- iv. harton dokumentacionin e tenderit;
- v. vlerëson ofertat ose kërkesat për pjesëmarrje të paraqitura;
- vi. i propozon autoritetit kontraktor, përzgjedhjen e ofertës së konsideruar si të suksesshme ose ndërprerjen e procedurës së prokurimit, shoqëruar me një shpjegim arsyetues të këtyre propozimeve;

Në vijim përshkruhen në mënyrë të detajuar veprimet konkrete që duhet të kryejë komisioni, për ushtrimin e detyrave të tij, përgjatë fazës së vlerësimit të projekteve të koncesionit apo PPP.

- i. Raporti përmbledhës mbi projekt idenë e propozimit

Komisioni ka për detyrë që të kryejë fillimisht një verifikim paraprak të projekt – idesë së propozimit të paraqitur. Bazuar në rezultatet e këtij vlerësimi paraprak, komisioni përgatit një raport përmbledhës në lidhje me mundësinë e realizimit të projektit. Ky raport përmbledh informacionet e nevojshme të cilat

lidhen veçanërisht me domosdoshmërinë e realizimit të projektit, me përshtatshmërinë e vënies në jetë të idesë së projektit si edhe konsideron mundësitë dhe alternativat për realizimin e tij.

Raporti duhet të përmbajë në brendësinë e tij, të paktën këto elementë thelbësore;

- përshkrimin e situatës aktuale të sektorit në të cilin paraqitet projekti, i cili identifikon dhe vlerëson mangësitë dhe nevojat për zhvillim;
- parashikimet afatmesme dhe afatgjata për sektorin specifik;
- përshkrimin e përgjithshëm të projektit të paraqitur;
- identifikimin e bazës ligjore që disiplinon objektin e investimit të propozuar;
- natyrën e funksionit institucional që kërkohet të kryhet nga partneri privat;
- përshkrim të pronave shtetërore të cilat propozohet të përfshihen në projekt dhe të përdorimit aktuale të tyre;
- identifikimin dhe vlerësimin e përfitimeve strategjike dhe operacionale të cilat parashikohet të realizohen nga zbatimi i projektit të paraqitur;
- bashkërendimin e projektit me politikat e përgjithshme të investimeve sektoriale apo rajonale;
- parashikimin e skenarëve teknikë dhe ekonomikë për zbatimin e projektit;
- vlerësimin paraprak të kostove dhe të qëndrueshmërisë financiare të projektit;
- analizën paraprake financiare dhe/ose ekonomike;
- alternativat e alokimit të rrezikut financiar, teknik dhe operacional ndërmjet parterit publik dhe partnerit privat;
- rekomandime në lidhje me metodat e zbatimit dhe modelet e zbatueshme;

në rastet e propozimeve të pakërkuara, vlerësimin në lidhje me dhënien apo jo të bonusit në favor të subjektit propozues si të përqindjes së pikëve të këtij bonusi.

Pas hartimit të këtij raporti mbi projekt idenë e propozimit, komisioni i koncesioneve/PPP, e përcjell këtë raport për shqyrtim tek autoriteti kontraktor kompetent. Autoriteti kontraktor, bazuar në informacionin e raportit përmbledhës të hartuar nga komisioni i koncesionit/PPP, merr një vendim në lidhje me projektin e shqyrtuar.

Autoriteti, pas shqyrtimit të raportit përmbledhës mund të zgjedhë një të prej alternativave të mëposhtme;

- refuzimin e zbatimit të projektit;
- Vendimi i autoritetit kontraktor për refuzimin e zbatimit të projektit zakonisht lidhen me një vlerësim negativ të projektit në diskrecion të vetë autoritetit. Ky refuzim mund të varet nga disa shkaqe dhe arsye të ndryshme, të cilat mund të jenë vlerësime negative, për shembull të ligjshmërisë, përshtatshmërisë, interesit publik, fizibilitetit dhe leverdisë së projektit.
- shtyrjen e zbatimit të projektit;
- Autoriteti kontraktor mund të ndërpresë dhe të shtyjë zbatimin e një projekti, si pasojë e arsyeve të ndryshme të vlerësuara prej tij. Këto arsye mund të lidhen me pamundësinë apo vështirësinë e autoritetit kontraktor për të venë në zbatim projektin në periudhën në të cilën është shqyrtuar ky propozim, me nevojën për integrimin e projektit me informacione, të dhëna apo elementë të cilët nuk janë të disponueshme për momentin, apo për arsye se projekti nuk konsiderohet si i nevojshëm për momentin, si pasojë e prioriteteve të tjera të autoritetit kontraktor.
- kthimin për plotësim të propozimit të pakërkuar
- Propozimi i pakërkuar i kthehet për plotësim subjektit propozues në rastet kur nuk plotëson kushtet minimale të kërkuara nga neni 10 i VKM 575. Sipas kësaj dispozite, për tu shqyrtuar nga autoritetet kontraktuese kompetente, propozimet e pakërkura duhet të plotësojnë këto kritere minimale:
- projekti i propozuar, duhet ti përkasë sektorëve në të cilat legjislacioni lejon mundësinë e zbatimit të koncesioneve dhe PPP;
- propozimi i paraqitur nuk duhet të lidhet me një projekt, për të cilin në momentin e paraqitjes së propozimit, ka filluar ose është shpallur një procedurë koncesioni/PPP;
- propozimi i pakërkuar duhet ti dorëzohet autoritetit kontraktues i cili është kompetent sipas ligjit;

- propozimi i pakërkuar duhet të paraqitet në format e kërkuara nga ligji, pra ose në formën e zhvilluar<sup>4</sup> ose me studimin e plotë të fizibilitetit.
- Me qëllim plotësimin e propozimit të pakërkuar, subjektit propozues i garantohet një afat prej 30 ditësh, i cili fillon nga data e kthimit të propozimit nga autoriteti kontraktor.
- vijimin e procedurave për zbatimin e projektit.
- Në rastet kur autoriteti kontraktor vlerëson pozitivisht projektin e paraqitur, atëherë ky autoritet merr një vendim për vijimin e procedurave ligjore për zbatimin e projektit.
- Procedurat e mëtejshme për zbatimin e projektit ndiqen nga i njëjti komision i krijuar për vlerësimin e projektit të paraqitur. Ndaj, pas përfundimit të raportit përmbledhës nga ana e komisionit të koncesionit/PPP, në rastet kur autoriteti kontraktor ka marrë një vendim pozitiv në lidhje me vazhdimin e procedurave për zbatimin e projektit të paraqitur, komisioni vijon punën e tij duke kryer veprimet e mëtejshme të parashikuar nga legjislacioni, të cilat detajohen në vijim.
- Studimi i fizibilitetit
- Veprimi kronologjik i mëtejshëm përgjatë procedurave të vlerësimit të një projekti koncesioni/PPP, është hartimi i studimit të fizibilitetit të projektit të paraqitur.
- Hartimi i studimi i fizibilitetit, nga ana e komisionit, ka si qëllim si që të vendosë në dispozicion të autoritetit kontraktor, një dokument i cili përmban një analizë të të gjitha aspekteve përbërës të një projekti të propozuar, në mënyrë që autoriteti kontraktor, duke u bazuar mbi rezultatet e këtij studimi, të ketë mundësi të marrë një vendim, pozitiv apo negativ, në lidhje me angazhimin ose jo nga ana e tij, në projektin konkret.
- Për sa i përket formës dhe elementëve përbërës të tij, studimi i fizibilitetit hartohet bazuar në modelin dhe sipas formularit standard të hartuar dhe të publikuar nga ATRAKO në faqen zyrtare të saj.
- Në nivel praktik, për sa i përket përmbajtjes së tij, studimi i fizibilitetit është një dokument i cili përmban një analizë të plotë të projektit dhe një vlerësim të mëtejshëm të tij, i cili shqyrton në mënyrë të detajuar, informacionet dhe të dhënat e përmbajtura në raportin përmbledhës të komisionit.

Së pari, studimi i fizibilitetit duhet të vlerësojë aspektet e përgjithshme, të cilat lidhen me vlerësimin e faktit nëse ka apo jo interes publik për realizimin e një projekti konkret.

Studimi i fizibilitetit duhet të vlerësojë nëse projekti harmonizohet me objektivat kombëtarë dhe sektorialë strategjikë të përcaktuar në dokumentet e

---

<sup>4</sup> Sipas kritereve të përcaktuara në nenin 11 të VKM 575



planifikimit, të tillë si politika, strategji apo plane të miratuara nga qeverisja qendrore apo vendore;

Gjithashtu, studimi i fizibilitetit duhet të identifikojë karakteristikat kryesore të projektit të shqyrtuar, të cilat duhet të shoqërohen me një analizë të thelluar të elementëve përbërës, të cilat përfshijnë aspektet teknike, ekonomike dhe financiare, si dhe ndikimin mjedisor e social të projektit.

Së fundmi studimi duhet të japë një vlerësim të arsyetuar, bazuar në analizimin e faktit nëse projekti i shqyrtuar, është ekonomikisht më i favorshëm për tu realizuar në formën e një koncesioni/PPP, krahasuar me alternativën tradicionale të prokurimit publik apo me mekanizma të tjerë alternativë.

- Afatet për hartimin e studimit të fizibilitetit.

Ndryshimet e fundit të zbatuara në legjislacionin e koncesioneve/PPP, kanë synuar të përcaktojnë afate të qarta dhe të shkurtojnë procedurën e shqyrtimit të projekteve. Si pasojë e këtyre dispozitave<sup>5</sup>, studimi i fizibilitetit duhet të hartohet nga komisioni i koncesionit/PPP, brenda një afati prej 60 ditësh pune, i cili nis nga data e krijimit të komisionit. Në rastet kur projekti i shqyrtuar rezulton të jetë kompleks, ky afat 60 ditor mund të zgjatet, deri në një maksimum prej 30 ditë pune shtesë.

Përrjashtimisht, nëse objekti i koncesionit/PPP është hidrocentral, afatet e mësipërme fillojnë nga data e marrjes së oponencës teknike shtetërore nga strukturat përgjegjëse të ngarkuara për të bërë këtë oponencë.

- Përmbajtja e studimit të fizibilitetit.

Për sa i përket përmbajtjes së tij, studimi i fizibilitetit duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm;

---

<sup>5</sup> Neni 4 i VKM 575, i ndryshuar me VKM nr. 313, datë 27.04.2016

- një përshkrim të përgjithshëm të projektit të shqyrtuar;
- përmbledhjen e fazave operacionale të nevojshme për realizimin e tij;
- analizën e detajuar teknike;
- analizën e detajuar financiare dhe ekonomike;
- analizën e detajuar ligjore;
- ndikimet mjedisore dhe sociale;
- konkluzionet dhe rekomandimet e komisionit në lidhje me projektin e shqyrtuar.

Të dhënat e detajuara të cilat duhet të përmbajë studimi i fizibilitetit, metodologjia që duhet përdorur dhe sqarimet të tjera të nevojshme, detajohen më hollësisht në aneksin përkatës, bashkëlidhur këtij manuali.

Gjithnjë në formën e një aneksi i është bashkëlidhur këtij manuali edhe një model studimi fizibiliteti i hartuar nga ATRAKO, i cili mund ti shërbejë autoriteteve kontraktuese si shembull për hartimin studimeve të fizibilitetit nga ana e tyre, për vlerësimin e projekteve të koncesionit dhe PPP.

Legjislacioni i kushton një vëmendje të posaçme dhe ka detajuar me anë të dispozitave specifike, disa elementë kryesorë përbërës të studimit të fizibilitetit, të cilat janë respektivisht; analiza teknike, analiza financiare dhe ekonomike dhe ndikimi mjedisor dhe social.

- Analiza teknike.

Për sa i përket analizës teknike e cila duhet të jetë pjesë e studimit të fizibilitetit, dispozitat e posaçme<sup>6</sup> përcaktojnë se qëllimi i këtij dokumenti është që të vlerësojë dhe të demonstrojë nëpërmjet analizës së detajuar, se projekti i shqyrtuar, mund të zbatohet duke përdorur teknologjitë e propozuara dhe pa rreziqe të paarsyeshme teknike.

- Ndikimi mjedisor dhe social.

Një nga elementët e rëndësishëm të studimit të fizibilitetit, lidhet me identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit. Për këto qëllime, analiza e ndikimeve mjedisore dhe sociale duhet të identifikojë ndikimet, pasojat dhe efektet e mundshme, me pasoja negative, alteruese apo

---

<sup>6</sup> Neni 5 i VKM 575

dëmtuese në mjedis si edhe masat përkatëse për zbutjen apo shmangjen e këtyre pasojave.

Analiza duhet të integrohet gjithashtu edhe me identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve sociale që mund të shkaktojë projekti tek territori dhe popullata.

- Analiza financiare dhe ekonomike.

Qëllimi i analizës ekonomike dhe financiare është që të përcaktojë “vlerën e parasë” së projektit, pra të përcaktojë nëse autoriteti kontraktues merr përfitimet maksimale të mundshme nga një projekt partneriteti publik privat. Si vlerë e parasë së projektit, nuk konsiderohet vetëm vlera e punëve apo e shërbimeve publike të një projekti por vlerësohen edhe elementë të tjerë ekonomikë dhe financiarë të projektit, të cilët përfshijnë cilësinë, koston, shfrytëzimin e burimeve, përshtatshmërinë me qëllimin dhe objektivin e kontratës dhe kohën e nevojshme për realizimin e tij. Vlerësimi përfundimtar i analizës financiare dhe ekonomike, shërben për të vendosur nëse të gjitha këto elemente të kombinuara përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit përbëjnë vlerën më të mirë ekonomike.

**Analiza financiare dhe ekonomike përbëhet nga këto elementë kryesore;**

- Kostot e drejtpërdrejta të investimeve
- Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes
- Kostot e drejtpërdrejta operative
- Kostot indirekte të projektit
- Të ardhurat e projektit
- Realizueshmëria ekonomike e projektit
- Përballueshmëria
- Përshtatshmëria financiare
- Analiza e rrezikut
- Analiza e ndjeshmërisë
- Vlerësimi i modelit për zbatimin e projektit; PP apo PPP.
- Rezultatet e pritshme të studimit të fizibilitetit

Rezultatet e studimit të fizibilitetit janë tepër të rëndësishme për autoritetin kontraktor, pasi ky dokument shërben si dokumenti bazë për të vlerësuar nëse një projekt konkret duhet të zbatohet apo jo. Për më tepër, sic do të shohim edhe në vijim, rezultatet e studimit të fizibilitetit do të shërbejnë si elementët identifikues për hartimin e kontratës së koncesionit apo PPP që do të disiplinojë realizimin e projektit. Për pasojë hartimi i një studimi i fizibiliteti të plotë do të ndikojë edhe rezultatet e autoritetit kontraktor edhe përgjatë fazës së zbatimit të projektit dhe menaxhimit e monitorimit të kontratës.

Si përfundim, bazuar në informacionin, analizat dhe veprimet e mësipërme, studimi i fizibilitetit, duhet të jetë një dokument i aftë që të tregojë dhe të arsyetojë nëse;

- projekti është i përshtatshëm dhe i nevojshëm për autoritetin kontraktues;
- projekti është i realizueshëm, nga na teknike, ekonomike, financiare dhe tregtare;
- projekti nuk ka ndikim negativ social dhe mjedisor;
- alternativa e koncesionit/PPP është më e dobishme krahasuar me mekanizma të tjerë;

Gjithashtu studimi i fizibilitetit duhet të përmbajë këto elementë kryesorë;

- të përcaktojë llojin dhe objektin e koncesionit/PPP që do të zbatohet;
- të vlerësojë rreziqet e drejtpërdrejta financiare të projektit dhe ndikimin në buxhetin e qeverisjes qendrore dhe vendore;
- të përcaktojë vlerën e parashikuar të kontratës;
- të përcaktojë kohëzgjatjen e propozuar të kontratës;
- të përmbledhë informacionet që duhet të përfshihen në dokumentet e tenderit.

Vetëm në rastet kur, si pasojë e rezultateve të studimit të fizibilitetit vërtetohet se projekti i përmbush të gjitha këto kushte dhe arrihet në një vlerësim pozitiv të tij, atëherë mund të vijohet me procedurën për dhënien e koncesionit/PPP nga ana e autoriteti kontraktor.

## KAPITULLI 8

## PROPOZIMET E PAKËRKUARA TË KONCESIONEVE/PPP

**a) Paraqitja e propozimeve të pakërkuara**

Propozimet e projekteve të koncesionit apo PPP, mund t'i paraqiten autoriteteve kontraktuese edhe nga subjekte private, të cilët janë të interesuar të përfshihen në realizimin një koncesioni apo PPP, në cilësinë e partnerit privat, në formën e propozimeve të pakërkuara.

Edhe në këto raste, propozimet duhet ti paraqiten autoritetit kontraktor i cili ka kompetencën ligjore mbi projektin specifik të propozuar. Autoritetet kontraktuese përpara se të vlerësojnë propozimet e pakërkuara, duhet të verifikojnë plotësimin e kushteve minimale të kërkuara nga ligji, në përputhje me përcaktimet e nenit 10 të VKM 575.

Së pari autoritet duhet të verifikojnë nëse propozimi i pakërkuar që është paraqitur, bën pjesë në sektorët për të cilat legjislacioni parashikon mundësinë e kryerjes së procedurave të koncesioneve dhe PPP, në veçanti sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 5 të Ligjit 125/2013.

Megjithatë në raste të veçanta, legjislacioni i njeh mundësinë autoriteteve kontraktuese, që nëse e konsiderojnë të arsyeshme dhe të nevojshme, ti propozojnë Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrisë së linjës për fushën e veprimtarisë së një projekti, që të miratojë zbatimin e projekteve koncesionare apo PPP, edhe në sektorë të tjerë, përveç atyre të parashikuar shprehimisht nga ligji. Në këtë rast, miratimi i Këshillit të Ministrave për kryerjen e procedurave të koncesionit apo PPP, për një projekt që nuk përfshihet në sektorët e përcaktuar nga ligji, duhet të jepet nëpërmjet një vendimi të posaçëm.

Më tej, autoritetet kontraktuese duhet të verifikojnë nëse propozimi i pakërkuar lidhet me ndonjë projekt koncesioni apo PPP, për të cilin kanë nisur apo janë shpallur ndërkohë, procedurat ligjore përkatëse.

Përveç këtij kontrolli paraprak, autoritetet kontraktuese duhet të verifikojnë edhe plotësimin e kushteve në lidhje me formën e propozimeve të pakërkuara. Këto propozime mund të paraqiten nga subjektet private të trajtuara në njërin prej dy formave të mëposhtme;

- i. propozim i pakërkuar me analizat teknike ekonomike dhe financiare<sup>7</sup>

Propozimi i pakërkuar në formë të zhvilluar, përmban një sërë analizash teknike, ekonomike dhe financiare, sipas përcaktimeve të nenit 11 të VKM 575. Në mënyrë të detajuar, propozimi i paraqitur në këtë formë duhet të përmbajë;

---

<sup>7</sup> Sipas kërkesave të nenit 11 të VKM 575.

- përshkrimin e situatës aktuale, i cili duhet të përshijë edhe identifikimin e nevojave, mangësive dhe të metave, të analizojë kontekstin e zhvillimit dhe, në rastet kur konsiderohet e përshtatshme, të përshkruajë një panoramë të tregut;
- parashikimet afatmesme dhe afatgjata të nevojave specifike;
- përshkrimin e përgjithshëm të projektit të propozuar;
- përfitimet strategjike dhe operacionale që priten nga projekti;
- bashkërendimin me politikat e investimeve të përgjithshme, sektoriale apo rajonale;
- analizën teknike;
- ndikimet mjedisore dhe sociale;
- analizën ekonomike dhe financiare.

Analizat teknike, ndikimet mjedisore dhe sociale dhe analiza ekonomike dhe financiare duhet të hartohen në përputhje me dispozitat e neneve 5, 6 dhe 7 të VKM 575, siç janë përshkruar më sipër në seksionin përkatës.

ii. propozim i pakërkuar në formë të zhvilluar plotësisht

Në këtë rast, propozimi i pakërkuar duhet të përmbajë një studim fizibiliteti të zhvilluar plotësisht, i cili duhet të përshijë edhe arsyetimin e vendimit për dhënien me koncesion/PPP. Ky studim fizibilitetit duhet të hartohet dhe të përmbajë të gjithë elementët e kërkuara nga legjislacioni, siç janë përshkruar më sipër në Kapitullin 7 të këtij manuali.

**b) Procedura e shqyrtimit të propozimeve të pakërkua**

Në mënyrë analoge me procedurën e vlerësimit të projekteve të koncesionit dhe PPP, të përshkruar në Kapitullin 7, autoriteti kontraktor dhe ATRAKO, krijojnë një komision të posaçëm, i cili zbaton detyrat dhe ndjek procedurat ligjore.

Edhe përgjatë vlerësimit të propozimeve të pakërkua, komisioni duhet të hartojë raportin përmbledhës në lidhje me projektin specifik. Raporti përmbledhës duhet të përcaktojë verifikimin e elementëve të mëposhtëm;

- objektivat e projektit janë të përcaktuar qartë dhe të duken të realizueshëm;

- objektivat e projektit i shërbejnë interesit publik dhe përshtaten brenda prioriteteve strategjike të autoritetit kontraktues;
- nuk ka pengesa ligjore ose kufizime për zbatimin e projektit dhe/ose për të hyrë në një kontratë koncesioni/PPP;
- projekti mund të zbatohet siç është planifikuar, duke përdorur teknologjitë e propozuara dhe pa rreziqe të paarsyeshme teknike;
- projekti paraqet qëndrueshmëri ekonomike;
- projekti është në gjendje të tërheqë garantuesit/mbështetësit financiarë, duke siguruar kthimin e arsyeshëm financiar;
- niveli i propozuar i alokimit të rrezikut midis partnerit publik dhe privat është racional dhe i arsyeshëm;
- (nëse kërkohet) mbështetja e duhur financiare mund të përshtatet brenda buxhetit të kufizuar dhe detyrimeve të tjera fiskale.

Përgjatë periudhës së përgatitjes së raportit përmbledhës, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga propozuesi informacione shtesë me qëllim plotësimin e raportit.

Bazuar në vlerësimet e raportit përmbledhës të hartuar nga komisioni, autoriteti kontraktues vendos refuzimin e propozimit të pakërkuar, kthimin për plotësim të propozimit të pakërkuar ose pranimin e propozimit, sipas përcaktimeve të Kapitullit 7.

Në të gjitha këto raste, vendimet e autoritetit kontraktues i komunikohen me shkrim subjekteve të cilët kanë paraqitur propozimet e pakërkua.

Në rastet kur autoriteti kontraktor vendos pranimin e propozimeve të pakërkua, vijon procedurën, nëpërmjet hartimit të studimit të fizibilitetit. Për hartimin e tij, komisioni i koncesionit/PPP mund të përdorë informacionet e përmbajtura në propozimin e pakërkuar, por me kushtin që të ketë verifikuar me kujdes që informacioni, të dhënat, hipotezat, supozimet, zgjidhjet, treguesit, analizat dhe rezultatet e propozimit të pakërkuar janë të sakta, të zbatueshme dhe të përshtatshme për zbatimin e projektit. Pavarësisht nga të dhënat e paraqitura nga subjekti privat në propozimin e pakërkuar, studimi i fizibilitetit duhet të konsiderohet si një produkt i cili konsiderohet si i autoritetit kontraktor.

Studimi i fizibilitetit duhet të hartohet në përputhje me kërkesat ligjore, sipas përcaktimeve të Kapitullit 7 dhe duhet të rezultojë në një dokument të plotë i cili duhet të tregojë se;

- projekti është i përshtatshëm, i nevojshëm, dhe përmbush kërkesat dhe politikat e autoritetit kontraktor;
- projekti është i realizueshëm, në aspektin e realizueshmërisë teknike, ekonomike dhe tregtare;
- projekti nuk ka ndikim negativ social dhe mjedisor;
- dhënia e kontratës me koncesion/PPP është ekonomikisht më e favorshme se dhënia e saj me prokurim publik apo me mekanizma të tjerë.

Afati për përfundimin e studimit të fizibilitetit, në rastin e propozimeve të pakërkuara janë të njëjta me procedurën e sipërpërmendur, pra 60 ditë pune nga data e krijimit të komisionit të koncesionit/PPP, afat i cili mund të shtyhet deri në 30 ditë pune për shkaqe të kompleksitetit të projektit.

Autoriteti kontraktues bazuar në studimin e fizibilitetit llogarit vlerën e parashikuar të projektit si vlerë totale e objektit të koncesionit/partneritetit publik privat, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e mundshme dhe opsionet e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, pa vlerën e TVSH-së.

Vlera e parashikuar e partneritetit publik privat llogaritet sipas përcaktimeve në legjislacionin e prokurimit publik.

Bazuar në rezultatet e studimit të fizibilitetit, nëse vërtetohet se projekti i përmbush të gjitha këto kushte dhe arrihet në një vlerësim pozitiv të tij, atëherë autoritetet kontraktuese mund të vijojnë me procedurën për dhënien e koncesionit/PPP.

Analogjikisht, edhe në rastin e propozimeve të pakërkuara, nëse kërkohet mbështetje financiare për realizimin e projektit, autoritetet kontraktuese përcjellin projektin për miratim në Ministrinë e Financave.

Në rastet kur pranohet një propozim i pakërkuar dhe vijohet me procedurat për dhënien e koncesionit apo PPP, subjekti privat propozues duhet ti nënshtrohet procedurave konkurruese të tenderimit, të cilat duhet të zhvillohen nëpërmjet një procesi transparent dhe diskriminues dhe në të cilat duhet të ftohen, njoftohen dhe përfshihen, në mënyrë që të marrin pjesë dhe të paraqesin oferta, edhe subjekte të tjerë privatë, të cilët janë të interesuar për zbatimin e projektit konkret.



## KAPITULLI 9

## PROJEKTET QË KËRKOJNË MBËSHTETJE FINANCIARE

## a) Miratimi paraprak i Ministrisë së Financave

Projektet e koncesionit/PPP, të cilat janë shqyrtuar nga autoritetet kontraktuese dhe kanë marrë një vlerësim pozitiv prej tyre, pavarësisht nëse janë propozime të kërkuara apo të pakërkuara, përpara se të fillojnë procedurat e dhënies së koncesionit/PPP, duhet të marrin miratimin paraprak të Ministrisë së Financave, në rastet kur kanë nevojë për mbështetje financiare. Pra autoritetet kontraktuese kërkojnë miratimin nga Ministria e Financave në rastet ku është përcaktuar në studimin e fizibilitetit që projekti ka nevojë për mbështetje financiare, përpara shpalljes së njoftimit të kontratës për dhënien me koncesion/PPP

Sipas përkufizimit ligjor, mbështetje financiare konsiderohet lloji i mbështetjes monetare ose jo monetare dhe/ose financimi i dhënë nga sektori publik, duke përfshirë, por pa u kufizuar, subvencione, garanci financiare apo të tjera, kontribute kapitale dhe transferimin e të drejtave të pronësisë.

Miratimi paraprak i Ministrisë së Financave lidhet me vlerësimin e aspekteve fiskale të projektit, të tilla si: përbalueshmëria, qëndrueshmëria dhe fizibiliteti fiskal në lidhje me ndikimet dhe rreziqet fiskale të menjëhershme dhe urgjente të projektit.

Kërkesa për mbështetje financiare i paraqitet Ministrisë së Financave, bazuar në përfundimet e studimit të fizibilitetit të hartuar nga autoriteti kontraktor. Për këtë qëllim autoriteti kontraktor i dorëzon ministrisë studimin e fizibilitetit të kryer dhe si draftin e kontratës për zbatimin e koncesionit/PPP. Studimi i fizibilitetit duhet të jetë i zhvilluar plotësisht, dhe duhet të përfshijë arsyetimin e vendimit për dhënien me koncesion/PPP, analizat e rrezikut, informacionin për projektet ekzistuese të koncesioneve/PPP dhe të angazhimeve buxhetore që rrjedhin prej tyre. Në përputhje me përcaktimet e VKM 575, përpara se të kërkohet miratimi nga MF, AK duhet të verifikojë që kostot e projektit janë në përputhje me planifikimet buxhetore të vitit si edhe me parashikimet afat mesme të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Në rastet kur konsiderohet e nevojshme dhe kur ky informacion disponohet nga autoriteti kontraktor, Ministria e Financave mund të kërkojë informacion shtesë. Kryesisht informacioni shtesë që mund të kërkohet lidhet me;

- projektet, dokumentacionin apo përshkrimet e kontratës;

- kërkesat e subjektit për qëllime të veçanta;
- blerjen dhe transferimet e të drejtave të pronësisë, të pasurive, të drejtave pasurore apo të drejtave të tjera reale;
- standardet e shërbimit dhe të mirëmbajtjes;
- mekanizmat e përlogaritjes së tarifës së disponueshmërisë;
- kërkesat në lidhje me sigurimet;

Kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues duhet të dorëzohen në formë të shkruar dhe në formë elektronike (CD apo forma të ngjashme me të).

Ministria e Financave verifikon dokumentacionin e dorëzuar dhe nëse verifikon mangësi, mund të kërkojë plotësimin e tij.

Gjithashtu, në rastet kur projekti është hartuar me asistencën e ATRAKO apo të ekspertëve të jashtëm, Ministria e Financave, mund të kërkojë nëpërmjet autoritetit kontraktues, mendimin e tyre në lidhje me çështje të caktuara të projektit, të cilat kanë rëndësi për analizën që duhet të kryejë kjo ministri.

#### **b) Procedura e vlerësimit të kërkesave**

Ministria e Financave i shqyrton kërkesat për mbështetje financiare duke kryer analizën dhe vlerësimet e saj, në përputhje me dispozitat e legjislacionit sektorial të koncesioneve/PPP. Analiza e projekteve nga ana e Ministrisë së Financave bazohet tek të dhënat e studimit të fizibilitetit dhe fokusohet tek aspektet e mëposhtëm;

- vlerësimi në lidhje me ndikimet e menjëhershme dhe të mundshme fiskale për qëllimet e vlerësimit të përbalueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së tyre, si dhe për qëllime të buxhetimit të detyrimeve dhe angazhimeve të tilla, kur është e përshtatshme;
- përcaktimi i përbalueshmërisë fiskale, në lidhje me pajtueshmërinë e mbështetjes së parashikuar financiare (alokimet buxhetore), duke përfshirë rreziqet, me tavanet e buxhetit/borxhit të përcaktuara nga rregullat e buxhetit;
- përcaktimi i qëndrueshmërisë dhe fizibilitetit fiskal, në lidhje me projeksionet afatgjata (fluksin e parasë) dhe parashikimet (makroekonomike) të kapacitetit buxhetor dhe aftësinë për të përkrahur shërbimin e mbështetjes financiare dhe angazhimet e tjera kontraktore të parashikuara nga projekti;
- analiza e rreziqeve, kryesisht ato që merren përsipër plotësisht ose pjesërisht nga autoriteti kontraktues, për qëllimin e vlerësimit të probabilitetit të ndodhjes së tyre dhe të kostove, si dhe në lidhje me përmbushjen e kërkesave për trajtim jashtë bilancit, nëse është e përshtatshme.

Rezultatet e këtyre analizave, i shërbejnë Ministrisë së Financave dhe përgjatë procesit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor, meqenëse kjo ministri, duhet të mbajë në konsideratë kufirin maksimal të totalit të detyrimeve të drejtpërdrejta, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në pagesat e tarifave të disponueshmërisë së partneritetit publik privat, të cilat mund të vendosen në nivel vendor dhe qendror.

#### **c) Afatet për vlerësimin e kërkesave**

Afati për dhënien ose jo të miratimit paraprak për mbështetje financiare nga ana e Ministrisë së Financave, është jo më vonë se 40 ditë nga data e marrjes së dokumentacionit të plotë, i cili mund të zgjatet me 15 ditë në rastet kur ministria i drejton autoritetit kontraktor një kërkesë për plotësimin apo shpjegimin e dokumentacionit.

#### **d) Vendimet e Ministrisë së Financave**

Në përfundim të procesit të vlerësimit, Ministria merr një vendim i cili mund të jetë miratim ose refuzim i projektit të paraqitur. Vendimet e ministrisë duhet të jenë të argumentuara.

Ministria e Financave miraton projektet e paraqitura në rastet kur shuma e parashikuar dhe mënyra e pagesës së mbështetjes financiare janë të përballueshme dhe të qëndrueshme. Projektet e miratuara, publikohen në faqen e internetit të ministrisë, brenda 20 ditësh nga dhënia e miratimit. Projektet konsiderohen të miratuara në heshtje në rast se Ministria e Financave nuk e merr vendimin brenda afateve ligjore të mësipërm.

Ministria e Financave refuzon kërkesat dhe kundërshton projektet, nëse shuma e parashikuar dhe mënyra e pagesës së mbështetjes financiare të projektit janë të papërballueshme dhe/ose të paqëndrueshme ose, nëse mundësia e rreziqeve të ndërmarra nga partneri publik, në projekt, janë të tilla që rrezikojnë në mënyrë të konsiderueshme përballueshmërinë dhe/ose qëndrueshmërinë e projektit. Projektet e refuzuara mund t'i nënshtrohen ndryshimeve të nevojshme dhe të paraqiten përsëri për miratim në Ministrinë e Financave.

## KAPITULLI 10

## PROCEDURAT KONKURRUESE PËR PARTNERITETET PUBLIKE PRIVATE

Siç u përshkrua më kapitullin e mëparshëm, në rastet kur në përfundim të procedurës së shqyrtimit të propozimeve të PPP, autoriteti kontraktor e vlerëson pozitivisht projektin, atëherë vijohet me procedurën për dhënien e PPP.

Procedura për dhënien e PPP parashikon kryerjen e një tenderi publik, në të cilin ftohen të konkurrojnë shoqëritë tregtare të cilat janë të interesuara për zbatimin e një projekti PPP.

Përgjatë zhvillimit të procedurave të tenderit, procedurat specifike bazohen në dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik, me përjashtim të atyre rasteve kur parashikohet ndryshe në legjislacionin për koncesionet dhe PPP. Pra si në rastet kur një autoritet kontraktor kërkon të realizojë një kontratë partneriteti publik privat, ashtu edhe në rastet kur kërkon të lidhë një kontratë prokurimi publik, për sa i përket procedurave të tenderit, ato zhvillohen sipas të njëjtës procedurë, të disiplinuar nga legjislacioni i prokurimit publik.

Për këtë arsye, përshkrimi i procedurave në këtë kapitull, do të bëhet duke u bazuar jo vetëm në dispozitat e legjislacionit për PPP por edhe në dispozitat e legjislacionit për prokurimet publike. Paraprakisht vlen të theksojmë se dispozitat konkrete të ligjit 125/2013, për sa i përket procedurave të tenderit, përcaktojnë shprehimisht se:

- Procedura për dhënien e PPP fillon me publikimin e njoftimit të kontratës dhe në rast se mbyllet pozitivisht, përfundon me publikimin e njoftimit të fituesit për dhënien e kontratës. Ndërsa në rast se procedura rezulton e pasuksesshme, ajo ndërpritet me vendimin për ndërprerjen e procedurës së dhënies së kontratës;
- Për dhënien e PPP, përgjatë fazës së tenderit, autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurën e hapur, procedurën e kufizuar ose procedurën me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
- Në rastin e kontratave të PPP të cilat kanë si objekt punë publike, afati për dorëzimin e ofertave është jo më pak se 30 ditë nga data e publikimit të njoftimit të kontratës;
- Kriter i vlerësimit për dhënien e PPP, konsiderohet oferta ekonomikisht më e favorshme, e cila mund të bazohet në disa kritere të ndryshme. Në dokumentet e tenderit duhet të specifikohen paraprakisht koeficientet e vlerësimit dhe pikët përkatëse, për secilin nga kriteret e zbatuar;

- Në rastin e propozimeve të pakërkuara, propozuesi duhet të konkurrojë dhe të marrë pjesë në garë së bashku me ofertuesit e tjerë të interesuar. Gjithsesi, në rastet kur propozuesit të pakërkuar i është miratuar një bonus nga Këshilli i Ministrave, ai hyn në garë duke patur paraprakisht pikët e këtij bonusi, të shprehur deri në një maksimum 10 % të pikëve totale të garës.
- Edhe përgjatë zhvillimit të procedurës së tenderit, është komisioni i PPP i ngritur pranë autoriteti kontraktor, i cili ndjek procedurat ligjore për llogari të këtij organi;

Legjislacioni i Prokurimeve publike bazohet kryesisht mbi aktet e mëposhtme normative:

- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.130 date 12.03.2014 , “Për kryerjen në mënyre elektronike të procedurave konkurruese të koncesionit/PPP”;
- Dokumentet standarde të tenderit për koncesionet/PPP, të miratuara nga APP.

#### **a) Procedurat e tenderit**

Për sa i përket llojit të procedurës e cila do të zbatohet përgjatë procedurës së tenderit, Ligji 125/2013, përcakton në nenin 22 të tij se për PPP, autoritetet kontraktues mund të përdorin këto tre lloje procedurash;

- i.* Procedurë e hapur;
- ii.* Procedurë e kufizuar;
- iii.* Procedurë me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Ky është një dallim fillestar nga parashikimet e legjislacionit për prokurimet publike i cili për prokurimin publik tradicional parashikon edhe lloje të tjera procedurash prokurimi.

Pra këto tre lloje procedurash, e hapur, e kufizuar ose me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, janë të vetmet procedura të cilat mund të zbatohen në rastet e dhënies së koncesioneve dhe PPP.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, përcaktimi i procedurës së zbatueshme për një projekt konkret përgjatë fazës së tenderit, kryhet nga komisioni i PPP i ngritur pranë AK.

Procedura e hapur është një procedurë e cila mund të përdoret për të gjitha llojet e kontratave dhe rekomandohet nga legjislacioni për tu zbatuar nga autoritetet kontraktuese si procedurë standarde. Ndërkohë që procedurat e tjera mund të përdoren vetëm në raste të caktuara dhe për përzgjedhjen e të cilave autoritetet kontraktuese duhet të ofrojnë një justifikim të arsyetuar. Procedura e kufizuar mund të përdoret atëherë kur është e domosdoshme të bëhet dallimi ndërmjet fazës së përzgjedhjes, në të cilën trajtohet kualifikimi i kandidatëve dhe fazës së përcaktimit të kontratës fituese, në të cilën shqyrtohet ofertat e paraqitura. Ndërsa procedura me negociim mund të përdoret vetëm në rrethana të veçanta, sipas përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik. Procedura fundit zbatohet dhe përdoret më shpesh në vendet e BE përgjatë procedurave të prokurimit të koncesioneve/PPP.

Duhet konsideruar gjithsesi se procedura e hapur, përdoret rrallë në ambientin ndërkombëtar dhe në kuadër të BE për prokurimin e PPP dhe projekteve koncesionare, të cilat shpesh herë janë shumë komplekse dhe kërkojnë specifikime të mëtejshme, të cilat mund të menaxhohen më mirë përgjatë një procesi i cili përmban më shumë se një fazë procedurale.

Procedurat e mësipërme detajohen nga legjislacioni për prokurimin publik si më poshtë:

i. Procedura e hapur

Procedura e hapur është procedura në të cilën njoftohen dhe në të cilën mund të marrë pjesë çdo subjekt i interesuar, i cili plotëson kushtet e kërkuara në dokumentacionin e tenderit. Kjo procedurë zhvillohet nëpërmjet një faze të vetme. Në procedurën e hapur autoriteti kontraktor boton një njoftim të kontratës dhe të gjithë ofertuesit e interesuar mund të dorëzojnë ofertën e tyre. Pas përfundimit të afatit maksimal për paraqitjen e ofertave, të përcaktuar në njoftimin e kontratës, autoriteti kontraktor verifikon plotësimin e kriterëve dhe pasi kryen vlerësimin e ofertave të paraqitura, përzgjedh fituesin e tenderit.

Procedurat e hapura nuk janë zakonisht të konsideruara në mjedisin ndërkombëtar si të favorshme për prokurimin e PPP dhe koncesioneve, duke qenë se këto janë lloje komplekse të prokurimit të cilat kërkojnë optimizim të ofertave përgjatë fazave, e cila nuk mund të arrihet në procedurën e hapur e cila zhvillohet në një fazë të vetme.

ii. Procedura e kufizuar

Procedura e kufizuar është një procedure prokurimi e cila zhvillohet me faza. Përdorimi i kësaj procedure justifikohet vetëm kur verifikohen rrethanat e

parashikuara në legjislacionin e prokurimit publik. Këto rrethana verifikohen në rastet kur;

- punët ose shërbimet e kërkuara, për shkak të karakteristikave të tyre të ndërlikuara ose të veçanta, mund të ofrohen ose ekzekutohen vetëm nga disa partnerë privatë, të cilët zotërojnë kapacitetin e duhur teknik, profesional ose financiar;
- është ekonomikisht më e leverdishme për autoritetin kontraktues, që të shqyrtojë fillimisht kapacitetin dhe kualifikimet e subjekteve të interesuar dhe më pas të ftojë për të paraqitur oferta, vetëm ata të cilët i plotësojnë kualifikimet specifike të kërkuara.

Për arsyet e mësipërme, procedura e kufizuar nuk duhet të përdoret në rastet kur punët apo shërbimet e kërkuara gjenden lehtësisht në treg dhe në raste kur kanë specifikime teknike apo standarde të përgjithshme e të mirënjohura në treg.

Në procedurën e kufizuar autoriteti kontraktor boton një njoftim të kontratës në të cilin përshkruhet objekti i kontratës, kriteret përzgjedhëse, kriteret e përcaktimit të ofertës fituese si dhe ftesa për të shprehur interesin për pjesëmarrje. Në këtë fazë mund të shprehë interes çdo subjekt i interesuar për kryerjen e kontratës i cili mund të paraqesë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit.

Në përfundim të afatit kohor për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, autoriteti kontraktor përzgjedh kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara. Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, vetëm këtyre subjekteve të përzgjedhur, autoriteti kontraktor i dërgon ftesën për të paraqitur ofertat e tyre.

Në përfundim të këtyre afateve, autoriteti kontraktor vlerëson ofertat dhe përzgjedh fituesin e tenderit.

iii. Procedura me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

Edhe procedura me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës është një procedurë prokurimi e cila zhvillohet me faza. Edhe në këtë rast kjo procedurë mund të zbatohet vetëm kur verifikohen kushtet e përcaktuara nga legjislacioni për prokurimin publik.

Rastet e parashikuar nga legjislacioni për zbatimin e kësaj procedure janë si më poshtë;

- kur pas kryerjes së dy procedurave të njëpasnjëshme, të hapura ose të kufizuara, janë dorëzuar vetëm oferta të pavlefshme;
- natyra e kontratës nuk lejon paraprakisht përcaktimin me saktësi të vlerës totale;
- natyra e kontratës nuk lejon paraprakisht përcaktimin me saktësi të specifikimeve;
- kur natyra e kontratës i shërben vetëm kërkimit, testimit ose zhvillimit dhe nuk ka lidhje me përfitimet apo me rikuperimin e kostove;

Në këtë procedurë autoriteti kontraktor negocion me ofertuesit, për t'i përshtatur ofertat e tyre me kërkesat e tij me qëllim përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në përputhje me nenin 55 të këtij ligji. Procedurat me negociim, siç aplikohet në shumë vende të BE-së për prokurimin e PPP-ve, pranon se kontratat e PPP dhe koncesionare përfshijnë rregullime ligjore që promovojnë angazhime afatgjata të marrëdhënieve midis palëve. Palët duhet të zhvendosen nga të qenit thjesht palë në të qenit partnerë, një instrument i tillë është një mjet i rëndësishëm për maksimizimin e rezultate dhe pritshmërie në një marrëdhënie strategjike afatgjatë. Ndarja e informacionit nëpërmjet fazave të negociatave është një mjet i rëndësishëm që është përdorur për të krijuar partneritet përfundimtar në projektet e PPP. Edhe në Evropë, Direktiva e prokurimit publik 2014/ 24/ EU përcakton se Komisioni Evropian ka pranuar se ekziston një nevojë e madhe për autoritetet kontraktuese që të ketë fleksibilitet shtesë në zgjedhjen e një procedure prokurimi, e cila i lejon atyre mundësinë për negociata. "Shtetet anëtare duhet të jetë në gjendje të sigurojnë përdorimin e procedurës së negociuar me negociata apo nëpërmjet dialogut konkurrues, për projektet e PPP apo në rastet kur procedurat e hapura ose të kufizuara pa negociata, kanë gjasa që të mos arrijnë rezultate të kënaqshme të prokurimit."

Një projekt efikas koncesioni/PPP varet nga negociatat dhe një raport reciprok që funksionon mirë në mes të palëve. Marrëdhëniet midis palëve ndikojnë në detyrimet dhe në kontratën e projektit. Negocimi i kontratës së PPP duhet të rezultojë në arritjen e qëllimit të përbashkët, duke shmangur interesat e kundërta midis palëve. Pasi të kenë përmirësuar projektin dhe transaksionin, palët mund të fokusohen tek interesi i përbashkët në vend të interesave të tyre vetjakë. Për shembull, në një kontratë tradicionale ndërtimi, porositësi do të kërkojë çmimin më të ulët ndërsa ndërtuesi do të kërkojë çmimin më të lartë të mundshëm.



Negociatat e PPP kanë si synim që të arrijnë përmirësim të kontratës përfundimtare dhe të ndajnë rreziqet dhe përfitimet në mes të dy palëve. Në një kontratë tradicionale furnizuesi është i detyruar për të ofruar aset në kohën, vendin dhe gjendjen e duhur, përndryshe do të jetë në shkelje të kontratës. Përfituesi i aseteve do të japë pagesën në kohën dhe vendin e duhur. Në këto raste asnjëra nga palët nuk ka asnjë nxitje për të ofruar një zgjidhje më të mirë se sa ajo e rënë dakord paraprakisht.

Dialogu individual me pjesëmarrësit në këtë procedurë duhet të garantojë trajtim të barabartë, mos diskriminim dhe konfidencialitet të informacionit, për të gjithë ofertuesit.

Procedura fillon me publikimin e kontratës dhe autoriteti kontraktor mund ta zhvillojë atë në disa faza të ndryshme, duke reduktuar ofertat për të cilat negociohet, por këto faza procedurale duhet të përcaktohen paraprakisht në njoftimin dhe specifikimet e shpallura.

Pas mbylljes së fazës së kualifikimit, autoriteti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur të dorëzojnë ofertat. Autoriteti kontraktor mund të negociojë individualisht me secilin nga ofertuesit e përzgjedhur deri në përcaktimin e ofertës fituese.

Në të gjitha rastet, pavarësisht nga lloji i procedurës së zbatuar nga autoriteti kontraktues, për të vazhduar procesin e përzgjedhjes së fituesit të një PPP, duhet të pranohet së paku një ofertë e vlefshme.

Në rastet kur jepen PPP të cilat kanë objekt punët publike, pavarësisht nga lloji i procedurës së zbatuar, afati për dorëzimin e ofertave nuk mund të jetë më pak se 30 ditë nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

#### **a) Dokumentet e tenderit**

Me qëllim kryerjen e procedurave të tenderit, komisioni i PPP i ngritur pranë AK, përveç kompetencës për të përcaktuar procedurën e zbatueshme të tenderit, gjithashtu duhet të hartojë edhe dokumentet e tenderit, duke u bazuar në modelin e dokumenteve standarde të koncesioneve/PPP, të publikuara nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Përgjatë kësaj faze komisioni vazhdon të asistohet nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, e cila bashkëpunon me APP për hartimin dhe miratimin e dokumenteve standarde të tenderit për koncesionet dhe PPP.

Dokumentet e tenderit publikohen në formë elektronike në sistemin elektronik të prokurimit të autoritetit kontraktor si dhe në Buletinin e Prokurimit Publik, i cili është botimi ku publikohen të gjitha njoftimet publike mbi prokurimet publike të kryera nga Autoritet Kontraktuese në Republikën e Shqipërisë.

Buletini i Njoftimeve Publike publikohet mbi bazë javore, çdo ditë të hënë si dhe në çdo rast tjetër, kur është e nevojshme. Në Buletin publikohen dokumentet e tenderit, njoftimi i kontratës, njoftimi i fituesit, njoftimi i kontratës së lidhur, njoftimet e anulimit si edhe lista e operatorëve ekonomikë të cilat janë sanksionuar dhe përjashtuar nga prokurimi publik.

Bazuar në dispozitat e VKM nr. 130, datë 12.3.2014, publikimi i dokumenteve të procedurave konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat si dhe dorëzimi i ofertave për këto procedura zhvillohen me mjete elektronike.

Dokumentet e tenderit duhet të përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik të PPP.

*i.* Informacioni i përgjithshëm:

Informacioni i përgjithshëm i dokumenteve të tenderit përfshin:

- njoftimin e kontratës;
- ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);
- udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;
- kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes;
- formularin për deklarimin e konfliktit të interesit;
- formularin për ofertën ekonomike;
- formularin për sigurimin e ofertës;
- formularin për njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
- formularin e ankesave;
- formularin e njoftimit të fituesit;
- përshkrimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës;
- formularin e sigurimit të kontratës dhe;
- formularin e njoftimit të kontratës së lidhur.

Përmbajtja dhe elementët e këtyre dokumenteve specifikohen në mënyrë të detajuar nga legjislacioni i prokurimit publik. Gjithsesi në mënyrë të përmbledhur, në vijim përshkruhen elementë kryesorë të këtyre dokumenteve;

- Njoftimi i kontratës

Procedura e tenderit fillon me publikimin e njoftimit të kontratës nga ana e AK. Publikimi i këtij njoftimi ka për qëllim që të bëjë të njohur qëllimin e autoritetit kontraktor për dhënien e një projekti konkret PPP.

Autoriteti Kontraktor përdor njoftimin e kontratës sipas formularit standard të miratuar nga APP, i cili publikohet në formë elektronike në Buletinin e Prokurimit Publik, sëbashku me dokumentet e tenderit.

Njoftimi i kontratës dhe dokumentet e tenderit ngarkohen nga vetë autoriteti kontraktor në sistemin elektronik të prokurimeve publike të publikuar nga APP.

Njoftimi i kontratës duhet të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm që i jep mundësi operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë ose jo në procedurat e prokurimit publik. Në këtë njoftim duhet të përfshihen detyrimisht të paktën informacionet e përcaktuara në nenin 24 të Ligjit 125/2013. Njoftimi i kontratës së PPP përmban kryesisht të dhënat në lidhje me kontratën e PP dhe specifikimet në lidhje me ofertat e subjekteve të interesuar.

Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat e përgjithshme të kontratës së PPP, të tilla si autoriteti kontraktor, personat përgjegjës të AK, lloji, objekti, vendndodhja dhe kohëzgjatja e PPP, vlera dhe kriteret e përzgjedhjes së kontratës.

Gjithashtu, në lidhje me ofertat që duhen paraqitur, duhet të specifikojë informacione të tilla si: afati për dorëzim, adresa dhe mënyra e dorëzimit, informacionet dhe të dhënat që duhen përfshirë, koha dhe vendi i hapjes publike të ofertave, kriteret për përjashtimin e ofertuesve, lloji dhe vlera e garancive për ofertuesit, procedura dhe për afatet për shqyrtimin e ofertave.

Në rastet kur vlera e kontratës së PPP, është mbi kufirin e lartë monetar të prokurimeve publike, një përmbledhje e njoftimit të kontratës, duhet të botohet edhe në të paktën një gazetë me shpërndarje të gjerë në Evropë. Kufiri i lartë monetar, aktualisht është përcaktuar në vlerën e 1.200.000.000 (një miliard e dyqind milionë) lekë për kontratat e punëve publike dhe 200.000.000 (dyqind milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve.

- Ftesa për ofertë

Ftesa për ofertë është një dokument i cili përdoret në rastet e zbatimit të procedurave të tenderit të cila zhvillohen me faza. Kjo ftesë u dërgohet vetëm

atyre kandidatëve të cilët janë përzgjedhur në fazën e parë të kualifikimit përgjatë procedurës së prokurimit. Ftesa për ofertë duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t'u mundësojë kandidatëve të përzgjedhur të dorëzojnë ofertat e tyre.

- Udhëzimet për ofertuesit

Udhëzimet për ofertuesit apo për kandidatët, në rastin e procedurave të tenderit me faza, duhet të përmbajnë të gjithë informacionin, të dhënat dhe përshkrimet në lidhje me përgatitjen e ofertës, duke treguar elementët përbërës të ofertës, mënyrat dhe format e kërkuara si edhe veprimet e ndaluara me ligj. Gjithashtu udhëzimet duhet të japin informacion edhe për procedurën e rishikimit dhe të animimit.

- Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes

Kriteret e përgjithshme të kualifikimit /pjesëmarrjes përmbajnë listën e dokumentacionit ligjor dhe administrativ të kandidatëve/ofertuesve, të cilat u kërkojnë ofertuesve për të marrë pjesë në procesin e prokurimit,

- Formulari i Deklarimit të konfliktit të interesit

Deklarimi i konfliktit të interesit nga ofertuesit ka për qëllim shmangjen e rasteve të konfliktit të interesit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

- Oferta ekonomike

Oferta ekonomike përmban vlerën e ofertës së paraqitur e cila duhet të detajohet me listën e detajuar të çmimeve specifike të ofruara.

- Sigurimi i ofertës

Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin sigurimin e ofertës, kur vlera e kontratës është më e lartë se kufiri i lartë monetar, në formën e një depozite apo garancie bankare. Vlera e sigurimit të ofertës është 2 (dy) % të vlerës së kontratës. Dokumentet e tenderit duhet të specifikojnë periudhën e vlefshmërisë, natyrën, formën, vlerën dhe kushtet e tjera thelbësore të sigurimit të ofertës.

Sigurimi i ofertës do të mbahet nga autoriteti kontraktor, në rastet e tërheqjes ose ndryshimit të ofertave pas afatit përfundimtar, refuzimit të nënshkrimit të kontratës, mosparaqitjes së sigurimit të kontratës kur oferta është shpallur fituese, ose në rastet e mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër detyrues përpara nënshkrimit të kontratës, të përcaktuar shprehimisht në dokumentet e tenderit.

Autoriteti kontraktues i kthen sigurimin e ofertës ofertuesve jo fitues, si dhe ofertuesit fitues i cili duhet ta zëvendësojë atë me sigurimin e kontratës.

- Njoftimi i skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve

Ky njoftim përmban përshkrimin e rasteve dhe të arsyeve të cilat justifikojnë skualifikimin e një ofertuesi apo kandidati përgjatë procedurës së prokurimit publik, në bazë të kriterëve të përcaktuar nga legjislacioni.

- Formulari i ankesave

Ofertuesit apo kandidatët kanë të drejtën e paraqitjes së ankesave kundër veprimeve ose mosveprimeve të autoritetit kontraktor, pranë këtij të fundit, nëpërmjet një formulari standard, i cili përmban udhëzimet e nevojshme për plotësimin e tij.

- Njoftimi i fituesit

Në përfundim të procedurave të tenderit dhe përzgjedhjes së një oferte fituese, autoriteti kontraktor njofton ofertuesin fitues për pranimin e ofertës dhe për lidhjen e kontratës, sipas formulari standard, i cili publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Pas publikimit të njoftimit të fituesit, autoriteti kontraktor fton ofertuesin fitues që të lidhë kontratën, por në çdo rast jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e publikimit të këtij njoftimi.

- Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës përcaktojnë punët apo shërbimet e kërkuara, të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe përcaktimet në lidhje me detyrimet për përmbushjen, mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratës.

- Sigurimi i kontratës

Ofrimi i sigurimit të kontratës ka për qëllim që të ofrojë një garanci në favor të autoritetit kontraktor, në rastet e shkeljes së kontratës nga partneri privat. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së kontratës, në formën e kërkuar.

- Njoftimi i kontratës së lidhur

Brenda 5 (pesë) ditësh nga lidhja e kontratës me partnerin privat, autoriteti kontraktor publikon njoftimin për lidhjen e kontratës i cili tregon llojin e kontratës dhe përshkrimin e punëve dhe shërbimeve të cilat janë objekt i saj.

#### *ii.* Informacioni specifik

Informacioni specifik i tenderit përmban informacionin në lidhje me punët ose shërbimet të cilat janë objekt i kontratës.

Zakonisht, informacioni specifik përfshin Termat e Referencës të cilat përfshijnë të paktën:

- projektin dhe specifikimet;
- preventivin dhe kostot;
- grafikun e zbatimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.
- kërkesat për personelin kryesor dhe;

Këto informacione detajohen në rregullat e prokurimit publik dhe varen nga llojet e kontratave që do të zbatohen. Në mënyrë të përmbledhur, mund të theksojmë se në rastin e kontrate të punëve publike, dokumentet e tenderit duhet të tregojnë edhe informacionet e detajuara në lidhje me punët publike të kërkuara, duke përfshirë elementë të tillë si çmimet për njësi, vëllimin, matjet, cilësinë dhe llojet e punëve. Po kështu duhet të detajohen në një grafik të punimeve edhe fazat dhe afatet e realizimit të punëve.

Në kontratat të cilat kanë si objekt ofrimin e shërbimeve, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore.

Autoriteti kontraktues duhet të specifikojë edhe kërkesat e veçanta të kualifikimit të ofertuesve, në lidhje me aftësinë e tyre zbatuese dhe eksperiencën duke konsideruar natyrën dhe vlerën e kontratës. Kërkesat e veçanta të kualifikimit mund të jenë të lidhura me verifikimin e kapaciteteve teknike, ekonomike dhe financiare.

### *iii.* Ndryshimi i dokumenteve të tenderit

Subjektet e interesuar kanë të drejtë ti kërkojnë autoriteti kontraktor ndryshimin ose korrigjimin e dokumenteve të tenderit. Në rastet kur autoriteti kontraktor pranon ndryshimet e kërkuara në dokumentet e tenderit, ofertueseve u garantohej një zgjatje e afateve kohore për paraqitjen e ofertave me 5 (pesë) ditë për prokurimet me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë dhe me 10 (dhjetë) ditë për prokurimet me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë.

### *iv.* Bashkimi i përkohshëm i shoqërive

Subjektet e interesuar, mund të paraqesin oferta e tyre, si ofertues të vetëm apo si pjesëmarrës të një grupi operatorësh ekonomikë të cilët kanë krijuar një bashkim të përkohshëm të shoqërive, me qëllim realizimin e një kontrate koncesioni/PPP. Në këtë rast të gjithë subjektet të cilët përbejnë grupin e operatorëve ekonomikë, ofertojnë si një kandidat i vetëm.

Në rastet e grupeve të operatorëve ekonomikë, forma e veçantë ligjore e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, duhet të kryhet sipas formës, mënyrës

dhe përcaktimeve të cilat autoriteti kontraktor duhet ti përfshijë në dokumentet e tenderit.

Në rastet kur oferta paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë, njëri prej tyre duhet të emërohet si përfaqësues i të gjithë subjekteve të grupit, përgjatë procedurës së tenderit dhe në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Gjithashtu, në ofertën e paraqitur, duhet të specifikohen shërbimet ose punët që do të kryhen nga secili prej anëtarët të këtij grupi.

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive duhet të krijohet zyrtarisht, me anë të një marrëveshjeje në formë noteriale, në të cilën përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës apo shërbimeve dhe elementet konkrete në ngarkim të secilit nga anëtarët e grupit. Ky bashkim duhet të formalizohet detyrimisht përpara dorëzimit të ofertës.

Në rastin kur oferta paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive pranohet dhe shpallet fituese, atëherë kontrata e koncesionit/PPP duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

Kriteret ligjore të parashikuara nga legjislacioni dhe të kërkuara në dokumentet e tenderit duhet të plotësohen nga secili prej anëtarëve të këtij grupi, ndërsa kriteret ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në kontratë.

Një subjekt i cili paraqet një ofertë si pjesëtar i një bashkimi shoqërorish, nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe ofertë individuale.

Ndryshimi i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë pas dorëzimit të ofertës, shkakton refuzimin e ofertës.

Nëse si pasojë e paraqitjes së një propozimi të pakërkuar, të paraqitur individualisht, njëri prej anëtarëve të grupit ka përfituar bonusin përkatës për propozimin e pakërkuar, në rastet kur oferton si anëtar i një grupi, ky bonus do t'i llogaritet bashkimit të përkohshëm të operatorëve ku ai bën pjesë. Ndërsa në rastet kur dy ose më shumë operatorë kanë përfituar bonus për propozimin e pakërkuar të paraqitur bashkërisht, pikët bonus nuk i llogaritet secilit prej tyre, në rast se marrin pjesë individualisht në garë.

## b) Vlerësimi i ofertave

### i. Dorëzimi i ofertave

Në bazë të kërkesave të tenderit, oferta duhet të dorëzohen në format dhe mënyrat e kërkuara nga autoriteti kontraktor, brenda afatit kohor për dorëzimin e tyre. Ofertat e dorëzuara pas përfundimit të afatit, nuk shqyrtohen dhe i kthehen ofertuesve që i kanë paraqitur.

Bazuar në dispozitat e VKM nr. 130, datë 12.3.2014, dorëzimi i ofertave për procedurat konkurruese të koncesioneve/PPP zhvillohen me mjete elektronike, duke u bazuar në udhëzimet specifike të APP për ngarkimin e ofertave në sistemin e elektronik të prokurimit publik.

### ii. Hapja e ofertave

Pas marrjes së ofertave, autoriteti kontraktor i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e tenderit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave.

### iii. Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

Pas hapjes së ofertave, komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit

Komisioni, nëse gjykon se i nevojitet më shumë kohë për vlerësimin e ofertave, informon ofertuesit për orën dhe datën kur do të komunikohet rezultati i vlerësimit të ofertave dhe klasifikimi përfundimtar. Kohëzgjatja e vlerësimit nuk duhet të kalojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, përveç rasteve të tjera të parashikuara nga legjislacioni.

Në rastin e procedurave të prokurimit me faza, komisioni brenda afatit maksimal prej 10 (dhjetë) ditësh nga data e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar, përcakton listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar, që do të vlerësohen për ofertën dhe ia komunikon këtë informacion menjëherë të gjithë kandidatëve, që kanë paraqitur kërkesë për pjesëmarrje. Kandidatëve të



kualifikuar, në përfundim të afateve të ankimit, u dërgohet më pas ftesa për ofertë. Pas paraqitjes së ofertave, komisioni kryen procedurat e vlerësimit përfundimtar të ofertave të paraqitura.

Në rastin e procedurave me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, në varësi të kompleksitetit të kontratës, komisioni mund të zhvillojë negociata në faza të ndryshme me secilin nga kandidatët e përzgjedhur.

#### iv. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese duhet të jenë vetëm ato kritere të cilat janë përcaktuar paraprakisht dhe shprehimisht në dokumentet e tenderit. Komisioni përcakton ofertën më të mirë pas krahasimit dhe vlerësimit të të gjithë ofertave të paraqitura dhe i përcjell propozimin e tij. për miratim Autoriteti Kontraktor.

Kriteret e ofertës me çmimin më të ulët përdoren si element përcaktues në vlerësimin dhe përzgjedhjen e ofertuesit fitues, sidomos gjatë fazës së prokurimit për kontratat e thjeshta ose kontrata me standardet e njohura teknike. Ndërsa kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme do të përdoret në kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë në të cilat kanë endësi jo vetëm çmimi por edhe elementë të tjerë të kontratës, të cilët kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tjera, të tilla, si kostot e mirëmbajtjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetja teknike, përzgjedhja e elementëve që ndotin më pak mjedisin etj.

Zakonisht, mjete më të përdorur ndërkombëtarisht, për dhënien e një kontrate PPP bazohet mbi parimin "tenderi ekonomikisht më i favorshëm" (MEAT). Kriteret e tenderit ekonomikisht më të favorshëm i mundësojnë autoritetit kontraktues që të marrë parasysh kriteret që reflektojnë aspektet cilësore, teknike dhe të qëndrueshmërisë, si edhe çmimin, për të arritur një vendim përfundimtar.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në të gjitha rastet kur ka më shumë se një kriter të vetëm vlerësimi, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për secilin kriter vlerësues duhen përcaktuar pikët specifike sipas rëndësisë së secilit kriter si dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula e vlerësimit duhet të parashikohet paraprakisht dhe në mënyrë të qartë në dokumentet standarde të tenderit.

#### v. Përzgjedhja e fituesit

Pas vlerësimit të ofertave, komisioni harton klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe përzgjedh ofertuesin fitues. Komisioni njofton ofertuesin fitues, ofertuesit të cilët kanë paraqitur oferta por nuk janë shpallur fitues, si edhe ofertuesit e skualifikuar së bashku me arsyetimin përkatës. Pas marrjes së

njoftimeve, ofertuesi kanë të drejtë të paraqesin ankimet e tyre ndaj procedurës së zhvilluar, brenda afateve ligjore.

i. Ankimi administrativ dhe gjyqësor

Bazuar në dispozitat e Ligjit 125/2013, çdo subjekt i cili ka interes në një procedurë konkurruese, në rastet kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor, për të cilin pretendon se është marrë në kundërshtim me këtë ligj, ka të drejtën e paraqitjes së një ankimi administrativ, pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Nëse objekti i ankesës lidhet me dokumentet e procedurës konkurruese, subjektet kanë afat 10 ditor nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të kontratës, ndërsa nëse objekti i ankesave lidhet me vendimin e vlerësimit dhe klasifikimit përfundimtar, afati 10 ditor nis nga dita e nesërme e datës së marrjes së njoftimit ose datës në të cilën duhet të ishte njoftuar.

Një kopje me shkrim e ankesës i drejtohet autoritetit kontraktor i cili menjëherë pezullon procedurën konkurruese.

deri në momentin kur Komisioni i Prokurimit Publik ka vlerësuar ankimin dhe ka miratuar një vendim përfundimtar në lidhje me të.

Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet sipas formularit standard të përfshirë edhe në dokumentet e tenderit, siç është përshkruar më lart. Ankuesi duhet të përshkruajë arsyet dhe bazën ligjore për shkelet dhe parregullsitë e pretenduara, sëbashku me dokumentet apo provat përkatëse, të cilat justifikojnë ankimin e tij.

Komisioni i Prokurimit Publik i përgjigjet me shkrim ankimuesit brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të ankesës ose në rastet kur nevojitet informacion nga autoriteti kontraktor, brenda 20 ditëve.

Procedura e rishikimit administrativ dhe vendimmarrja e Komisionit të Prokurimit Publik, bazohen mbi dispozitat e parashikuar në legjislacionin e prokurimit publik.

Pas përfundimit të shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik mund të marrë këto vendime:

- të pushojë gjykimin, në rastet kur nuk vërtetohen shkelje ligjore. Në këtë rast, Komisioni i Prokurimit Publik i sqaron, me shkrim, ankimuesit arsyet për pushimin e gjykimin;
- të marrë një vendim i cili detyron autoritetin kontraktor të ndalë sjelljen e jashtëligjshme, brenda një afati të caktuar kohor.

Autoritetet kontraktuese duhet të zbatojnë vendimin e dhënë ose të kërkojnë rishikimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga marrja dijani për vendimin.

Ankimuesi ka të drejtë që edhe në rastet e një vendimi negativ të KPP, ti drejtohet gjykatës administrative kompetente. Në këtë rast, ankimi në gjykatë nuk pezullon vazhdimin e procedurave konkurruese, lidhjen e kontratës apo ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.

#### vi. Raporti përmbledhës i vlerësimit të ofertave

Pas përfundimit të afateve ligjore për paraqitjen e ankimeve të mundshme nga ana e ofertuesve, komisioni përgatit një raport përmbledhës i cili përmban informacionin në lidhje me procedurën, përshkrimin e punëve dhe shërbimeve, vlerat e ofertave, ofertuesit e skualifikuar sëbashku me arsyet e skualifikimit, ofertuesin fitues si dhe informacion në lidhje me ankimet dhe vendimet e marra për to. Ky raport përmbledhës i dërgohet për miratim titullarit të autoritetit kontraktues.

#### vii. Njoftimi i fituesit

Pas miratimit të raportit përmbledhës, autoriteti kontraktor dërgon për publikim në faqen e internetit të APP-së dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, njoftimin e fituesit sipas formularit standard. Pas publikimit të njoftimit të fituesit, autoriteti kontraktor fton ofertuesin fitues që të lidhë kontratën, por në çdo rast jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e publikimit të këtij njoftimi.

## KAPITULLI 11 VEPRIMET E NEVOSJHME PËRPARA LIDHJES SË KONTRATËS

### a) Sigurimi i kontratës

Përpara se të nënshkruhet ose të hyjë në fuqi kontrata e koncesionit/PPP, autoriteti kontraktues duhet të marrë nga partneri privat garancinë e kontratës. Elementët e garancisë për realizimin e kontratës, të tillë si vlera, forma, mënyra, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e paracaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Sigurimi i kontratës i shërben autoriteti kontraktor si mjet kompensimi për dëmin që mund ti shkaktohet si pasojë e dështimit të partnerit privat për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë. Instrumentet e sigurisë të kërkuara nga autoriteti kontraktor mund të jenë premtim për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, kambiale apo forma të tjera, por në çdo rast, të njëjta me ato të përcaktuara paraprakisht në dokumentet e tenderit. Sigurimi i kontratës depozitohet pranë autoritetit kontraktues, i cili është i detyruar t'i ruajë atë përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Autoriteti kontraktues duhet të verifikojë periodikisht vlefshmërinë e instrumenteve të sigurisë të ofruara nga partneri privat.

Me marrjen e sigurimit së kontratës, partnerit privat i kthehet sigurimi i ofertës së depozituar përgjatë procedurës konkurruese të tenderit.

### a) Subjekti për qëllime të veçanta (SPV)

Në rastet kur, sipas përcaktimeve të dokumenteve të tenderit, ofertuesi i përzgjedhur është i detyruar të krijojë një subjekt për qëllime të veçanta (SPV), atëherë ofertuesi fitues duhet të themelojë një shoqëri tregtare sipas legjislacionit shqiptar, e cila do të lidhë kontratën me autoritetin kontraktor.

Dokumentet e tenderit duhet të përcaktojnë formën e kërkuar të personit juridik, shumën minimale të kapitalit, detyrimet e ofertuesit më të suksesshëm në lidhje me themelimin e shoqërisë, si dhe marrëdhëniet e tjera midis ofertuesit më të suksesshëm, SPV dhe autoritetit kontraktues.

SPV duhet të ketë selinë e saj ligjore në Republikën e Shqipërisë, të ketë shënimin "Shoqëri koncesionare" në emrin e saj tregtar, ndërsa si objekt të saj duhet të ketë objektin e kontratës së koncesionit/PPP. Në këtë rast, autoriteti kontraktues nënshkruan kontratën me personin e autorizuar të kësaj shoqërie. Pas regjistrimit të SPV, autoriteti kontraktues i dërgon Ministrisë së Financave një kopje të kontratës dhe ekstraktit të regjistrimit të shoqërisë.

Në rastet kur ofertuesi fitues tërhiqet nga lidhja e kontratës ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës, atëherë autoriteti kontraktues mund të marrë një vendim të ri për dhënien e kontratës dhe t'i ofrojë nënshkrimin e kontratës ofertuesit që vijon në klasifikimin e ofertuesve të suksesshëm. Tërheqja e ofertuesit për këto shkaqe, shkakton mbajtjen nga ana e autoriteti kontraktor të sigurimit të ofertës.

Në kapitullin në vijim detajohen aspektet e lidhura me dispozitat specifike të kontratave, ndërkohë që në shtojcat bashkëlidhur këtij manuali, gjenden edhe modelet e kontratave të cilat mund të merren për bazë nga autoritetet kontraktuese.

#### **b) Negocimi i kontratës së koncesionit/PPP**

Pas përfundimit me sukses të procedurave konkurruese dhe përzgjedhjes së ofertës, autoriteti kontraktor fton ofertuesin fitues që të lidhë kontratën e koncesionit/PPP.

Në asnjë rast, autoritetet kontraktuese nuk mund të lidhin kontratën e koncesionit/PPP, pa përfunduar periudhat ligjore për paraqitjen e ankesave administrative. Lidhja e kontratës para përfundimit të afatit të njoftimit të klasifikimit apo para se të ketë përfunduar shqyrtimi administrativ shkakton pavlefshmërinë absolute të saj.

Njoftimi i partnerit privat nga ana e autoritetit kontraktor duhet të kryhet brenda 10 (dhjetë) ditësh nga data e skadimit të periudhës së pritjes së ankesave, përveç rasteve kur ky afat zgjatet në raste të arsyetuara, të cilat duhet të përcaktohen në dokumentet e tenderit.

Përgjatë kësaj faze palët do të negociojnë kontratën përfundimtare të koncesionit/PPP. Për hartimin e kontratës, autoritetet kontraktuese dhe partnerët privatë duhet të bazohen mbi kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës të cilat kanë qenë pjesë e dokumenteve të tenderit, si edhe në të gjithë elementët e tjerë të përfshirë në dokumentet e tenderit të cilat identifikojnë elementët e zbatimit të kontratës. Po kështu kushtet e ofruara nga partneri privat duhet të përputhen me ofertën e paraqitur e cila është shpallur fituese.

Qëllimi i dispozitave ligjore lidhet me faktin se kushtet e kontratës, nuk duhet të ndryshojnë nga kushtet e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit dhe nga kushtet e ofruara nga partneri privat në ofertën e tij e cila është përzgjedhur si fituese.

Gjithashtu, rikujtojmë se autoritetet kontraktuese kanë detyrimin, përgjatë procesit të hartimit dhe të nënshkrimit të kontratave administrative që të

konsultohen me Avokaturën e Shtetit. Po kështu autoritetet kontraktuese, janë të detyruara që të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës, në rastet kur, si pasojë e projekteve të koncesionit/PPP, miratojnë akte normative të cilat vendosin kufizojnë aksesin në treg apo tregtimin, japin të drejta ekskluzive ose të veçanta, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara ose imponojnë praktika të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

## KAPITULLI 12

## PËRMBAJTJA E KONTRATËS SË KONCESIONIT/PPP

**a) Hartimi i draft kontratës së PPP**

Projektet e partneritetet publik privat realizohen nëpërmjet kontratave të cilat lidhen midis autoriteteve kontraktuese dhe partnerëve privatë, të cilët janë përzgjedhur si fitues pas kryerjes së procedurave konkurruese. Legjislacioni ka përcaktuar vetëm katër llojet e përgjithshme të kontratave të PPP, sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 8 të ligjit 125/2013, të cilat mund të jenë kontrata koncesioni për punë apo shërbime publike, ose kontrata për punë apo shërbime publike. Termi i përgjithshëm, "kontrata" i jep diskrecion autoriteteve kontraktuese në përzgjedhjen e llojeve specifike të kontratave të zbatueshme, në përputhje me parimin e lirisë kontraktore. Parimi i lirisë kontraktore përcaktohet nga Kodi Civil dhe përcakton se palët janë të lira të rregullojnë marrëdhëniet e tyre në kontratë, brenda kufijve të përcaktuara me ligj. Pra liria kontraktore ka si limit të saj, faktin se kontrata nuk mund të përmbajë dispozita të cilat janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Si rezultat, partneritetet publike private mund të rregullohen nëpërmjet kontratave me struktura të ndryshme, sipas nevojave të autoriteteve kontraktuese dhe të partnerëve private, në përputhje me specifikat e projekteve konkrete të bashkëpunimit midis tyre.

Kontrata e partneritetit publik privat duhet të hartohet duke u bazuar në informacionet e përmbajtura në dokumentet e tenderit dhe në përcaktimet e ofertës e cila është shpallur fituese në përfundim të procedurave konkurruese. Ky përfundim justifikohet nga fakti se kushtet e kontratës, nuk duhet të ndryshojnë nga kushtet e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit dhe nga kushtet e ofruara nga partneri privat në ofertën e tij.

Siç u përshkrua në kapitujt e mëparshëm, dokumentacioni i tenderit duhet të përmbajë disa informacione specifike, të cilat jo vetëm që duhet të identifikojnë autoritetin kontraktues, objektin, llojin dhe kohëzgjatjen e kontratës, por duhet të përcaktojnë edhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

Bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare këshillohet që autoritetet kontraktuese të përfshijnë në dokumentet e tenderit, një draft sa më të plotë të kontratës. Në këtë mënyrë shmangen paqartësitë apo keqkuptimet e mundshme midis palëve në lidhje me zbatimin e projektit dhe problematikat që mund të lindin gjatë procesit të negocimit. Gjithashtu, hartimi i një draft kontrate të plotë rezulton të jetë i pashmangshëm në rastet kur përgjatë procesit të tenderimit, zbatohen procedurat me faza, pra procedura e kufizuar apo me negocim, në të cilat nuk ka më hapësirë për negocim midis palëve, pas paraqitjes së ofertave përfundimtare.

Me qëllim hartimin e kontratave të mirë përcaktuara, autoritetet kontraktuese duhet të konsultohen me stafin e specializuar të ATRAKO, si edhe në rastet kur kërkohet një nivel i lartë ekspertize, mund të angazhojnë edhe konsulentë ligjorë apo ekspertë teknikë të jashtëm. Autoritetet kontraktuese, përgjatë procesit të hartimit dhe të nënshkrimit të kontratave, duhet të konsultohen me Avokaturën e Shtetit<sup>8</sup>. Gjithashtu autoritetet kontraktuese, janë të detyruara që të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës, në rastet vendosin kufizime në aksesin apo tregtimin, garantojnë të drejta ekskluzive ose të veçanta për ndërmarrje ose për produkte të caktuara ose imponojnë praktika të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes<sup>9</sup>.

Në momentin e hartimit të kontratave, autoritetet kontraktore duhet të kenë parasysh qëllimin që teksti i kontratës të jetë sa më i qartë, i kuptueshëm dhe të krijojë siguri për palët që do e zbatojnë atë, duke shmangur mundësitë për keqkuptime, keqinterpretime apo verifikimin e mangësive të saj. Kontrata do të jetë dokumenti bazë mbi të cilin do të rregullohen marrëdhëniet afatgjata të palëve përgjatë zbatimit të projekti, për pasojë ajo duhet të garantojë qartësinë e nevojshme për zbatimin efektiv të një projekti PPP.

Kontrata është edhe gjithashtu dokumenti mbi të cilin do të bazohet autoriteti kontraktues dhe partneri privat edhe përgjatë fazës së menaxhimit dhe monitorimit, fazë e cila zgjat deri në përfundimin e projektit konkret të PPP.

#### b) Përmbajtja e kontratës

Për sa i përket përmbajtjes dhe dispozitave konkrete që duhet të përmbajë kontrata, në vijim identifikohen disa nga elementët kryesore të cilat duhet të jenë pjesë e kontratës. Këto elementë janë identifikuar duke u bazuar mbi udhëzimet dhe praktikën e mira ndërkombëtare, përfshirë Bankën Botërore dhe Qendrën Europiane të Ekspertizës së PPP.

Gjithashtu, në formën e një aneksi të këtij manuali, mund të konsultohet edhe një model kontrate koncesioni/PPP, i cili mund ti shërbejë autoriteteve kontraktore si shembull në të cilin mund të mbështetën për hartimin e kontratave në të ardhmen.

---

<sup>8</sup> Referuar Ligjit nr 10018 date 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", neni 15, pika 4, "Për hartimin dhe nënshkrimin e kontratave administrative, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, këshillimi i organit përkatës të administratës publike me Avokaturën e Shtetit është i detyrueshëm. Në këto raste, këshillimi i organeve të administratës publike me Avokaturën e Shtetit zgjat deri në përmbushjen e detyrimeve të kontratave nga palët nënshkruese."

<sup>9</sup> Referuar dispozitave të nenit 69 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës"



Në përmbajtjen e saj draft kontrata duhet të përfshijë dispozita të cilat përcaktojnë të paktën elementët e mëposhtëm;

- i.* dispozitat e përgjithshme, përfshirë objektin, qëllimin dhe përkufizimet;
- ii.* datën e fillimit dhe kohëzgjatjen e përcaktuar të kontratës;
- iii.* të drejtat dhe detyrimet e secilës palë;
- iv.* ndarjen e rreziqeve midis palëve;
- v.* kushtet e përgjithshme në lidhje me punimet/shërbimet, përfshirë objektivat dhe standardet e performancës që i kërkohen partnerit privat;
- vi.* mekanizmat e shpërblimit të partnerit privat, përfshirë afatet dhe modalitetet e pagesave;
- vii.* sanksionet dhe penalitetet që mund të zbatohen në rastet e shkeljeve nga palët;
- viii.* sigurimi i kontratës (Garancia e performancës);
- ix.* ndryshimet, shkaqet për të cilat lejohet ndryshimi i kontratës në të ardhmen, dhe procedura e zbatueshme;
- x.* rastet e zgjidhjes së parakohshme të kontratës dhe procedurat përkatëse;
- xi.* mekanizmat e zëvendësimit (step in rights) të kreditorëve të garantuar dhe autoritetit kontraktues;
- xii.* çështjet e pronësisë së pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme;
- xiii.* mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- xiv.* procedurën e zbatueshme në momentin e përfundimit të kontratës, përfshirë dorëzimin e aseteve, verifikimet përfundimtare dhe pagesat e mundshme;
- xv.* mekanizmat për menaxhimin e kontratës
- xvi.* mekanizmat e monitorimit, përfshirë afatet dhe modalitetet e monitorimit;

Në vijim jepen disa udhëzime të detajuara në lidhje me përcaktimet e elementëve të mësipërm në kontratat e PPP.

- i. dispozitat e përgjithshme të kontratës;

Kushtet e përgjithshme të kontratës duhet të mirë përcaktojnë projektin konkret të PPP që do të rregullohet nga kontrata. Objekti i kontratës së PPP duhet të respektojë dispozitat e legjislacionit, pra duhet të ketë si objekt dhënien e koncesionit/PPP për realizimin e punëve ose ofrimin e shërbimeve publike, ose kryerjen e të dy elementëve. Kontrata duhet të përcaktojë modelin e zbatuar të PPP (p.sh. BOT, BTO, BOOT, etj)

Për të qartësuar objektin e kontratës dhe qëllimin e palëve për ta zbatuar atë, ndodh shpesh që kontratës ti bashkëlidhen si shtojca edhe dokumentet e tenderit, njoftimi i kontratës, specifikimet teknike dhe oferta e paraqitur nga partneri privat, të cilat detajojnë objektin e kërkuar nga autoriteti kontraktues dhe të pranuar nga partneri privat.

Këto dokumente duke u bërë pjesë e kontratës si anekse të saj ndihmojnë palët në identifikimin më të qartë të detyrimeve reciproke dhe të objektivave që kërkohen të arrihen nëpërmjet kontratës dhe janë një mjet i mirë reference në rast konflikti.

- i. fillimi dhe kohëzgjatja e kontratës;

Kontrata duhet të përcaktojë afatin e kohëzgjatjes së saj, i cili nuk duhet të tejkalojë afatin maksimal prej 35 vjetësh të përcaktuar nga Ligji 125/2013.

Kohëzgjatja e kontratës përcaktohet paraprakisht në studimin e fizibilitetit dhe duhet të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme, duke marrë në konsideratë disa elementë.

Së pari autoritetet kontraktore duhet të përcaktojnë një afat të arsyeshëm si për realizimin e punëve apo shërbimeve të kërkuara nga partneri privat.

Së dyti, kohëzgjatja duhet të jetë e tillë që ti mundësojë partnerit privat, një kohë të mjaftueshme për të realizuar kthimin e investimit dhe një normë fitimi të arsyeshme.

Së treti kohëzgjatja duhet të përcaktohet në afate kohore të përshtatshëm, të cilat nuk e kufizojnë konkurrencën më shumë sesa është e nevojshme.

Kontrata duhet të përcaktojë se cila do të jetë data efektive e fillimit të kohëzgjatjes së saj. Kjo datë mund të jetë data e nënshkrimit të kontratës ose mund të përcaktohet një datë tjetër e mëvonshme, në rastet kur nevojitet plotësimi i disa kushteve paraprake apo kryerja e disa veprimeve përgatitore për fillimin e saj. Në varësi të datës së fillimit dhe sipas kohëzgjatjes së

përcaktuar, kontrata duhet të përcaktojë edhe datën e saktë të përfundimit të saj.

Kohëzgjatja e kontratës mund të kushtëzohet edhe nga rastet kur verifikohen ngjarje të cilat mund të pezullojnë zbatimin e saj (si për shembull, rastet e forcës madhore, nevojat e diktuar nga interesi publik, vonesat e autoriteteve kompetente për dhënien e lejeve, licencave apo autorizimeve të nevojshme, etj), dhe për pasojë që shkaktojnë shtyrjen e datës së përfundimit të saj.

Bazuar në përcaktimet e pikës 5 të nenit 30 të ligjit 125/2013, afati kohor i kontratës mund të zgjatet vetëm në rastet e parashikuara nga nenet 31, 32 dhe 33 të këtij ligji, të cilat lidhen me rastet e ndryshimit të kontratës, transferimit të kontratës apo të dhënies së punëve dhe shërbimeve shtesë.

ii. të drejtat dhe detyrimet e palëve;

Përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve konkrete të palëve është një nga elementët më të rëndësishëm të kontratës. Dispozitat përkatëse, duhet të përcaktojnë qartësisht dhe konkretisht të drejtat dhe detyrimet specifike të partnerit publik dhe atij privat, për të shmangur çdo mundësi keqkuptimi apo mosmarrëveshjeje përgjatë zbatimit të kontratës.

Të drejtat dhe detyrimet e palëve mund të jenë të natyrave të ndryshme. Ato përcaktohen në varësi të një shumëllojshmërie faktorësh, të cilët përfshijnë tipologjinë e kontratës, karakteristikat dhe llojin e projektit të zbatuar, kushtet e përcaktuara nga palët, nivelet e ndarjes së rreziqeve midis partnerëve apo elementë të tjerë.

Parimi i përgjithshëm është që kontrata të ofrojë një ekuilibër të të drejtave dhe detyrimeve për të dyja palët. Gjithsesi kontrata duhet të reflektojë një ndarje të tyre e cila merr parasysh nga njëra anë faktin e rëndësishëm që, kontrata lidhet me realizimin e punëve apo me ofrimin e shërbimeve, të cilat janë me interes publik dhe nga ana tjetër, faktin që partneri privat duhet të ketë mundësinë që të rikuperojë kostot e investimit, si edhe të realizojë një fitim të arsyeshëm si pasojë e kryerjes së tyre sipas kontratës. Të drejtat dhe detyrimet duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e dokumenteve të tenderit.

Të drejtat e autoritetit kontraktues përfshijnë kryesisht të drejtën për monitorimin e zbatimit të rregullt të kontratës, verifikimin e realizimit të standardeve të kërkuara, marrjen e informacioneve dhe raportimeve nga ana e partnerit privat, kryerjen e kontroleve dhe rimarrjen në dorëzim të aseteve apo shërbimeve në përfundim të kontratës, kur kjo parashikohet nga kontrata.

Detyrimet e autoritetit kontraktues përfshijnë kryerjen e pagesave në favor të partnerit privat, sipas afateve dhe modaliteteve të rëna dakord, dhënien e asistencës me qëllim pajisjen e tij me lejet apo licencat e nevojshme, vënien në dispozicion të aseteve publike apo suportit logjistik, në rastet kur ofrohen,

shkëmbimin e informacionit dhe komunikimin korrekt me partnerin privat. Detyrimet e autoritetit kontraktor lidhen konkretisht edhe me përballimin e rreziqeve përkatëse, që janë në ngarkim të partnerit publik.

Të drejtat e partnerit privat përfshijnë kryesisht të drejtën për përfituar të ardhura nga punët e kryera dhe shërbimet e ofruara, marrjen e informacioneve të nevojshme nga autoriteti kontraktor apo përfitimin e asistencës së partnerit publik për pajisjen me lejet dhe licencat e nevojshme.

Partneri privat mund të marrë përsipër detyrime të ndryshme, në varësi të kërkesave të partnerit publik dhe të nevojave të lidhura me realizimin e punëve apo shërbimeve publike.

Detyrimet e partnerit privat përfshijnë kryesisht detyrimin për të financuar, projektuar, ndërtuar, rindërtuar, mirëmbajtur dhe operuar punët apo shërbimet, respektimin e standardeve, afateve dhe modaliteteve të kërkuara, dhënien e informacionit dhe raportimin tek autoriteti kontraktor. Detyrimet e partnerit privat lidhen konkretisht edhe me përballimin e rreziqeve përkatëse, që janë në ngarkim të tij.

Kontrata duhet të përcaktojë detyrimet e partnerit privat, duke përcaktuara se cilat do të jenë punët, punimet apo shërbimet që duhet të realizohen, duke përcaktuar edhe afatet konkrete, metodologjinë, mënyrën, specifikimet teknike, standardet, nivelet e mirëmbajtjes, mënyrën e dorëzimit, garancitë e përdorimit të tyre pas dorëzimit apo çështje të tjera të lidhura.

Edhe në këtë rast, për të ndihmuar përcaktimin e qartë të të drejtave dhe detyrimeve të palëve, është e dobishme që kontratës ti bashkëlidhen si shtojca edhe dokumentet e tenderit, njoftimi i kontratës, specifikimet teknike dhe oferta e paraqitur nga partneri privat në të cilën përcaktohen kushtet e kontratës.

iii. ndarja e rreziqeve dhe përgjegjësitë përkatëse;

Rreziqet duhet ti ngarkohen palës e cila objektivisht i përballon më mirë ato dhe zakonisht çdo partner merr përgjegjësinë për rastet e rrezikut që janë nën sferën e ndikimit të tij.

Kontrata duhet të identifikojë konkretisht rreziqet e parashikuara për zbatimin e kontratës, ndarjen e tyre midis palëve si edhe procedurat e zbatueshme në rastet kur ato verifikohen. Ndarja e rreziqeve mund të bazohet mbi një matricë risku të akorduar midis palëve, në të cilën listohen konkretisht rreziqet e mundshme, si dhe përcaktohet për secilin prej tyre, nëse janë në ngarkim të partnerit publik, në ngarkim të partnerit privat apo përballohen bashkërisht nga të dyja palët.

Kjo matricë risku apo tabelë e rreziqeve mund të detajohet në formën e një shtojce që i bashkëlidhet kontratës. Po kështu ndarja e rreziqeve mund të integrohet edhe nga plani i menaxhimit të rreziqeve, i cili përveç identifikimit të rreziqeve dhe ndarjes së përgjegjësiave, përshkruan edhe procedurat dhe

veprimet konkrete të cilat duhet zbatuar nga palët për parandalimin, shmangjen apo zbutjen e pasojave në rastet kur verifikohen këto rreziqe.

### Shembull: Model i tabelës së ndarjes së rreziqeve

Rreziqet e kontratës	Subjekti përgjegjës për rrezikun			Masat parandaluese ose zbutëse	Dispozita përkatëse e kontratës
	Partneri publik	Partneri Privat	Të dyja palët		
<b>Rreziqet e lidhura me financimin e projektit</b>		x		Marrja e masave mbrojtëse nëpërmjet parashikimit të pasojave negative të mundshme, në planin e biznesit dhe në marrëveshjet e lidhura nga me huadhënësit	Neni __ “Përgjegjësitë e partnerit privat”
<b>Ndryshimet e legjislacionit</b>	x			Paracaktimi i modelit të ekuilibrit financiar midis palëve	Neni __ : Neni __ “Përgjegjësitë e autoritetit kontraktues”
<b>Rastet e Forcës Madhore</b>			x	Komunikim i menjëhershëm i ngjarjes, kryerja e procedurave sipas kontratës, mbulim nëpërmjet sigurimit ndaj rasteve të forcës madhore	Neni __, Forca Madhore”
_____etj					

#### iv. Kushtet e përgjithshme në lidhje me punët/shërbimet;

Ky seksion duhet të përcaktojë dispozitat e nevojshme në lidhje me kryerjen e punëve dhe/ose shërbimeve të ofruara nga partneri privat. Kontrata duhet të përfshijë listën thelbësore dhe jo-thelbësore të punëve/shërbimeve, si dhe dispozita të tjera për kryerjen e këtyre punëve dhe ofrimin e shërbimeve. Për shembull mund përcaktohen rregullat për nën-kontraktorët, nëse partnerit privat i lejohet të nën-kontrakttojë me sipërmarrës të pavarur dhe deri në çfarë niveli.

Kontrata duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë se cilat janë objektivat, nivelet dhe standardet e performancës të cilat i kërkohen partnerit privat, duke specifikuar konkretisht sasi të cilësive të punëve dhe shërbimeve që duhet të realizohen prej tij. Për shembull kontrata mund të përcaktojë paraprakisht standarde kombëtare apo ndërkombëtare, të cilat shërbejnë si indikatorë dhe referencë për nivelet e cilësisë së kërkuar. Këto standarde, nëse

janë të shumtë në numër dhe të detajuar, mund të listohen dhe përcaktohen në anekse të veçanta, për të mos renduar tekstin dhe lexueshmërinë e kontratës.

Një element i rëndësishëm në përcaktimin e objektivave të performancës lidhet me faktin që kontrata, për sa është e mundur, duhet të përcaktojë objektivat në lidhje me rezultatet e pritshme (outputs), më shumë sesa për mënyrën sesi duhet të realizohen objektivat (inputs). Për shembull, për kontratat e menaxhimit të rrugëve, është më mirë që të përcaktohet cilësia e sipërfaqes së rrugës që kërkohet, sesa thjesht të përcaktohen materialet dhe metodat specifike që duhet të përdoren. Në këtë mënyrë edhe partneri privat është i lirë që të rinovojë apo përditësojë materialet apo teknologjitë e përdorura në projektet e PPP.

Objektivat e performancës duhet të jenë të përcaktuar konkretisht, të matshëm, të arritshëm, reale dhe të përcaktuar në afate kohore.

Verifikimi i respektimit të standardeve të performancës lidhet ngushtë me aspektet e fazës së monitorimit të kontratës. Kontrata duhet të parashikojë edhe me mekanizmat për verifikimin në mënyrë të pavarur të faktit nëse standardet janë respektuar apo jo, në rastet kur nuk ka dakordësi midis palëve, goftë edhe nëpërmjet ekspertëve apo organeve të treta, të pavarura.

Gjithashtu kontrata duhet të përcaktojë edhe pasojat në rastet e mosrealizimit të secilit prej objektivave të performancës, duke përcaktuar edhe pasojat e zbatueshme, përfshirë sanksionet e zbatueshme, dëmet që duhet të shpërblehen, reduktimet e pagesave apo mbajtjen e garancisë së kontratës.

Kushte të tjera mund të përfshijnë Sigurimin e Cilësisë, Mbajtjen dhe raportimin e Informacioneve (teknikë dhe financiarë), Personelin, Detyrimet në lidhje me Mjedisin, Shëndetin, Sigurinë etj.

v. mekanizmat e pagesës;

Mekanizmat e pagesës duhet të përcaktojnë mënyrën se si partneri privat do të shpërblehet për punët e realizuara dhe shërbimet e ofruara sipas kontratës. Këto mekanizma duhet të përshkojnë qartësisht format dhe mënyrat e pagesave, burimin e tyre dhe afatet kohore të pagesave.

Mekanizmat e pagesës, afatet, mënyra dhe vlera e tarifave të koncesionit/PPP përcaktohen paraprakisht në studimin e fizibilitetit, në përpjesëtim me objektin, vlerën dhe kohëzgjatjen e kontratës, ndarjen e rreziqeve, kostot që partneri privat merr përsipër, fitimin e pritshëm, si dhe vlerën e pasurive dhe asetëve të vëna në dispozicion nga autoriteti kontraktues.

Po kështu mekanizmat e pagesës duhet të parashikojnë edhe mundësitë e ndryshimeve dhe rregullimeve të pagesave, të cilat mund të varen nga realizimi i objektivave të performancës, nga faktorët e rreziqeve, inflacioni etj.

Siç u përshkrua në kapitujt e mëparshëm, për kryerjen e punëve apo shërbimeve të kërkuara nga partneri publik, partneri privat shpërblehet:

- duke ju dhënë e drejta për të shfrytëzuar veprat dhe/ose shërbimet publike duke vendosur tarifa ose pagesa të cilat përballohen nga përdoruesit fundorë të shërbimeve apo nga konsumatorët;
- duke ju dhënë e drejta për të shfrytëzuar veprat dhe/ose shërbimet publike së bashku me përfitimin e mbështetjes

- nga pagesat e kryera nga autoriteti kontraktor ose të përfituara në emër të tij, zakonisht kundrejt disponueshmërisë së objektit dhe/ose shërbimit të ofruar;
- me forma të tjera të mbështetjes financiare, përfshirë transferimin e të drejtave materiale dhe të drejtave të tjera reale;
- një kombinim i mjeteve të shpërblimit të sipërpërmendura.

Bazuar në përkufizimin ligjor, mbështetje financiare konsiderohet çdo lloj i mbështetjes monetare ose jo monetare dhe/ose financimi i dhënë nga sektori publik, duke përfshirë, por pa u kufizuar, subvencionet, garancitë financiare apo të tjera, kontribute kapitale dhe transferim të të drejtave të pronësisë.

Format kryesore të pagesave në favor të një partneri privat mund të jenë;

- Pagesat nga përdoruesit fundorë, të cilat mund të jenë tarifatat e paguara nga përdoruesit e shërbimeve publike të ofruara nga partneri privat. Në këtë rast, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit shqiptar në lidhje me vendosjen dhe përcaktimin e tarifave, duhet të jetë autoriteti kontraktues subjekti i cili përcakton tarifatat që do të përballojnë përdoruesit për shfrytëzime punëve apo shërbimeve publike të realizuara nga partneri privat;
- Pagesat nga autoriteti kontraktor apo organet shtetërore, të cilat i paguhen partnerit privat, për objekte apo shërbimet e ofruara. Këto mekanizma shpërblimi parashikojnë pagesa të cilat mund të jenë:
- të bazuara mbi përdorimin, për shembull rastet kur autoriteti kontraktues paguan një tarifë, e cila bazohet mbi numrin e automjeteve që përdorin një rrugë të menaxhuar sipas kontratës nga partneri privat;
- të bazuara mbi disponibilitetin, pra rastet kur pagesat janë të kushtëzuara nga vënia në dispozicion nga ana e partnerit privat e një objekti apo një shërbimi, sipas standarteve të kërkuara;

- mbështetje financiare e bazuar mbi arritjen dhe realizimin e disa objektivave të paracaktuar.
- Mekanizma shpërblyes apo penalizues, të cilat mund të parashikojnë dhënien e bonuseve në rastet kur realizohen rezultate të kënaqshme apo në rast të kundërt, aplikimin e penaliteteve nëse nuk arrihen rezultatet e kërkuara.

vi. sanksionet dhe penalitetet në rastet e shkeljeve;

Një element i rëndësishëm i kontratës lidhet me përcaktimin e saktë të sanksioneve dhe penaliteteve që mund të zbatohen. Së pari duhet të identifikohen paraprakisht rastet konkrete të cilat do të konsiderohen si shkelje të kontratës. Këto mund të lidhen me mosrealizimin e detyrimeve sipas kontratës, mosrespektimin e standardeve të kërkuara apo moskryerjen e pagesave. Për secilën prej këtyre rasteve, duhet të përcaktohet procedura që do të zbatohet për verifikimin e shkeljes mënyrën e aplikimit të sanksioneve si edhe nivelin e sanksioneve të zbatueshme.

Kontrata duhet të përcaktojë edhe mekanizmat e aplikimit të sanksioneve, të cilat mund të jenë aplikim i gjobave, reduktim i pagesave, shpërblime të dëmit të shkaktuar apo mbajtje e tyre nga garancia e kontratës.

vii. sigurimi i kontratës (garancia e performancës);

Siç u përshkrua në kapitujt e mësipërm, partneri privat duhet të ofrojë një garanci kontrate, e cila i shërben autoritetit kontraktor si mjet sigurimi për realizimin e suksesshëm të detyrimeve të kontratës nga ana e partnerit privat dhe parandalon braktisjen e projektit nga partneri privat.

Kërkesat në lidhje me garancinë e kontratës përcaktohen në dokumentet e tenderit. Garancia e kontratës mund të kërkohen në forma të ndryshme, të tilla si premtim për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, kambiale etj.

Garancia e kontratës si rregull kërkohet para nënshkrimit të kontratës ose para datës efektive të fillimit të saj.

Gjithsesi, partneri privat ka interes që vlera kësaj garancie të mos mbetet e pandryshuar për gjithë afatit e kontratës, por të reduktohet gradualisht, përgjatë zbatimit të saj, në përputhje me realizimin e objektivave të saj. Kjo kërkesë lidhet me kostot financiare që lidhen me ruajtjen e garancive të kontratave të cilat kanë vlera të konsiderueshme.

Në këto raste kontrata duhet të përcaktojë jo vetëm formën dhe nivelin e garancisë, por edhe procedurën dhe modalitetet për reduktimin gradual të saj. Reduktimi mund të bazohet mbi afatet kohore apo me plotësimin e disa objektivave të veçantë të kontratës (milestones) nga ana e partnerit privat. Po kështu kontrata mund të parashikojë të drejtat e autoriteti kontraktor për



verifikimin periodik të vlefshmërisë së instrumenteve të garancisë, ruajtjen e niveleve, formës dhe kushteve të saj, sipas përcaktimeve të kontratës.

viii. ndryshimi i kontratës dhe procedurat e zbatueshme;

Kontrata e PPP janë afatgjata, komplekse dhe mbartin një shumëllojshmëri rreziqesh të cilat mund të verifikohen në të ardhmen, përgjatë zbatimit të saj. Për këto arsye, mund të verifikohen raste kur mund të nevojiten ndryshime dhe ripërshtatje të kontratës, në varësi të kushteve të reja. Për këtë qëllim kontrata duhet të përmbajë dispozita të cilat identifikojnë raste dhe arsyet që mund të shkaktojnë ndryshime të kushteve, për të cilat nevojitet ndryshimi i kontratës si edhe procedurën përkatëse që do të zbatohet për ndryshimet e kontratës. Fleksibiliteti i kontratës nëpërmjet mekanizmave ripërshtatës, shmang nevojën që kontrata të rinegociohet apo që të zgjidhet në mënyrë të parakohshme. Mekanizmat e ripërshtatjes mund të bazohen mbi parimin e ekuilibrit financiar, i cili përcakton se në rastet kur verifikohen ndryshime, të cilat sjellin pasoja negative mbi një palë të kontratës, kontrata duhet të përshtatet, me qëllimin që të ruhet ekuilibri financiar i palëve, siç ka qenë në momentin fillestar të nënshkrimit të kontratës.

Këto lloje ndryshimesh lidhen tipikisht me tre lloje ngjarjesh: forca madhore (shkaqe natyrore apo trazira civile), ndryshimet si pasojë e ndërhyrjes së qeverisë (ndryshime të rregullave mbi sistemin e taksave, transferimet e kapitalit apo kursin e këmbimit), apo ndryshime thelbësore dhe të papritura të kushteve ekonomike (si për shembull rritja në mënyrë të konsiderueshme e çmimeve të lëndëve të para që përdoren).

Bazuar në përcaktimet ligjore, autoritetet kontraktuese, mund të marrin përsipër angazhime detyruese, me qëllim dhënien e garancive të përshtatshme në favor të partnerit privat, për tu mbrojtur nga pasojat negative financiare, të cilat mund të shkaktohen si pasojë e ndryshimeve të mëvonshme të legjislacionit. Këto angazhime mund të ndërmerren vetëm në rastet kur pasojat financiare dhe natyra e legjislacionit janë paracaktuar qartësisht dhe saktësisht dhe nuk mund të zgjasin përtej afatit të kontratës. Angazhimet detyruese të kësaj natyre, konsiderohen si dispozita stabilizuese dhe mund të ndërmerren vetëm nëpërmjet një vendimi të posaçëm të këshillit të Ministrave, bazuar në propozimin e autoritetit kontraktues<sup>10</sup>.

ix. rastet e zgjidhjes së parakohshme të kontratës dhe procedurat përkatëse;

Kontrata duhet të identifikojë ato raste të cilat kanë një rendësi të veçantë dhe sjellin pasoja të rënda, në nivele të tilla që justifikojnë vendimet për zgjidhjen e parakohshme të kontratës. Zgjidhja e kontratës nga ana e autoritetit kontraktues mund të lidhet me rastet kur partneri privat nuk mund të kryejë detyrimet e veta, për shkak të paaftësisë paguese, dështimin për të siguruar financimin e projektit apo në rastet e shkeljeve serioze të detyrimeve të tij

<sup>10</sup> Sipas dispozitave të nenit 41 "Dispozita e stabilizimit" të ligjit 125/2013

sipas kontratës. Por zgjidhja e kontratës është një mundësi që i jepet edhe partnerit privat në rastet e shkeljeve serioze të detyrimeve nga ana e autoritetit kontraktues. Kontrata mund të zgjidhet paraprakisht edhe me pëlqimin reciprok të palëve, si edhe në rastet kur verifikohen shkaqe objektive që e bëjnë të pamundur realizimin e saj.

Përveç identifikimit të rasteve konkrete që shkaktojnë zgjidhjen e parakohshme, kontrata duhet të përcaktojë edhe procedurat përkatëse që do të zbatohen nëse verifikohen këto raste. Këto procedura duhet të përcaktojnë komunikimet midis palëve, verifikimet e shkeljeve, njoftimet paraprake dhe procedurën për zgjidhjen e kontratës.

Zgjidhja e parakohshme e kontratës zbatohet në ato raste kur nuk ka qenë e mundur parandalimi i pasojave negative dhe kur shkeljet e verifikuara nuk janë shmangur dot, as pasi janë aplikuar mekanizme sanksionues.

Përpara se autoriteti kontraktues të zgjidhë në mënyrë të njëanshme dhe të parakohshme kontratën, duhet të kryejë një vlerësim të kujdesshëm nëse i ka plotësuar rregullisht të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kontratës dhe nëse zgjidhja e parakohshme dhe shkaqet e saj, janë në përputhje me dispozitat e kontratës. Ky vlerësim ka për qëllim që të shmangë penalitetet e mundshme që mund ti ngarkohen autoriteteve kontraktore, nga panelet e arbitrazhit apo nga gjykatat. në rastet e zgjidhjeve abuzive të kontratave.

Në rastet kur është autoriteti kontraktues ai që merr iniciativën për zgjidhjen e kontratës, ky autoriteti duhet që përpara zgjidhjes së kontratës, të informojë Ministrinë e Financave mbi shkaqet dhe rrethanat për zgjidhjen e kontratës dhe të kërkojë mendimin e saj<sup>11</sup>.

#### ii. Mekanizmat e zëvendësimit (step in rights);

Mekanizmat zëvendësues zbatohen në raste tepër të veçanta, dhe parashikojnë mundësinë që partneri privat të zëvendësohet në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të kontratës, nga një palë e tretë apo nga autoriteti kontraktues, me qëllim mos ndërprerjen e shërbimit publik të ofruar sipas kontratës.

Rasti i parë (lenders step in rights) verifikohet në rastet kur si pasojë e dështimit nga ana e partnerit privat për të realizuar në mënyrë të suksesshme projektin e PPP, rrezikohen edhe interesat financiare të palëve të treta të cilat në cilësinë e huadhënësve, e kanë financuar apo mbështetur financiarisht partnerin privat. Këto palë të treta kreditore, të cilat zakonisht janë institute bankare apo financiare, mund të zëvendësojnë partnerin privat në realizimin e

<sup>11</sup> Sipas dispozitave të nenit 36" Zgjidhja e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat" të ligjit 125/2013

objektit të kontratës, duke ndërrhyrë vetë apo nëpërmjet një partneri tjetër privat.

Kontrata duhet të përcaktojë rastet dhe procedurat e zbatimit të këtij mekanizmi zëvendësues, duke patur parasysh mbrojtjen e interesit publik por edhe interesat legjitime të financuesve të projektit. Step in rights mund të rregullohen edhe nëpërmjet kontratave të veçanta, të cilat mund ti bashkëlidhen kontratës së PPP apo të cilave i referohet kontrata e PPP

Rasti i dytë (public partner step in rights) zbatohet në raste të veçanta, në të cilat autoriteti kontraktues merr përkohësisht kontrollin e një projekti PPP, kur verifikohen probleme të cilat rrezikojnë ofrimin e shërbimeve publike, zakonisht në rastet e emergjencave mjedisore, shëndetësore apo të lidhura me sigurinë. Ky mekanizëm ka karakter të përkohshëm dhe lidhet me faktin që partneri publik mund të përballojë më mirë situatat e jashtëzakonshme të emergjencës.

Në të dyja rastet kontrata duhet të përcaktojë procedurën dhe të drejtat e ndërrhyrjes së partnerit publik, përfshirë njoftimin e ndërrhyrjes, pagesat përgjatë ndërrhyrjes, procedurat e rikthimit dhe përgjegjësitë e palëve, etj.

- x. çështjet e pronësisë së pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme;

Kontrata duhet të përcaktojë qartësisht statusin juridik, të drejtat e pronësisë dhe të drejtat e lidhura me pronësinë dhe përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe pasurive të tjera, të cilat janë objekt i kontratës. Gjithashtu duhet të përcaktohen edhe të drejtat e pronësisë dhe përdorimit mbi pasuritë dhe asetet e krijuara nga realizimi i kontratës, si përgjatë zbatimit të kontratës, ashtu edhe në momentin e përfundimit të saj.

- xi. mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;

Kontrata duhet të parashikojë se cilat do të jene mekanizmat që do të zbatohen për zgjidhjet e mosmarrëveshjeve të mundshme midis partnerit publik dhe privat. Ky është një aspekt tepër i rëndësishëm i kontratës, sepse ka për qëllim që për sa është e mundur, të parandalojë apo të zbusë pasojat negative të mosmarrëveshjeve, për të shmangur dështimin e projektit dhe zgjidhjen përfundimtare të kontratës. Mekanizmat kryesorë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve janë;

- ndërmjetësimi, pra rastet kur një palë e tretë e pavarur, përfshihet në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, duke rekomanduar mënyrën për zgjidhjen e konflikteve. Ndërmjetësimi përdoret kryesisht për të shmangur zgjidhjen me anë të procedurave gjyqësore apo të arbitrazhit.
- adresimi i çështjes tek një organ rregullator, zakonisht përdoret në PPP e zbatuara në sektorë ekonomikë të rregulluar dhe parashikon mundësitë që palët ti drejtohen organit kompetent rregullator për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre.

- zgjidhja në rrugë gjyqësore, parashikon që palët ti drejtohen gjykatave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre. Shpesh herë partnerët privatë kërkojnë të shmangin këtë mundësi, në shtete ku sistemi gjyqësor nuk ka nivele të larta ekspertize apo pavarësie nga ndërhyrjet politike.
- Arbitrazhi, i cili parashikon zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nëpërmjet adresimit të tyre tek një panel arbitrash apo ekspertësh. Arbitrazhi mund të jetë konsultativ (mendim jodetyrues për palët) apo vendimmarrës (në rastet kur parashikohet marrja e një vendimi përfundimtar dhe detyrimisht të zbatueshëm prej palëve). Po kështu arbitrazhi mund të jetë kombëtar ose ndërkombëtar. Në këto rast kontrata duhet të paracaktojë arbitrat dhe procedurën e zbatueshme, sipas rregullave të arbitrazhit.

Në të gjitha rastet, duhet patur parasysh dispozita detyruese e përcaktuar nga neni 46 i ligjit 125/2013, se kontrata e PPP rregullohet nga legjislacioni shqiptar i cili zbatohet edhe përgjatë procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis partnerit publik dhe privat.

xii. procedura e zbatueshme në përfundim të kontratës;

Kontrata duhet të mirë përcaktojë procedurën e zbatueshme në momentin e zgjidhjes së kontratës e cila mund të përfshijë kryerjen e disa veprimeve, të tilla si dorëzimi i punëve, shërbimeve apo aseteve të kontratës, kryerjen e verifikimeve përfundimtare të gjendjes së tyre si dhe pagesat e mundshme që mund të përfitojë partneri privat. Këto dispozita vlejné si në rastet kur kontrata zgjidhet në mënyrë të natyrshme, në përfundim të afatit të kohëzgjatjes së saj, ashtu edhe në rastet e zgjidhjes së parakohshme të saj.

Bazuar në përcaktimet e ligjit 125/2013, objektet e ndërtuara në bazë të një kontrate PPP, janë në pronësi të autoritetit kontraktues, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratën e PPP. Për pasojë, pas përfundimit të kontratës, partneri privat duhet të dorëzojë objektet e ndërtuara në bazë të kontratës, sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar në kontratë.

Kështu për shembull kontrata duhet të përcaktojë afate dhe modalitetet për dorëzimin e aseteve të kontratës. Kontrata mund të parashikojë që përpara përfundimit të kontratës, palët të komunikojnë sipas afateve të përcaktuara, për tu përgatitur dhe për të rregulluar modalitetet e dorëzimit të aseteve.

Gjithashtu autoriteti kontraktor mund të ketë të drejtë për të verifikuar, vetë apo nëpërmjet ekspertëve të pavarur, dorëzimin e aseteve në një gjendje të kënaqshme përdorimi, meqenëse do të vijojnë të përdoren në të ardhmen prej tij, për qëllime publike. Kontrata mund të parashikojë për këtë qëllim që partneri privat të respektojë disa standarde cilësie në momentin e dorëzimit të tyre apo të ofrojë garanci mbi përdorimin e ardhshëm të tyre. Po kështu autoriteti kontraktor mund të ketë interes që partneri privat të dorëzojë edhe një sasi të caktuar materialesh apo lëndësh të para, të cilat mundësojnë

përdorimin e aseteve apo shërbimeve edhe për një afat të caktuar pas datës së përfundimit të kontratës, për të mos shkaktuar ndërprerjen e shërbimeve.

Kontrata duhet të përcaktojë edhe mekanizma për verifikimin e standardeve dhe shmangjen e konflikteve në lidhje me fazën e dorëzimit të aseteve. Nga ana tjetër kontrata mund të parashikojë pagesa nga ana e autoriteti kontraktues në favor të partnerit privat, në momentin e dorëzimit dhe përfundimit të kontratës të lidhura me vlerën e aseteve apo me kushtet e pagesës sipas kontratës.

Përfundimi i suksesshëm i kontratës shkakton edhe kthimin e garancisë së kontratës në favor të partnerit privat.

Të gjitha këto aspekte duhet të jenë të përcaktuara dhe detajuar në kontratën e PPP.

#### xiii. mekanizmat për menaxhimin e kontratës

Faza e menaxhimit të kontratave është një fazë e cila fillon me nënshkrimin e kontratës dhe zgjat përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, deri në përfundimin e saj. Menaxhimi i kontratës përfshin;

- kryerjen e veprimeve të nevojshme dhe detyrave përkatëse, për zbatimin e kushteve të kontratës;
- administrimi i komunikimeve dhe marrëdhënieve midis palëve të kontratës;
- monitorimin e zbatimit të kontratës.

Kontrata duhet të përcaktojë nëpërmjet dispozitave të qarta dhe të detajuara, procedurat dhe mekanizmat e menaxhimit të kontratës, përgjatë zbatimit të saj.

Për menaxhimin e kontratave të PPP nga ana e autoriteteve kontraktuese, mund të jetë e dobishme që të përdoren disa mekanizma, si për shembull:

- Përcaktim i strukturave përgjegjëse për menaxhimin e kontratës
- Monitorim i zbatimit të kontratës së PPP
- Monitorim i rreziqeve të kontratës
- Menaxhim i situatave në të cilat nevojiten ndryshime të projektit të PPP.
- Kushtet për rinegocimin e kontratës
- Menaxhim i mosmarrëveshjeve midis palëve
- Përfundim i kontratës dhe dorëzimi i aseteve
- Zgjidhje e parakohshme e kontratës

Për këtë qëllim, dispozitat e kontratës duhet të kenë parasysh disiplinimin e procedurave dhe mënyrave të veprimit, për rregullimin e aspekteve të mësipërme. Përcaktime më të detajuara në lidhje me këtë fazë, jepen në kapitullin në vijim.

iii. mekanizmat e monitorimit të kontratës;

Një nga elementët më të rëndësishëm që lidhen me realizimin suksesshëm të një projekti dhe një kontrate PPP, lidhet me monitorimin e kontratës nga ana e autoriteti kontraktor. Monitorimi i kontratës ka për qëllim që të verifikojë zbatimin e përpiktë të të drejtave, detyrimeve, standardeve, afateve dhe procedurave të kontratës.

Kontrata duhet të përmbajë dispozita të cilat detajojnë mekanizmat e funksionimit të monitorimit të kontratës, të cilat përfshijnë së pari, dispozitat të cilat lidhen me shkëmbimin e informacionit dhe raportimet midis palëve. Për këtë qëllim duhet të identifikohet lloji dhe natyra e informacionit që duhet shkëmbyer, mënyra e mbledhjes, modalitetet, formatet dhe afatet e raportimit të tij si dhe personat apo organet dërgues dhe pritës i këtij informacioni. Në rastet kur përgjatë monitorimit verifikohen mospërputhje të qëndrimeve të të dy partnerëve në lidhje me zbatimin e kontratës, kontrata duhet të përcaktojë mekanizmat dhe strukturat për verifikimin e realizimit të tyre, të cilët mund të jenë edhe ekspertë apo organe të treta, të pavarura.

Kontrata duhet të ketë një plan dhe një sistem të mirëpërcaktuar monitorimi. Qëllimi primar i monitorimit është identifikimi në kohë reale i problematikave të hasura dhe reagimi i shpejtë i palëve. Palët duhet të përpiqen që të parandalojnë rreziqet apo problematikat, dhe në rast se ato verifikohen, të përpiqen të shmangin dhe të zbusin pasojat negativ të tyre.

Monitorimi i kontratës lidhet ngushtësisht me verifikimin nga ana e autoritetit kontraktues, të respektimit të standardeve të performancës në ngarkim të partnerit privat. Për këtë arsye kontrata duhet të parashikojë se cilat do të jenë mekanizmat e verifikimit. Gjithashtu, për situatat në të cilat mund të verifikohen qëndrime të ndryshme midis palëve në lidhje me faktin nëse standardet janë respektuar apo jo, kontrata duhet të parashikojë mekanizmat për zgjidhjen e tyre, për shembull nëpërmjet përcaktimit të ekspertëve apo organeve të treta e të pavarura.

Është e këshillueshme që kontrata të ketë një sistem të mirëpërcaktuar monitorimi të realizimit të objektivave të performancës, i cili të ketë mundësitë e identifikimit në kohë reale të problematikave të hasura, duke përcaktuar përshkallëzimin e mekanizmave të reagimit të autoritetit kontraktor. Këto mekanizma duhet të jenë fillimisht parandalues, më pas zbutës të pasojave negative të verifikuara dhe vetëm nëse mosrealizimi

vazhdon dhe intensifikohet, duhet të zbatohen mekanizmat sanksionues, apo në raste ekstreme, mekanizmat që çojnë në zgjidhjen e kontratës.

Faza e monitorimit të kontratës do të detajohet më hollësisht në kapitullin në vijim.

### c) Kontratat e tjera, të lidhura me kontratën e PPP

Ekziston mundësia përgjatë zbatimit të projekteve të PPP që përveç kontratës kryesore të PPP, palët të lidhin midis tyre dhe palëve të treta edhe marrëveshje të cilat janë të lidhura me këtë kontratë.

Kështu, përveç kontratës së PPP, autoriteti kontraktues mund të lidhë kontrata shtesë apo të kushtëzuara, me partnerin privat dhe me palë të treta. Këto kontrata shtesë dhe/ose të kushtëzuara, zakonisht janë kontrata e lidhura me qëllimin për të siguruar financimin e nevojshëm për zbatimin e kontratës. Për të siguruar financimin e kontratës, partnerët privatë zakonisht i drejtohen bankave apo subjekteve financues për përfitimin e kredive apo mekanizmave financues të përshtatshëm. Huadhënësit, me qëllim mbrojtjen e interesave të tyre të lidhura me kreditë e dhëna në favor të partnerit privat, mund të kërkojnë garanci të ndryshme për mbrojtjen e financimit të kontratës së PPP.

Këto garanci mund të jenë të formave të ndryshme dhe mund të përcaktohen nëpërmjet kontratave të posaçme. Një nga rastet më të shpeshta verifikohet kur subjektet financues të kontratës, kërkojnë që partneri privat i cili ka përfituar kredi financiare, të sigurojë në favor të kreditorëve, të drejtat e tij në lidhje me pagesat e përfituara nga kontrata e PPP. Ky sigurim nuk mund të krijohet pa pëlqimin e autoritetit kontraktues dhe mund të bëhet vetëm në favor të institucioneve financiare për të siguruar pretendimet e këtyre institucioneve, mbi bazën e kontratës së kredisë<sup>12</sup>.

Për mbrojtjen e interesave të mësipërm, huadhënësit mund të kërkojnë edhe të drejtat e zëvendësimit në rastet kur realizimi i projektit të PPP, vihen në rrezik si pasojë e dështimit të partnerit privat. Në këto raste kreditorët mund të zëvendësojnë rolin e partnerit privat, nëpërmjet ndërhyrjes së tyre apo përzgjedhjes së një partneri tjetër privat, për realizimin e kontratës, duke arritur që në këtë mënyrë të mbrojnë edhe interesat e tyre financiare. Ky mekanizëm zëvendësimi (lender step in rights) mund të rregullohet në një kontratë të veçantë, të lidhur me midis financuesve, partnerit privat apo edhe partnerit publik.

Në të gjitha rastet kur nënshkruhen kontrata të veçanta, të cilat kanë lidhje dhe ndikime mbi kontratën kryesore të PPO, këto kontrata mund ti bashkëlidhen kontratës kryesore, ose mundet që dispozitat e kësaj kontrate të kenë referenca të posaçme në lidhje me detyrimet dhe procedurat e zbatueshme që lindin sipas këtyre kontratave.

---

<sup>12</sup> Sipas dispozitave të nenit 40 "Interesat e sigurisë" të Ligjit 125/2013





## KAPITULLI 13

## ZBATIMI DHE MENAXHIMI I KONTRATËS SË PPP

Pas negocimit dhe lidhjes së kontratës dhe me fillimin e zbatimit të saj, nis edhe faza e menaxhimit të kontratës. Menaxhimi i kontratave të PPP nga ana e autoriteteve kontraktuese përfshin kryerjen e veprimeve të nevojshme për zbatimin e kushteve të kontratës së PPP dhe administrimin e marrëdhënieve midis partnerit publik dhe privat si monitorimin e saj. Faza e menaxhimit të kontratave është një fazë e cila fillon me nënshkrimin e kontratës dhe zgjat përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, deri në përfundimin e saj.

Legjislacioni mbi koncesionet dhe PPP, nuk përmban dispozita të detajuara në lidhje me monitorimin dhe menaxhimin e kontratës, por nga një analizë e tërësishme e këtij legjislacioni, arrihet në përfundimin se çështjet e lidhura me menaxhimin e kontratës, duhet të paracaktohen dhe të disiplinohen, nga dispozitat e kontratës së PPP të lidhur midis palëve. Në të gjitha rastet, legjislacioni përcakton se autoriteti kontraktor është organi kryesor i cili duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, duke bashkëpunuar për këtë qëllim edhe me Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve.

Për këto arsye, ky kapitull bazohet jo vetëm në analizën e legjislacionit shqiptar në fuqi, por edhe në një vlerësim të praktikave më të mira dhe të guidave të organeve ndërkombëtare në lidhje e zbatimin e projekteve të PPP dhe në veçanti monitorimin e kontratave.

Faza e menaxhimit të kontratës së PPP ka si qëllim që të sigurojë plotësimin e kushteve të kontratës, në veçanti nëse;

- Punët apo shërbimet objekt i kontratës realizohen dhe ofrohen rregullisht, në përputhje me me kriteret dhe standardet e kontratës;
- Përgjegjësitë sipas kontratës dhe ndarja e rrezikut zbatohen në praktikë dhe në veçanti nëse përgjegjësitë dhe rreziqet e autoritetit kontraktor menaxhohen në mënyrë efikase;
- Ndikimet e projektit kanë qenë pozitive apo negative për territorin dhe popullatën.

Së pari, për sa i përket menaxhimit të kontratës, duhet të merret në konsideratë parimi i përgjithshëm sipas të cilit baza më e mirë për të menaxhuar në mënyrë efektive zbatimin, është vetë kontrata e PPP. Për këtë arsye dispozitat e kontratës, duhet të përcaktojnë në mënyrë të plotë dhe të qartë, fazën e zbatimit të kontratës duke detajuar procedurat e menaxhimit dhe të monitorimit. Për menaxhimin e kontratave të PPP nga ana e

autoriteteve kontraktuese, mund të përdoren disa mekanizma, disa prej të cilëve përshkruhen në vijim:

- Përcaktimi i strukturave përgjegjëse për menaxhimin e kontratës.

Autoriteti kontraktor duhet që të identifikojë organin, strukturën apo njësinë përgjegjëse për menaxhimin e kontratës, si dhe të përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësitë përkatëse. Autoritetet kontraktuese mund të emërojnë një Menaxher Projekti apo një Njësi/Grup për Menaxhimin e Projektit.

Pas lidhjes së kontratës së PPP, përgjegjësia e menaxhimit të kontratës zakonisht i transferohet një njësie të caktuar nga autoriteti kontraktor i cili do të kryejë kontrollin e vazhdueshëm të zbatimit të kontratës. Në rastet kur ka disa kontrata të ngjashme PPP (p.sh. disa kontrata PPP për ndërtimin apo mirëmbajtjen e disa rrugëve), është e këshillueshme që menaxhimi i tyre të bëhet nga i njëjti ekip që në këtë mënyrë krijon eksperiencën dhe mbart njohuritë e nevojshme për një monitorim sa më efikas.

Struktura përgjegjëse për menaxhimin e kontratës duhet të ketë burime dhe kapacitete profesionale të mjaftueshme si edhe një nivel hierarkik të tillë që të lehtësojë komunikimet jo vetëm më partnerin privat por edhe me organet e tjera publike të cilat përfshihen në zbatimin e projektit. Në lidhje me këto organe, këto mund të jenë organet të cilat kanë kompetenca sektoriale të lidhura me zbatimin e një projekti specifik apo organe të cilat kanë kompetenca të lidhura në fushën e koncesioneve të tilla si Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve apo Ministria e Financave.

Struktura përgjegjëse për menaxhimin e kontratës duhet të kryejë për llogari të autoritetit kontraktor, të gjitha veprimet dhe procedurat e parashikuara nga kontrata, në zbatim të të drejtave dhe të detyrimeve të partnerit publik sipas kontratës.

- Monitorimi i zbatimit të kontratës së PPP

Monitorimi i kontratës ka për qëllim verifikimin e zbatimit në mënyrë korrekte të detyrave, nivelin e përputhshmërisë dhe standardet e zbatuara nga partneri privat, si edhe zbatimin korrekt të detyrave dhe përgjegjësive të autoritetit kontraktor.

Monitorimi mund të bazohet mbi informacionet dhe të dhënat e mbledhura në lidhje me zbatimin e kontratës. Burimet e këtyre informacioneve mund të jenë të ndryshme, të tilla si raportimet dhe të dhënat e ofruara nga partneri privat, vlerësimet e kryera nga ekspertë të pavarur apo edhe nga anketimet dhe përshtypjet e përdoruesve fundorë të punëve apo shërbimeve të cilat janë objekt i Koncesionit/PPP. Burimet e informacioneve të cilat do të shërbejnë për monitorimin duhet të identifikohen dhe të përcaktohen në kontratat e PPP. Për shembull kontrata mund të përcaktojë detyrime të tilla si; kryerja e

auditimeve financiare dhe e verifikimeve teknike në mënyrë periodike, duke përcaktuar afatet dhe subjektet e pavarura që do ti kryejnë ato. Gjithashtu kontrata mund të kërkojë respektimin e standardeve të caktuara, duke përcaktuar standardet specifike dhe organet certifikuese.

Kontrata e PPP duhet të ketë përcaktuar në mënyrë të qartë detyrimet e partnerit privat, të cilat duhet të përcaktojnë midis të tjerash, karakteristikat e punimeve, nivelet e pritura të shërbimeve, standardet e cilësisë, modalitetet e realizimit të tyre dhe afatet kohore.

Menaxhimi efektiv i kontratës është i lidhur ngushtë me zbatimin e përpiktë të procedurave, mënyrave dhe afateve të monitorimit të përcaktuara në kontratë. Kjo kërkon që autoriteti kontraktor ashtu edhe partneri privat, të kenë të qarta modalitetet e monitorimit dhe të raportimit. Për këtë arsye kontrata duhet të përcaktojë afatet, format dhe mënyrat e duhura të raportimit nga ana e partnerit privat, ku këshillohet të përfshihet edhe një format standard raportimi periodik apo i posaçëm, i rënë dakord mes palëve në kontratë, si edhe procedurat dhe mënyrat e monitorimit të kryera nga autoriteti kontraktor.

- Monitorimi i rreziqeve të kontratës

Menaxhimi i rreziqeve ka për qëllim kontrollimin e rreziqeve të një kontrate PPP, duke verifikuar që planifikimi i ndarjes së rreziqeve të parashikuara në kontratë, të zbatohet efektivisht. Ky menaxhim arrihet duke monitoruar nivelet e rreziqeve, duke marrë masa për parandalimin, zbutjen dhe shmangjen e pasojave të tyre, por edhe duke zbatuar sanksionet përkatëse të parashikuara nga kontrata, në rastet kur është e nevojshme.

Një instrument efikas i përdorur për këtë qëllim është hartimi i një plani të menaxhimit të rrezikut, apo e një matrice të rreziqeve, i cili liston rreziqet e lidhura me projektin dhe përcakton palën e cila do të mbajë përsipër këtë rrezik. Disa rreziqe të kontratës mund ti ngarkohen ekskluzivisht partnerit privat, disa të tjerë ekskluzivisht partnerit publik ndërsa disa rreziqe të kontratës mund të ndahen midis partnerit publik dhe atij privat.

Për secilin rrezik të identifikuar, duhet të përcaktohet informacioni i cili duhet të jepet nga palët, me qëllim monitorimin e rrezikut konkret si dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme për parandalimin, zbutjen apo shmangjen e pasojave të tij. Ky plan menaxhimi i rreziqeve si edhe mënyra e raportimit dhe monitorimit, duhet të përcaktohen në kontratën e PPP.

Monitorimi i rreziqeve duhet të ketë si qëllim kryesor, reagimin në kohë dhe marrjen e masave të nevojshme për shmangjen e pasojave të rënda, të cilat mund të shkaktojnë dështimin e një projekti PPP.

- Menaxhimi i situatave në të cilat nevojiten ndryshime të projektit të PPP.

Ky lloj menaxhimi duhet të përballojë në mënyrë të suksesshme situatat në të cilat është e nevojshme që të kryhen ndryshime në kontratë. Kontratat e PPP zakonisht kanë një kohëzgjatje të konsiderueshme, deri në 35 vjet dhe përgjatë kësaj periudhe mund të verifikohen situata të cilat nuk ishin parashikuar fillimisht në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Gjithashtu mund të ndodhë që palët e kontratës të kenë mospërputhje apo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin korrekt të kontratës, të cilat mund të shkaktojnë edhe në përfundimin e parakohshëm të kontratës. Këto situata të mundshme shpesh herë nuk mund të shmangen, por e rëndësishme është që të mirë menaxhohen nëpërmjet një procesi transparent, efikas dhe që garanton mbrojtjen e interesave të secilës palë të përfshirë, si dhe kur është e mundur vazhdimin e shërbimit publik pa ndërprerje.

Për këtë qëllim kontrata duhet të parashikojë për sa është e mundur, rastet dhe mekanizmat për ndryshimin, rishikimin dhe rinegocimit të kontratës, zgjidhjet e mosmarrëveshjeve apo rastet e zgjidhjes së parakohshme të kontratës.

Një nga mekanizmat më të përdorur ndërkombëtarisht për menaxhimin e ndryshimeve, është mekanizmi i bazuar mbi “dispozitat e ekuilibrit financiar”. Dispozitat e ekuilibrit financiar i japin të drejtën palëve të kontratës, që në rastet e situatave të paparashikuara të cilat kanë sjellë impakt negativ mbi njërin palë, të kërkojnë ndryshime të kushteve të kontratës, të cilat kompensojnë dhe rivendosin ekuilibrin financiar të parashikuar në momentin e nënshkrimit të kontratës. Këto ndryshime dhe përshtatje, bazohen mbi një model të ekuilibrit financiar për të cilin është rënë dakord paraprakisht nga palët në kontratën e PPP.

Kontratat mund të ndryshohen vetëm nëse kjo mundësi parashikohet në dokumentacionin e tenderit dhe në kontratë.

Kontratat e mirë strukturuara të PPP, përmbajnë klauzola specifike të cilat parashikojnë rregullimin e pasojave të disa prej faktorëve të cilët ndikojnë mbi projektin dhe që mund të verifikohen më shpesh. Tre nga shkaqet tipike të cilat prishin ekuilibrin financiar, janë rastet e Forcës Madhore (fatkeqësi të mëdha natyrore ose trazira civile), factum principis (veprime të autoritetit kontraktor apo të qeverisë) dhe ius variandi (verifikimi i ndryshimeve të paparashikuara të kushteve ekonomike të kontratës si pasojë e faktorëve të jashtëm).

- Rinegocimi i kontratës

Ekziston mundësia që palët të rinegociojnë kushtet e kontratës. Rinegocimi nënkupton ndryshime të kushteve të kontratës, për të cilat është rënë dakort fillimisht. Ndryshimet si pasojë e rinegocimit janë të ndryshme nga ndryshimet e aplikuar sipas mekanizmave të parashikuar paraprakisht në kontratë.

Parimisht, mekanizmi i renogicimit duhet shmangur sa më tepër që të jetë e mundur nga autoritetet kontraktuese, pasi ndryshon kushtet fillestare të kontratës për të cilat është rënë dakord fillimisht, rrezikon shtrembërimin e tregut dhe mund të shkaktojë pasoja mbi konkurrencën lirë. Për këtë qëllim autoritetet kontraktuese duhet të përcaktojnë në kontratë, për sa është e mundur, mekanizmat e sipërpërmendur për rregullimin e pasojave dhe ndryshimeve të kontratës. Megjithatë ka raste kur rinegociimi nuk mund të shmanget, si pasojë e verifikimit të situatave të paparashikuara dhe kur është në përputhje me interesin publik dhe të palëve kontraktore.

- Menaxhimi i mosmarrëveshjeve midis palëve

Midis palëve mund të lindin mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin e përgjegjësive sipas kontratës. Për shmangjen e pasojave që do të shkaktonin këto mosmarrëveshje dhe zgjidhjen e kontratës, vetë kontrata e PPP duhet të përmbajë mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve. Mekanizmat tipikë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mund të jenë;

- sistemi gjyqësor;
- arbitrazhi kombëtar ose ndërkombëtar;
- panel ekspertësh (ky opsion është përdorur shpesh për zgjidhjen e çështjeve tepër specifike, si p.sh një çështje teknike apo financiare, dhe mund të jetë një vendim i përkohshëm i cili më pas mund të ankimohet në rrugë gjyqësore apo në arbitrazh);
- ndërmjetësimi ose pajtimi; dhe
- një vendim i marrë nga një organ i specializuar rregullator.

Me qëllim shmangjen e pasojave dhe të dëmeve të shkaktuara nga mosmarrëveshjet e palëve, autoritetet kontraktuese duhet të veprojnë me këto modalitete;

- të reagojnë në mënyrë të shpejtë, sapo lindin problematikat;
- të përpiqen ti zgjidhin problemet që në nivelet e ulëta hierarkike;
- të kenë ekipe me eksperiencën dhe aftësitë e duhura dhe nivel të përshtatshëm vendimmarrjeje për zgjidhjen e çështjes;
- të ndjekin përpikmërisht procedurat e përcaktuara në kontratë;
- të kërkojnë zgjidhje të cilat kënaqin të dy palët, në interes të publikut dhe të palëve kontraktore.

Autoritetet kontraktuese duhet të përpiqen të shmangin përshkallëzimin e mosmarrëveshjeve të cilat mund të shkaktojnë zgjidhjen e kontratës dhe dështimin e projektit. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në rrugë gjyqësore duhet të

konsiderohet si zgjidhje e fundit për shkak se shkakton situata ngërci apo rreziku të cilat nuk sjellin dobi për asnjë nga palët e interesuara.

- Përfundimi i kontratës dhe dorëzimi i aseteve

Faza e fundit e menaxhimit të kontratave të PPP lidhet me kryerjen e veprimeve dhe administrimin e procedurave transitore në momentin e përfundimit të kontratës dhe marrjes në dorëzim nga autoriteti kontraktor të aseteve të saj.

Kjo fazë përfshin dorëzimin nga ana e partnerit privat tek autoriteti kontraktor, të punëve, shërbimeve dhe aseteve të cilat janë objekt i kontratës. Për pasojë kjo fazë përfshin të gjitha procedurat dhe veprimet e nevojshme të cilat duhen kryer nga palët, të tilla si kryerja e pagesave të mundshme, modalitetet e dorëzimit, verifikimet, dokumentet e marrjes në dorëzim apo aspekte të tjera.

Të gjitha këto veprime dhe procedura transitore për dorëzimin e aseteve në momentin e përfundimit të kontratës, duhet të detajohen qartësisht në kontratën e PPP, në mënyrë që palët të mos kenë paqartësi apo konflikte në momentin e përfundimit të marrëdhënieve kontraktore midis tyre.

- Zgjidhja e parakohshme e kontratës

Përveç rasteve kur kontrata përmbyllet me sukses si pasojë e përfundimit të afatit të parashikuar, ekziston mundësia që kontratat të zgjidhen edhe përpara skadimit të afatit normal të përcaktuar. Zgjidhjet e parakohshme të kontratës mund të shkaktohen nga disa faktorë;

- si pasojë e mospërbushjes nga partneri privat;
- si pasojë e mospërbushjes nga partneri publik;
- nga një vendim i njëanshëm i partnerit publik;
- nga një vendim i njëanshëm i partnerit publik;
- si pasojë e efekteve të zgjatura të shkaktuara nga Forca madhore;
- me pëlqimin e të dyja palëve.

Kontrata e Koncesionit/PPP duhet të përshkruajë në mënyrë të detajuar rrethanat të cilat lejojnë palët që të zgjidhin kontratën dhe pasojat e kësaj zgjidhjeje. Në mënyrë të veçantë, kontrata duhet të disiplinojë rastet në të cilat njëra palë ka dështuar në përbushjen e detyrimeve të saj sipas kontratës, të cilat janë të një rëndësie të tillë që shkaktojnë zgjidhjen e kontratës.

Si rregull zgjidhja e kontratës është një mekanizëm drastik i cili shkakton ndërprerjen e marrëdhënieve kontraktore, ndaj për sa është e mundur, kontrata duhet të parashikojë modalitete dhe afate të përshtatshme, të cilat mundësojnë rregullimin e mospërbushjeve kontraktore, për të shmangur zgjidhjen e kontratës. Në rastet kur verifikohen pamundësi, mangësi apo

mospërbushje të rregullt të kushteve të kontratës, kontrata duhet të përcaktojë së pari, mekanizma zbutës të ndikimeve negative të kësaj mospërbushje, me qëllim mundësimin e riparimit në kohë të shkurtër të problematikave të hasura dhe vazhdimin e rregullt të kontratës. Së dyti kontrata duhet të përcaktojë aplikimin e sanksioneve, në formën e pagesave, penaliteteve apo gjobave, në lidhje me mospërbushjet e verifikuara, të cilat duhet të vendosen në përpjesëtim me dëmin e krijuar dhe me rrethanat konkrete që kanë shkaktuar mospërbushjen.

Kontrata mund të parashikojë edhe situatat kur verifikohen mospërbushje të përsëritura të detyrimeve kontraktore, duke përcaktuar përshkallëzimin e sanksioneve dhe penaliteteve të aplikuara. Gjithashtu kontrata duhet të specifikojë numrin e mospërbushjeve, që shkakton zgjidhjen e kontratës.

## KAPITULLI 14

## VLERËSIMI I REZULTATEVE TË KONTRATËS PAS PËRFUNDIMIT TË SAJ

Pas përfundimit të kontratës së PPP, edhe pse nuk është një detyrim i përcaktuar aktualisht nga legjislacioni mbi PPP, bazuar në praktikat më të mira dhe në interesin e autoritetit kontraktor, është e nevojshme ky autoritet të kryejë edhe një vlerësim të kontratës së realizuar.

Ky vlerësim ka për qëllim të kryejë një analizë të efekteve të zbatimit të kontratës, me qëllim identifikimin e aspekteve të suksesshëm ose të pasuksesshëm përgjatë realizimit të kontratës. Rezultatet e kësaj analize do të shërbejnë si mësim për të përmirësuar vendimet e ardhshme të autoritetit kontraktor përgjatë identifikimit, hartimit dhe zbatimit të kontratave të PPP në të ardhmen.

Vlerësimi do të duhet që të analizojë të gjitha aspektet e kontratës, duke verifikuar nëse pritshmëritë e autoritetit kontraktor në momentin e hartimit të studimit të fizibilitetit, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe më pas gjatë zbatimit të kontratës, u realizuan me sukses, në formën më të mirë të mundshme dhe sollën impaktin pozitiv që pritej. Po kështu analiza duhet të identifikojë dobësitë, zgjedhjet e gabuara apo problematikat që dolën në pah përgjatë zbatimit të kontratës.

Vlerësimi duhet të përcaktojë kriteret dhe metodologjinë e cila do të përdoret për të nxjerrë përfundimet e kërkuara, me qëllim arritjen e një analize të plotë dhe gjithëpërfshirëse. Kjo analizë duhet të përdorë edhe kriteret krahasuese, pra të verifikojë nëse rezultatet e arritura nga kontrata e PPP, mundet të realizoheshin nga kontrata alternative.

Në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më i saktë dhe objektiv, duhet që analizat e kontratave të kryhen nga njësi të pavarura dhe nga persona të cilët zotërojnë ekspertizën dhe profesionalizmin e duhur. Në disa raste janë njësitë kombëtare të auditimit apo kontrollit organet që ndërmarrin studime të tilla ndërsa në raste të tjera vlerësimi ex post mund të kryhet nëpërmjet një konsulence të pavarur, sidomos kur në kapacitetet e ekspertimit nuk disponohen brenda një organi publik.

Në fazën e vlerësimit të kontratës pas përfundimit të saj, vlerësimi do të bazohej mbi informacionet e mbledhura përgjatë fazës së menaxhimit të kontratës, e cila gjithashtu bazohet mbi mbledhjen e të dhënave sipas përcaktimeve të kontratës. Ndaj edhe në këtë rast, për të patur një vlerësim të suksesshëm, pikënisja është tek hartimi i një kontrate të plotë të PPP.



**Model**

**KONTRATË KONCESIONI**

**PËR**

**SHËRBIME PUBLIKE**

**Ndërmjet**

**AUTORITETIT KONTRAKTUES**

**dhe**

**PARTNERIT PRIVAT**

## **ANEKSET**

Aneksi 1	Përkufizimet
Aneksi 2	Dokumentet e Tenderit
Aneksi 3	Oferta e Koncesionarit
Aneksi 4	Nivelet e Shërbimit
Aneksi 5	Plani i Zbatimit
Aneksi 6	Sigurimi
Aneksi 7	Çështje financiare
Aneksi 8	Garancia e Kontratës
Aneksi 9	Personeli kyç
Aneksi 10	Dorëzimi dhe Pranimi
Aneksi 11	Zgjidhja e konflikteve
Aneksi 12	Procedura e Monitorimit

**KJO MARRËVESHJE** lidhet më datë \_\_.\_\_.2016 në \_\_\_\_\_, Shqipëri

**NDËRMJET:**

\_\_\_\_\_ (në vazhdim referuar si **“Autoriteti”**), përfaqësuar nga  
\_\_\_\_\_.

**DHE**

\_\_\_\_\_ (në vazhdim referuar si **“Koncesionari”**);

### **DEKLARIME PARAPRAKE**

Në përputhje me sa vijon:

- Ligji nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat”, i ndryshuar;
- Vendimin e Autoritetit Kontraktues \_\_\_\_\_;

Autoriteti është i autorizuar që të arrijë këtë Marrëveshje;

### **MEQENËSE**

- (A) Autoriteti ka miratuar më datë \_\_.\_\_.\_\_\_\_ Dokumentet e Procedurës së Konkurrimit për dhënien e Koncesionit “\_\_\_\_\_”, këtu bashkangjitur si Aneksi 2 i kësaj Marrëveshje;
- (B) Koncesionari ka paraqitur më datë \_\_.\_\_.\_\_\_\_ një propozim në përgjigje të një tenderi të tillë në lidhje me Koncesionin “\_\_\_\_\_”, këtu bashkangjitur si Aneksi 3 i kësaj Marrëveshje, propozim i cili është pranuar nga Autoriteti;
- (C) Autoriteti i ka dërguar Koncesionarit më datë \_\_.\_\_.\_\_\_\_ “Njoftimin e Fituesit”, duke pranuar propozimin e paraqitur nga Koncesionari dhe duke caktuar këtë Koncesion ndaj këtij Koncesionari;
- (D) Autoriteti dhe Koncesionari përfshihen në këtë Marrëveshje me qëllimin për të vënë në jetë Koncesionin në përputhje me afatet dhe dispozitat e përcaktuara në këtë Marrëveshje;
- (E) Koncesionari, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshje do të caktojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (në vazhdim “Shoqëria Koncesionare”), e cila, përveçse për sa përcaktohet ndryshe do të jetë e ngarkuar me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit sipas kësaj

*Marrëveshje të tanishme Koncesioni;*

### **Përkufizimet dhe interpretimi**

Në këtë Marrëveshje, do të zbatohen përkufizimet e paraqitura në Aneksin 1 (Përkufizime).

### **Kujdesi i duhur**

Koncesionari njeh dhe pranon faktin që:

- a) ka bërë dhe do të bëjë kërkimet e veta për të gjitha çështjet përkatëse për zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tij bazuar në këtë Marrëveshje, duke përfshirë kërkimin e informacionit të tillë nga Autoriteti pasi Koncesionari beson se kërkohet për një qëllim të tillë;
- b) ka ngritur të gjitha çështjet e arsyeshme mbi kujdesin e duhur përpara Autoritetit përpara Datës Efektive;
- c) është ndërgjegjësuar për sa i përket përmbajtjes dhe kërkesave të Autoritetit të referuara në Anekset 2 (Dokumentet e Tenderit) dhe 3 (Oferta e Koncesionarit); dhe
- d) ka të gjithë njohurinë, të drejtat, pajisjet, programet kompjuterike, sistemet dhe personelin e nevojshëm me qëllim që t'i japë mundësi atij të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë mundësinë për të përmbushur dhe realizuar kërkesat e Ofertës së Koncesionarit.

Autoriteti garanton që të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion të Koncesionarit me shkrim janë të sakta, të përpikta dhe të vërteta, duke përfshirë këtu Dokumentet e Tenderit.

### **Dhënia e Koncesionit**

Në përputhje më afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe Programet bashkangjitur, Autoriteti jep dhe autorizon Koncesionarin të zbatojë shërbimet e \_\_\_\_\_.

3.2 Koncesionari do të sigurojë shërbimet e \_\_\_\_\_;

3.3 Për qëllimin e sigurimit të shërbimeve të përshkruara më lart, objekti i kësaj Marrëveshje do të përfshijë gjithashtu:

- a) ndërtimin nga Koncesionari të një Objekti Kryesor të Shërbimeve të vendosur në \_\_\_\_\_ nëpërmjet ndërtimit fizik, përshtatjes me kushtet e nevojshme të sigurisë dhe teknologjisë që do të përdoret në përputhje me kushtet e përcaktuara në Anekset 2 (Dokumentet e Tenderit) dhe 3 (Oferta e Koncesionarit).
- b) përcaktimi i një rrjeti të zyrave për ofrimin e shërbimeve \_\_\_\_\_;
- c) \_\_\_\_\_

#### 4. Periudha e Koncesionit

4.1 Koncesioni sipas kësaj kontrate jepet për një periudhë prej \_\_ (\_\_\_\_\_) vjetësh nga Data Efektive dhe përfundon në ditën e përvjetorit të \_\_\_\_\_ të datës Efektive (“Periudha e Koncesionit”). Megjithatë, në rastin e Përfundimit, Periudha e Koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet tek periudha që fillon nga Data Efektive dhe mbaron në Datën e Përfundimit.

#### 5. Data Efektive e Marrëveshjes

5.1 Data Efektive e kësaj Marrëveshje do të jetë data në të cilën do të jenë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) ekzekutimi i kësaj Marrëveshje nga të dyja Palët në Datën e Ekzekutimit;
- b) \_\_\_\_\_.

(ii) hyrja në fuqi e Vendimit të Këshillit të Ministrave që miraton këtë Marrëveshje.

5.2 Në rast se Data Efektive nuk hyn në veprim brenda një periudhe prej 60 ditësh që nga Data e Ekzekutimit të kësaj Marrëveshje, secila nga Palët do të ketë të drejtën që ta përfundojë këtë Marrëveshje duke dhënë një Njoftim Përfundimi ndaj Palës tjetër. Në vijim të marrjes së një Njoftimi Përfundimi të tillë, Palët në këtë Marrëveshje nuk do të kenë të drejta apo detyrime të mëtejshme sipas kësaj Marrëveshje (përveç të drejtave dhe detyrimeve të tilla që sipas termave të tyre të shprehura janë mbi përfundimin e kësaj Marrëveshje sipas Nenit 33 (Konfidencialiteti) dhe Nenit 54 (Ligji rregullues dhe Arbitrazhi).

#### 6. Plani i Zbatimit të Projektit

6.1 Koncesionari do të sigurojë Shërbimet në përputhje me Etapat dhe Afatet Kohore të përcaktuara në Planin e Zbatimit të Projektit sipas Aneksit 5 (Plani i Zbatimit).

## 7. Vonesat në zbatim

7.1 Nëse, në çdo kohë, Koncesionari ndërgjegjësohet se ai nuk do të (apo se ka pak të ngjarë që të) arrijë cilindo nga Etapat sipas Afateve kohore ai do të njoftojë menjëherë Autoritetin mbi faktin e Vonesës e dot ë përmbledhë arsyet për këtë.

7.2 Koncesionari, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se sa 10 ditë pune pas njoftimit fillestar sipas Nenit 7.1, do t'i japë Autoritetit hollësi të plotë me shkrim për:

- a) Arsyet e Vonesës;
- b) Pasojat e Vonesës; dhe
- c) Nëse Koncesionari pretendon se Vonesa vjen për shkak të Autoritetit, arsyen pse e paraqet atë pretendim.

7.3 Çfarëdo konflikti në lidhje me apo si rrjedhë e Vonesave do të zgjidhet përmes Procedurës për Zgjidhjen e Konfliktëve. Gjatë kohës së zgjidhjes së Konfliktit të dy Palët do të vazhdojnë të punojnë për të zgjidhur shkaqet apo për të ulur pasojat e Vonesës.

7.4 Koncesionari do të paraqesë një projekt të Planit të Korrigjimit nëse:

- a) ai ndërgjegjësohet se nuk do të arrijë realizimin e Etapave në Afatin kohor përkatës; ose
- b) ai ka dështuar në përpjekjen që të arrijë realizimin e Etapave në Afatin kohor përkatës, nëse ky dështim vjen si rrjedhë e:
  - (i) dështimit për të ofruar Shërbimet sipas Etapës përkatëse; ose
  - (ii) \_\_\_\_\_

7.5 Projekt Plani i Korrjigimit do të identifikojë çështjet që rrjedhin nga Vonesa dhe hapat që Koncesionari propozon që të ndërmerren për të realizuar Etapën në përputhje me këtë Marrëveshje.

7.6 Projekt Plani i Korrjigimit do t'i paraqitet Autoritetit për miratim sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 10 ditë pune pas njoftimit fillestar sipas Nenit 7.1 apo dërgimit të një Raporti Mospërputhje.

7.7 Autoriteti nuk do të refuzojë miratimin e tij për një Projekt Plan Korrjigimi në mënyrë të paarsyeshme. Nëse Autoriteti nuk miraton Projekt Planin e Korrjigimit, ai do të informojë Koncesionarin mbi arsyet e tij dhe Koncesionari do të marrë parasysh këto arsye në përgatitjen e Projekt Plani të mëtejshëm të Korrjigimit, i cili do t'i paraqitet Autoritetit brenda 10 ditësh pune nga refuzimi i projektit të parë.

## **8. Vonesat për Shkak të Pazotësisë së Koncesionarit**

8.1 Nëse Shërbimet nuk përmbushin Kriteret e Pranimit të përcaktuara në Aneksin 4 (Nivelet e Shërbimeve) dhe/ose secila nga Etapat e përcaktuara në Aneksin 5 (Plani i Zbatimit) nuk arrihet si pasojë e Pazotësisë së Koncesionarit, Autoriteti do të lëshojë një Raport të Mospërputhjes ndaj Koncesionarit duke përcaktuar me hollësi mospërputhjet e Shërbimeve. Në rast të Mospërputhjeve, Koncesionari do të ketë 30 (tridhjetë) ditë kohë për rregullimin e mospërputhjeve.

8.2 \_\_\_\_\_

## **9. Vonesat për Shkak të Pazotësisë së Autoritetit**

9.1 Nëse Koncesionari do të kishte qenë i aftë që të realizonte Etapën brenda Afatit Kohor përkatës por nuk arritur ta bëjë këtë si pasojë e një Shkaku të Autoritetit atëherë, Koncesionari do të përfitojë nga të drejtat dhe lehtësimi i përcaktuar në këtë Nen.

- a) do t'i lejohet një zgjatje e afatit e barabartë me Vonesën e shkaktuar nga Shkaku i Autoritetit;
- b) nuk do të ketë përgjegjësi për Pagesat e Vonesës në lidhje me realizimin etapës përkatëse në masën që Vonesa vjen drejtpërdrejt nga Shkaku i Autoritetit, dhe;
- c) do të ketë të drejtën të ngrejë pretendime për shpenzimet e kryera nga Koncesionari për shkak të Pazotësisë së Autoritetit

9.2 Në këto raste Autoriteti:

- a) do të marrë në konsideratë kohëzgjatjen e Vonesës, natyrën e shkakut dhe pasojën e Vonesës si edhe Pazotësinë e Autoritetit mbi aftësinë e Koncesionarit për të vepruar në përputhje me Planin e Zbatimit;
- b) do të këshillohet me Përfaqësuesin e Koncesionarit në përcaktimin e pasojës së Vonesës dhe në atë se si të pakësohen pasoja të tilla atje ku kjo është e praktikueshme në mënyrë të arsyeshme;
- c) do të caktojë një Datë të Rishikuar për realizimin e Etapës; dhe
- d) nëse është e nevojshme do të bëjë çdo rishikim vijues ndaj Etapave vijuese në Planin e Zbatimit.

## 10. Shërbimet

10.1 Koncesionari do të sigurojë Shërbimet dhe do të sigurojë që Shërbimet:

- a) të përputhen në të gjitha aspektet me Dokumentet e Tenderit siç përcaktohet tek Aneksi 2 (Dokumentet e Tenderit);
- b) të ofrohen në përputhje me Ofertën e Koncesionarit të parashikuar në Aneksin 3 (Oferta e Koncesionarit);
- c) të përputhen në çdo kohë me Anekset e parashikuara në këtë Marrëveshje përfshirë këtu me Aneksin 5 (Plani i Zbatimit) dhe Aneksin 4 (Nivelet e Shërbimit).

10.2 Në rastin e mosarritjes së Koncesionarit për të siguruar Shërbimin apo për të vepruar në përputhje me detyrimet e tij në përputhje me këtë Marrëveshje, Autoriteti mundet që, pa paragjykuar të drejtat e tjera të tij, t'i kërkojë Koncesionarit që të ri kryejë Shërbimet apo të veprojë në përputhje me detyrimet e tij

## 11. Nivelet e Shërbimit

11.1 Koncesionari do të sigurojë që Shërbimet Operacionale të arrijnë apo tejkalojnë Nivelet e Shërbimit e përcaktuara në Aneksin 4 (nivelet e Shërbimit).

11.2 Çdo konflikt për, ose që lind nëse një Shkak i Autoritetit aplikohet për dështimin e Koncesionarit për sigurimin e Shërbimeve në pajtim me Nivelet e Shërbimit dhe /ose këtë Marrëveshje do të zgjidhet përmes Procedurës së Zgjidhjeve të Konflikteve. Në pritje të zgjidhjeve të konflikteve të dyja palët do të vazhdojnë të zgjidhin çështjet dhe të zbusin efektet e këtij dështimi.



## 12. Standardet

Koncesionari do të plotësojë Standardet Teknike të përmendura apo të referuara në Aneksin 2 (Dokumentet e Tenderit) dhe 3 (Oferta e Koncesionarit), në përmbushjen e detyrimeve të tij në këtë Marrëveshje.

## 13. Siguria e Cilësisë

13.1 Koncesionari do të zhvillojë Plane të Cilësisë të cilat:

- a) do të sigurojnë që të gjithë aspektet e Shërbimeve janë subjekt i sistemeve të menaxhimit të cilësisë; dhe
- b) janë në përputhje me standardet (*p.sh ISO \_\_\_\_\_*) ose çdo standard ekuivalent, i cili është i njohur gjerësisht që të ketë zëvendësuar atë standard.

13.2 Koncesionari do të sigurojë që Shërbimet të zhvillohen në pajtim me Planet e Cilësisë.

## 14. Monitorimi i Dorëzimit të Shërbimit

14.1 Autoriteti do të monitorojë kryerjen e Shërbimeve nga Koncesionari në përputhje me procedurat e përshkruara në Aneksin 12 (Procedura e Monitorimit).

14.2 Koncesionari do të bashkëpunojë dhe do të sigurojë që të gjithë nënkontraktuesit e tij të bashkëpunojnë me Autoritetin në zhvillimin e kontrolleve dhe monitorimit pa detyrime shtesë për Autoritetin.

14.3 Nëse Koncesionari beson se kontrolli i Autoritetit për Shërbimet është i paarsyeshëm, Koncesionari mund të përshkallëzojë çështjen me Autoritetin duke përdorur Procesin e Përshkallëzimit të konflikteve siç parashikohet në Aneksin 11 (Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve).

## 15. Sistemi i Shërbimeve

15.1 Përveç rasteve kur është rënë dakord me shkrim ndryshe nga Autoriteti ose kur është përcaktuar ndryshe në këtë Marrëveshje, Sistemi i Shërbimeve do të përdoret nga Koncesionari vetëm për qëllimet e ofrimit të Shërbimeve për Autoritetin dhe nuk do të përdoret për qëllimet e veta të Koncesionarit ose për ofrimin e shërbimeve të tjera palëve të treta.

15.2 Përveçse nëse parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, humbja ose shkatërrimi për çdo arsye i aseteve ekzistuese nuk do ta çlirojnë Koncesionarin nga detyrimi i tij për të ofruar Shërbimet, në pajtim me Nivelet e Shërbimit.

## **16. Tarifa e Koncesionit**

16.1 Koncesionari do të paguajë një tarifë ("Tarifa e Koncesionit") që arrin në \_ % të xhiros së përgjithshme (duke përjashtuar TVSH) mbi shitjet vjetore të Shërbimeve sipas kontratës në favor të Autoritetit për të drejtat dhe privilegjet e dhëna në këtë Marrëveshje, bazuar në deklaratimet financiare të kontrolluara të Shoqërisë Koncesionare për çdo Vit Financiar.

16.2 Tarifa Vjetore e Koncesionit do të paguhet nga Koncesionari brenda \_ (\_\_\_\_) muajve të parë të secilit vit bazuar në deklaratimet financiare të kontrolluara për Vitin Financiar paraardhës.

## **17. Kostot dhe shpenzimet**

17.1 Palët bien dakord që çfarëdo kostoje dhe shpenzimi në lidhje me vënien në jetë të Koncesionit do të jetë në përputhje me dispozitat e Aneksit 7 (Aspektet financiare) të kësaj Marrëveshje.

17.2 Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje apo tjetërkund, secila Palë do të paguajë vetë kostot e përkatëse të lidhura me, drejtpërdrejt apo tërthorazi, komunikimin, negocimin, përgatitjen dhe kryerjen e kësaj Marrëveshje.

## **18. Çmimi për Njësi i Shërbimeve**

18.1 Çmimi për Njësi i Shërbimeve të kontratës do të jetë çmimi i ofruar nga Koncesionari dhe i pranuar nga Autoriteti, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje nga Aneksi 7 (Aspektet Financiare). Çmimi për Njësi do të jetë çmim neto (duke përjashtuar TVSH).

18.2 Çmimi për Njësi do të paguhet ndaj Koncesionarit nga përdoruesit e shërbimeve paraprakisht për përfitimin e shërbimeve sipas kësaj kontrate.

## **19. Financimi i Koncesionit**

19.1 Koncesionari do të marrë të gjitha masat për një financim të përshtatshëm të Koncesionit dhe përmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshje dhe nuk do të kërkohet asnjë autorizim apo miratim nga Autoriteti për një qëllim të tillë me kusht që Koncesionari të mos nuk do të kërkojë, ngarkojë me barrë apo vendosë një peng mbi pasuritë/asetet ekzistuese ose të reja apo mbi Sistemin e Shërbimeve, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit.

19.2 Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje, Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë asnjë detyrim që të japë kontribute të cilitdo lloj (financiare apo të tjera) në lidhje me Koncesionin.

## 20. Përfaqësuesit

20.1 Koncesionari do të caktojë personat e emëruar si të tillë në Aneksin 9 (Personeli Kyç) si Përfaqësues i Koncesionarit. Përfaqësuesi i Koncesionarit do të ketë autoritetin të veprojë në emër të Koncesionarit në lidhje me çështjet e caktuara ose në lidhje me këtë Marrëveshje.

20.2 Autoriteti do të emërojë Përfaqësuesin e Autoritetit. Përfaqësuesi i Autoritetit do të ketë autoritetin për të vepruar në emër të Autoritetit në çështjet e përcaktuara në, apo në lidhje me, këtë Marrëveshje.

20.3 Përfaqësuesi do të jetë mjaftueshëm me përvojë brenda organizatës së Koncesionarit dhe do t'i jepet autoritet i mjaftueshëm për të siguruar bashkëpunim të plotë në lidhje me veprimtarinë dhe menaxhimin e kësaj Marrëveshjeje.

## 21. Nën-kontraktimi

21.1 Koncesionari nuk do të nënkontrakttojë asnjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje pa marrë miratimin me shkrim të Autoritetit, i cili nuk do të refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme. Koncesionari nuk do të nënkontrakttojë pa miratimin e mëparshëm me shkrim të Autoritetit më shumë se \_\_\_% të vlerës së kontratës.

21.2 Autoriteti mund të refuzojë ose të vonojë miratimin e tij kur konsideron, në baza të arsyeshme që:

- a) Caktimi i një nën-kontraktori të propozuar mund të dëmtojë ofrimin e Shërbimeve; dhe/ose
- b) Nën-kontraktuesi i propozuar është konsideruar të jetë jo i besueshëm dhe /ose nuk ka ofruar shërbime të arsyeshme për klientët e tjerë të tij; dhe /ose
- c) Nën-kontraktuesi i propozuar punëson persona të papërshtatshëm.

21.3 Në bërjen e një kërkesë sipas Nenit 21.1, Koncesionari do të pajisë Autoritetin me informacionin e mëposhtëm për Nën-kontraktuesin e propozuar:

- a) Emrin e tij dhe adresën;

- b) Qëllimet për të cilat nën-kontraktuesi i propozuar do të punësohet, duke përfshirë qëllimin e çdo shërbimi që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar; dhe
- c) çdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti në lidhje me kapacitetin financiar dhe eksperiencën.

## 22. Kontrollët financiarë

22.1 Autoriteti mund, jo më shumë se një herë në çdo Vit Kontrate lidhur me sa më poshtë, të kryejë kontrolle financiare për qëllimet e mëposhtme:

- a) të verifikojë saktësinë e numrit të njësive të Shërbimeve të ofruara;
- b) të verifikojë përmbushjen e Koncesionarit me detyrimet sipas legjislacionit dhe me Nivelet e Shërbimit, Cilësinë dhe Monitorimin sipas Kontratës;
- c) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

## 23. Regjistra dhe Raporte

23.1 Palët do të veprojnë në përputhje me dispozitat e Aneksit 2 (Dokumentet e Tenderit) dhe 3 (Oferta e Koncesionarit) lidhur me mbajtjen e të dhënave dhe bërjen e raporteve. Koncesionari do të sigurojë Autoritetit mbi një bazë të rregullt në mënyrë dhe formë të atillë dhe në mënyrë të shpeshtë siç mund të përcaktohet me hollësi nga Autoriteti.

## 24. Kontrolli i Ndryshimit

24.1 Nëse pas Ditës së Ekzekutimit hyn në fuqi, ndryshohet apo shtohet çfarëdo ligji, rregulloreje, urdhërese apo procedure që ka fuqinë e ligjit në Republikën e Shqipërisë, e cila ndikon kushtet e kontratës, por gjithmonë duke përjashtuar ndryshime të tilla të cilat ndikojnë në të gjitha bizneset në Shqipëri të tilla si ndryshime në ligjin për taksat, kushtet ose çmimi i njësive të shërbimit, kushtet e kësaj Marrëveshje do të përshtaten në masën që është prekur Koncesionari në përmbushjen e detyrimeve të tij të përcaktuara në këtë Marrëveshje sipas Procedurës për Kontrollin e Ndryshimit.

## 25. Personeli Kyç

25.1 Autoriteti do të sigurojë se ai ka personel të mjaftueshëm dhe të bashkëpunojë me Koncesionarin për sa i përket zbatimit të Koncesionit dhe në përputhje me kërkesat e paraqitura në këtë Marrëveshje.

25.2 Palët kanë rënë dakord për përcaktimin e Personelit Kryesor të listuar në Aneksin 9 (Personeli Kyç). Atje ku është e mundur, Koncesionari do të japë së paku 3 muaj njoftim paraprak me shkrim rreth synimit të tij për të zëvendësuar Personelin Kyç.

25.3 Autoriteti nuk do të vonojë ose të tërheqë pëlqimin e tij në mënyrë të pa arsyetueshme për caktimin e një zëvendësimi për çdo Personel Kyç përkatës nga Koncesionari.

## 26. Detyrimet e Shoqërisë/ve Mëmë të SPV

26.1 Shoqëritë Mëmë të Shoqërisë Koncesionare bien dakord si vijon:

- a) do të mbeten të vetmet ortake/aksionare në Shoqërinë Koncesionare;
- b) nuk do të kalojnë, lënë peng apo tregtojnë aksionet e tyre në Shoqërinë Koncesionare pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit përjashtuar rastin kur mund të shesin pjesëmarrjen e tyre tek palë të treta, me kushtin që në të gjitha rastet do të ruajnë të paktën 50.1% të aksioneve me të drejtë vote në Shoqërinë Koncesionare. Çdo transferim do t'i njoftohet menjëherë Autoritetit;
- c) Shoqëritë Mëmë të Shoqërisë Koncesionare do të mbështesin plotësisht dhe do të jenë të përfshira në vënien në jetë të Koncesionit nga Shoqëria Koncesionare përgjatë gjithë Periudhës së Koncesionit, ndërmjet të tjerash edhe me anë të:
  - (i) sigurimit të burimeve të nevojshme (përfshirë edhe ato financiare), ekspertizës, teknologjisë dhe njohurive;
  - (ii) sigurimit të ekspertëve për çështje parësore të angazhuar prej tyre ;
  - (iii) mbështetjes së vazhdueshme për Shoqërinë Koncesionare;
  - (iv) përshtatjes më zhvillimet më bashkëkohore në lidhje me Koncesionin;

26.2 Kapitali i Shoqërisë Koncesionare do të jetë dhe do të mbetet jo më pak se \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_) për gjithë Periudhën e Koncesionit shumë e kapitalit e cila do të arrihet brenda një maksimumi prej 6 (gjashtë) muajsh që nga Data Efektive e kësaj Marrëveshje.

26.3 Pavarësisht nga transferimi i kësaj Marrëveshje për tek Shoqëria Koncesionare, detyrimet e përcaktuara në këtë Nen 26 do të vazhdojnë të bien

mbi Shoqëritë Mëmë.

## 27. Garantimi dhe Mirëmbajtja

27.1 Koncesionari bie dakord që, për një periudhë prej \_\_\_\_\_ pas përfundimit të kësaj Marrëveshje (Periudha e Garancisë), do të sigurojë garancinë e Sistemit të Shërbimeve, pa ndonjë tarifë shtesë.

27.2 Mbulimi i Garancisë \_\_\_\_\_.

27.3 Kushtet e Garancisë \_\_\_\_\_.

27.4 Pavarësisht nga transferimi i kësaj Marrëveshje tek Shoqëria Koncesionare, detyrimet e përcaktuara në këtë Nen 27 do të vazhdojnë të bien mbi Shoqëritë Mëmë.

## 28. Shëndeti dhe siguria

28.1 Koncesionari njeh se ai do të veprojë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregullat e zbatueshme lidhur me shëndetin dhe sigurinë.

## 29. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale

29.1 Kjo Marrëveshje nuk përcakton ndonjë të Drejtë të Pronësisë Intelektuale të secilës palë ose të licensuarve të tyre përkatës që ekziston në Datën Efektive.

## 30. Forca Madhore

30.1 Në rastin e ndodhjes së çfarëdo Ngjarje të Forcës Madhore, do të zbatohen sa vijon:

- a) nuk do të ketë Përfundim të kësaj marrëveshje përveçse siç parashikohet në Nenin 41;
- b) në rastin kur një Ngjarje e Forcës Madhore ndodh përpara Datës Efektive, afati për arritjen e Datës Efektive do të zgjatet me periudhën e Ngjarjes së Forcës Madhore;
- c) në rastin kur një Ngjarje e Forcës Madhore ndodh pas Datës Efektive, Periudha e Koncesionit do të zgjatet për kohëzgjatjen e një Ngjarje të tillë të Forcës Madhore.

### 31. Dëmshpërblimi

31.1 Autoriteti do të dëmshpërblejë, mbrojë dhe ruajë Koncesionarin të pacenuar nga ndonjë dhe çdo procedim, veprim, pretendim të palës së tretë për humbje, dëm dhe shpenzim të çfarëdo lloji dhe natyre që lind nga shkelja nga ana e Autoritetit, zyrtarëve, nëpunësve dhe agjentëve të tij, të ndonjë detyrimi të Autoritetit sipas kësaj Marrëveshjeje, përveçse në shkallën që një pretendim i tillë ka lindur për shkak të shkeljes nga Koncesionari të ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

31.2 Koncesionari do të dëmshpërblejë dhe do të vazhdojë të dëmshpërblejë Autoritetin gjatë Periudhës së Koncesionit nga dhe kundër ndonjë dhe çdo procedimi, veprimi, pretendimi të palës së tretë për humbje, dëm, dhe shpenzim të çfarëdo lloji dhe natyre që lind nga shkelja nga ana e Koncesionarit, nëpunësve, nëpunësve të afërt dhe agjentëve të tij, të ndonjë detyrimi të Koncesionarit sipas kësaj Marrëveshjeje, përveçse në shkallën që kjo humbje ose ky dëm lind nga shkelja e ndonjë dispozite të shprehur të kësaj Marrëveshjeje nga Autoriteti ose ndonjë Organ Shtetëror ose ndonjë veprim ose mosveprim i qëllimshëm i Autoritetit ose i ndonjë Organi Shtetëror;

### 32. Pakësimi i Humbjeve

32.1 Pala që shkakton një shkelje të kësaj Marrëveshjeje do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të pakësuar humbjen, dëmin që ka ndodhur, me kusht që pakësimi i humbjes ose lehtësimi i dëmit të mund të bëhen pa vështirësi ose kosto të paarsyeshme.

### 33. Konfidencialiteti

33.1 Përveçse në shkallën e përcaktuar në këtë Nen ose kur zbulimi i informacionit lejohet shprehimisht diku tjetër në këtë Marrëveshje, secila Palë:

- a) Do të trajtojë Informacionin Konfidencial të Palës tjetër si të tillë dhe do ta ruajë atë në mënyrën e duhur; dhe
- b) Nuk do t'i zbulojë Informacionin Konfidencial të Palës tjetër ndonjë personi tjetër pa miratimin paraprak me shkrim të zotëruesit.

33.2 Dispozita 33.1 **Error! Reference source not found.** nuk do të zbatohet në shkallën që:

- a) Ky informacion ka qenë në zotërim të Palës që bën zbulimin pa detyrimin e konfidencialitetit para zbulimit të tij nga zotëruesi i informacionit;

- b) Ky informacion ishte përftuar nga një palë e tretë pa detyrimin e konfidencialitetit;
- c) Ky informacion ka qenë për përdorim publik në kohën e zbulimit ndryshe nga shkelja e kësaj Marrëveshjeje; ose
- d) Është zhvilluar në mënyrë të pavarur, pa akses në Informacionin Konfidencial të Palës tjetër.
- e) Një informacion i tillë është i detyrueshëm për tu dhënë sipas ligjit.

### **34. Kufizimet e Përgjegjësi**

34.1 Asnjë Palë nuk e kufizon përgjegjësinë e saj për:

- a) Vdekjen ose plagosjen personale të shkaktuar nga neglizhenca e saj ose nga neglizhenca e punonjësve, agentëve ose Nën-kontraktorëve të saj (si të jetë e zbatueshme); ose
- b) Mashtrimin nga ana e saj ose nga punonjësit e saj.

34.2 Duke iu nënshtruar Nenit 34.3, përgjegjësia e Koncesionarit do të jetë:

- a) Për të gjithë humbjen ose dëmin në Objektet, pronat ose asetet (duke përfshirë infrastrukturën teknike, asetet ose pajisjet) e Autoritetit të shkaktuar nga Pazotësia e Koncesionarit, në asnjë rast nuk do të tejkalojë shumat e parashikuara në Aneksin 7;
- b) në lidhje me Kreditë e Shërbimeve dhe Pagesat e Vonuara do të kufizohen në total për të gjithë Periudhën e Koncesionit për një shumë maksimale prej \_\_\_\_\_;
- c) në lidhje me të gjitha pretendimet, humbjet ose dëmet e tjera që lindin ose nga dëmi (duke përfshirë neglizhencën), shkelja e kontratës ose ndonjë mënyrë tjetër sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje, në asnjë rast nuk do të tejkalojë shumën \_\_\_\_\_.

34.3 Asnjë parashikimi i këtij neni nuk do të përdoret me qëllim reduktimin ose ndikimin e detyrimeve të përgjithshme të Palëve për humbjet e saj.

### **35. Sigurimi**

35.1 Koncesionari do të sigurojë dhe do të mbajë të vlefshme Sigurimet e mëposhtme: \_\_\_\_\_.



35.2 Nëse përgjatë një kohe të caktuar Koncesionari nuk është në gjendje të ruajë ndonjë prej Sigurimeve, Koncesionari do të kujdeset menjëherë që të pajisë Autoritetin me garanci të barazvlefshme me anë të një letre kredie.

### **36. Të drejtat dhe Detyrimet e Koncesionarit**

36.1 Përveç të drejtave që lindin nga dhënia e Koncesionit, Koncesionari gëzon të drejtat e mëposhtme:

- a) të përfitojë pagesat dhe përfitimet për shërbimet e ofruara, bazuar në përcaktimet e kësaj Kontrate dhe Anekseve të saj;
- b) të marrë të gjithë informacionin dhe të ketë bashkëpunimin e nevojshëm nga Autoriteti përgjatë ofrimit të shërbimeve;
- c) të përfitojë asistencën e Autoriteti për marrjen e të gjitha lejeve dhe licencave të nevojshmen për ofrimin e shërbimeve sipas kësaj Kontrate;
- d) të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të realizuar Kontratën e Koncesionit, përmbushjen e detyrimeve dhe ushtrimin e të drejtave sipas kësaj Kontrate;
- e) \_\_\_\_\_

36.2 Koncesionari ka detyrimet e mëposhtme;

- a) të financojë, projektojë, ndërtojë, mirëmbajë dhe operojë shërbimet e kërkuara nga kontrata, në bazë të specifikimeve teknike, kërkesave, modalitetet, afatet e përcaktuara me këtë kontratë dhe anekset e saj;
- b) në çdo kohë do të vërë në dispozicion rezerva të mjaftueshme për ofrimin e Shërbimeve sipas kësaj Kontrate;
- c) do të aplikojë, paguajë, marrë dhe ruajë të gjitha autorizimet, lejet dhe licencat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje;
- d) të zbatojë Koncesionin në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe Anekset e saj;
- e) të mbulojë kostot dhe shpenzimet që shoqërojnë përmbushjen e detyrimeve të tij në përputhje me këtë Marrëveshje dhe Anekset e saj;

- f) të caktojë, mbikqyrë, monitorojë dhe kontrollojë aktivitetet e nën-kontraktorit (sipas kontratave përkatëse që mund të jenë të nevojshme) në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe Anekset e saj;
- g) të ndërtojë furnizojë dhe operojë Objektiv kryesor dhe Zyrat e Shërbimeve në përputhje me kërkesat dhe afatet e përcaktuara në këtë Marrëveshje;
- h) të projektojë, vendosë, menaxhojë, mirëmbajë, operojë dhe mbikqyrë Sistemin e Shërbimeve gjatë Periudhës së Koncesionit në përputhje me kërkesat dhe afatet e parashikuara në këtë Marrëveshje;
- i) të sigurojë cilësi të lartë, besueshmëri dhe qëndrueshmëri të Sistemit të Shërbimeve gjatë periudhës së Koncesionit;
- j) të informojë Autoritetin në çfarëdo rrethane që mund të dëmtojë procesin e zbatimit të Koncesionit;
- k) të raportojë çdo muaj tek Autoritetin në lidhje me përparimin e realizuar në zhvillimin e Koncesionit, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje;
- l) të marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme me qëllim garantimin e kushteve të sigurisë në punë për punonjësit e tij si dhe të njohë legjislacionin që lidhet me parandalimin e dëmeve dhe fatkeqësive.
- m) pas përfundimit të Periudhës së Koncesionit dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjeje të gjitha pasuritë apo asetet e krijuara apo rindërtuara apo të zhvilluara posaçërisht ose të përdorura nga Koncesionari dhe/ose punonjësit e tij dhe që i përkasin Koncesionarit gjatë Periudhës së Koncesionit dhe për qëllimin e zbatimit të Koncesionit, do t'i kalohen Autoritetit pa pagesë.
- n) \_\_\_\_\_

36.3 Koncesionari është i detyruar të themelojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Shoqërinë Koncesionare, e cila do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj realizimit të Koncesionit.

### **37. Të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit**

37.1 Përveç të drejtave që lindin nga dhënia e Koncesionit, Autoriteti gëzon të drejtat e mëposhtme:

- a) të përfitojë pagesat e Tarifës së Koncesionit, bazuar në përcaktimet e kësaj Kontrate dhe Anekseve të saj

- b) të monitorojë zbatimin e rregullt të ofrimit të shërbimeve, sipas procedurave të përcaktuara në Aneksin 12 (procedurat e Monitorimit) dhe Aneksit 5 (Plani i Zbatimit);
- c) të verifikojë, inspektojë dhe kontrollojë respektimin e standardeve dhe niveleve të shërbimit, sipas përcaktimeve të Aneksit 2 (Dokumentet e Tenderit, Aneksi 3 (Oferta e Koncesionarit) dhe Aneksi 4 (Nivelet e Shërbimit);
- d) të kërkojë dhe të marrë nga Koncesionari informacionin dhe raportimet sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe Aneksëve të saj;
- e) të përfitojë pronësinë mbi pronat, asetet dhe shërbimet e ndërtuara dhe operuara sipas Kontratës, pas Periudhës së Koncesionit;
- f) \_\_\_\_\_

### 37.2 Autoriteti ka detyrimet e mëposhtme:

- a) të asistojë, informojë dhe bashkëpunojë me Koncesionarin përgjatë ofrimit të shërbimeve;
- b) të garantojë që çdo subjekt nën autoritetin e tij direkt, i cili ka marrë një kërkesë apo aplikim të plotë dhe të rregullt, nga Koncesionari, ti lëshojë Koncesionarit, licencat dhe lejet në lidhje me zbatimin e Koncesionit;
- c) të asistojë dhe të ndihmojë Koncesionarin që çdo subjekt i cili nuk është nën autoritetin e tij direkt, i cili ka marrë një kërkesë apo aplikim të plotë dhe të rregullt, nga Koncesionari, ti lëshojë koncesionarit, licencat dhe lejet në lidhje me zbatimin e Koncesionit;
- d) të sigurojë që të gjitha organet shtetërore të cilat kanë kompetenca në lidhje me koncesionin të jen të informuara në masën e duhur për këtë Kontratë në mënyrë që organet shtetërore, pa vonesa të paarsyeshëm, të bashkëpunojnë me Koncesionarin.
- e) \_\_\_\_\_

## 38. Garancitë

38.1 Autoriteti deklaron dhe garanton se, që nga data e kësaj Marrëveshjeje dhe gjatë Periudhës së Koncesionit:

- a) ka tagrat dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe

- përbushur detyrimet nën këtë Marrëveshje dhe për të kryer transaksionet e parashikuar në të;
- b) kjo marrëveshje përbën detyrim të saj ligjor, të vlefshëm dhe detyrues që zbatohet në përputhje me kushtet e saj;
  - c) asetet që lidhen me zbatimin e Koncesionit në pronësi të Autoritetit janë dhe do të mbeten të çliuara nga të drejtat e palëve të treta, gjatë të gjithë Periudhës së Koncesionit;
  - d) do të mbrojtë dhe nuk do të dëmtojë Koncesionarin nga të gjitha pretendimet e palëve të treta në lidhje me zotërimin e qetë të vendeve dhe asetëve të Koncesionit;
  - e) ekzekutimi, realizimi dhe përbushja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të krijojë konflikte, nuk do të rezultojë në shkelje dhe nuk do të përbëjë kundërvajtje apo të përshpejtojë realizimin që kërkohet nga çfarëdo kushti i ligjeve në fuqi apo marrëveshjeve, konventave, dekreteve apo urdhrave tek të cilat ai është palë apo nga të cilat ai ose cilado pronë apo aset mund të ndikohen ose mbartin detyrim.

38.2 Koncesionari deklaron dhe garanton tek Autoriteti se, që nga data e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje dhe gjatë Periudhës së Koncesionit:

- a) është i organizuar rregullisht dhe ekziston ligjërisht si shoqëri e ngritur sipas ligjeve të Shqipërisë (ose \_\_\_\_\_);
- b) ka tagrat dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe përbushur detyrimet nën këtë Marrëveshje dhe për të kryer transaksionet e parashikuar në të;
- c) kjo marrëveshje përbën detyrim të saj ligjor, të vlefshëm dhe detyrues që zbatohet në përputhje me kushtet e saj;
- d) ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme të Shoqërisë dhe ka ndërmarrë veprime të tjera sipas ligjeve në fuqi si dhe dokumentet ligjore për të miratuar ekzekutimin, realizimin dhe përbushjen e kësaj Marrëveshjeje;
- e) ka pozitën dhe kapacitetin financiar për të ndërmarrë Koncesionin;
- f) asnjë deklaram apo garanci që përfshihen këtu apo në dokumente të tjera të dorëzuara nga ai tek Autoriteti apo në Institucione të tjera Shtetërore në lidhje me Koncesionin nuk përmbajnë apo nuk do të përmbajnë deklarata të pavërteta të fakteve materiale ose nuk anashkalon apo nuk do të

anashkalojë deklarin e fakteve materiale që janë të nevojshme për të deklaruar apo garantuar vërtetësinë;

- g) do të përmbushë detyrimet e tij me zellin e duhur profesional;
- h) nuk është e falimentuar dhe është në përputhje të plotë me ligjet në fuqi dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

### **39. Dorëzimi i Koncesionit**

39.1 Pas përfundimit të Periudhës së Koncesionit, Koncesionari do të rikthejë posedimin e lirë dhe të plotë të mjediseve të Koncesionit ndaj Autoritetit në pajtim me Procedurën e Dorëzimit.

39.2 Procesi i rikthimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit nga një inspektim i përbashkët i Autoritetit dhe Koncesionarit.

### **40. Procedura e Dorëzimit**

40.1 Palët bien dakord që në vijim të mbarimit të datës së Periudhës së Koncesionit, çdo e drejtë apo titull i dhënë ndaj Koncesionarit në lidhje me vendndodhjet (mjediset) e Koncesionit, pasuritë dhe mjediset e tjera lehtësuese do të përfundojnë dhe Koncesionari:

- a) do t'i kalojë Autoritetit çdo të drejtë ose titull në lidhje me vendndodhjet (mjediset) e Koncesionit, Pasuritë e Reja apo ekzistuese duke përfshirë të gjithë përbërësit që formojnë Sistemin e Shërbimeve;
- b) do t'i dorëzojë Autoritetit të gjitha dokumentet dhe të dhënat në posedim të tij në lidhje me të gjitha temat që kanë të bëjnë me operimin e Koncesionit nga Koncesionari pa pagesa, detyrime apo tarifa të mëtejshme.

40.2 Autoriteti bie dakord dhe merr përsipër që brenda 30 ditëve nga transferimi i të drejtave, titujve në lidhje me vendndodhjet (mjediset) e Koncesionit, Pasurive të Reja apo Ekzistuese, përfshirë transferimin e të gjithë përbërësve që formojnë Sistemin dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse siç është parashikuar në paragrafin më lart, ai do ti lëshojë Koncesionarit Certifikatën e Pranimit të Dorëzimit dhe Rikthimit, sipas Aneksit 10 të kësaj Marrëveshjeje.

40.3 Koncesionari do të sigurojë që të gjitha pronat, pasuritë, të drejtat dhe artikujt e tjerë të referuara sipas këtij Neni të cilat janë të bashkëngjitura apo të transferuara tek Autoriteti, do të jenë në kushte të mira pune dhe në një gjendje të mirë riparimi, të tilla që Sistemi të jetë në gjendje për të punuar nën kushte

normale për një periudhë të mëtejshme trevjeçare pa pasur nevojë për të zëvendësuar ndonjë përbërës përveç atyre të konsumueshme.

40.4 Koncesionari do të kalojë tek Autoriteti në kushte dhe afate të ngjashme edhe të gjitha kontratat e mirëmbajtjes që i përkasin Sistemit.

40.5 Ndërsa të gjitha pasuritë e Koncesionarit, duke përfshirë të gjithë përbërësit që përbëjnë sistemin do të transferohen tek Autoriteti në ditën e përfundimit të Periudhës së Koncesionit, vetë Koncesionari nuk do të transferohet tek Autoriteti.

## 41. Përfundimi

41.1 Autoritetit, në rast se nuk është parashikuar në këtë Marrëveshje, i jepet e drejta për të përfunduar këtë Marrëveshje kur:

- a) Koncesionari është në shkelje të detyrimeve të tij, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe një shkelje e tillë, vazhdon pa ndërprerje, pas një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga njoftimi me shkrim i kësaj shkeljeje;
- b) kur ka një kalim të kuotave/aksioneve në kundërshtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;
- c) \_\_\_\_\_.

41.2 Koncesionari, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, ka të drejtë ta përfundojë këtë Marrëveshje kur Autoriteti është në shkelje materiale të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe një shkelje e tillë, vazhdon pa ndërprerje, pas një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga njoftimi i kësaj shkeljeje, me anë të një njoftimi me shkrim.

41.3 Nëse një Ngjarje e Forcës Madhore vazhdon ose në gjykimin e drejtë të Palëve, ka mundësi të vazhdojë për një periudhë më të gjatë se \_\_ muaj të njëpasnjëshëm, përveç dispozitave të nenit të Forcës Madhore, secila Palë mund ti japë fund kësaj Marrëveshjeje, duke i dhënë një Njoftim Përfundimi Palës tjetër.

41.4 Secila nga Palët që i japin fund kësaj Marrëveshjeje në përputhje me këtë Nen, do ta bëjë këtë me anë të një Njoftimi paraprak me shkrim prej 30 ditësh, i cili i dërgohet Palës tjetër (Njoftim Përfundimi). Njoftim Përfundimi duhet të përmbajë:

- a) detajet e duhura duke përshkruar shkakun apo shkeljen;

- b) Datën e Përfundimit, e cila duhet të jetë jo më parë se 30 ditë nga data e Njoftimit të Përfundimit;
- c) Pagesat në lidhje me Përfundimin përfshirë dhe hollësitë e llogaritjes së tyre dhe;
- d) çdo informacion tjetër të nevojshëm.

## 42. Pasojat e Përfundimit

42.1 Në vijim të Njoftimit të Përfundimit, për çfarëdolloj arsye, Koncesionari, duhet të vazhdojë të jetë nën detyrimin për t'i pajisur me Shërbime, Nivelet e Shërbimit dhe të sigurojë se, nuk ka përkeqësim në Nivelet e Shërbimit, apo të standardeve të tjera të Shërbimeve, deri në datën e përfundimit.

42.2 Në rast të përfundimit apo të mbarimit, Koncesionari duhet të \_\_\_\_\_:

42.3 Përfundimi normal apo i parakohshëm i kësaj Marrëveshjeje (sidu që të ndodhë ai), nuk do të cenohet të drejtat apo përgjegjësitë e çdonjërit prej palëve, dhe as vazhdimësinë e ndonjë dispozite në këtë Marrëveshje, e cila në mënyrë të qartë apo të nënkuptuar, ka si qëllim të hyjë në fuqi apo të vazhdojë të jetë në fuqi pas mbarimit të afatit të përfundimit.

## 43. Menaxhimi i Daljes

43.1 Autoriteti dhe Koncesionari, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Menaxhimit të Daljes, të parashtruara në këtë Marrëveshje dhe me çdo Plan të Daljes të akorduar mes tyre.

## 44. Të Drejtat e Autoritetit për Ndërhyrje

44.1 Autoriteti mund të marrë një veprim, në përputhje me këtë nen, në rrethanat e mëposhtme:

kur ka një shkak që i jep të drejtë Autoritetit, të përfundojë, në përputhje me nenin 41 (Përfundimi);

kur ka një Pazotësi nga ana e Koncesionarit, për të parandaluar ose vonuar ofrimin e Shërbimeve apo të ndonjë pjese të tyre dhe kjo Pazotësi nuk është rregulluar brenda 30 ditëve pas njoftimit me shkrim nga Autoriteti;

## 45. Veprimet që duhet të merren para ushtrimit të të drejtave të ndërhyrjes nga Autoriteti

45.1 Para se Autoriteti, të ushtrojë të drejtat e tij të ndërhyrjes, ai duhet ti japë mundësinë Koncesionarit, për një afat prej jo më pak se 15 ditësh, t'i tregojë Autoritetit që, ai është ende i aftë për të siguruar Shërbimet, në përputhje me kushtet e Marrëveshjes dhe/ose të rregullojë rrethanat, duke dhënë të drejtën për ndërhyrje, pa kërkesën për të ndërmarrë një veprim nga ana e Autoritetit.

45.2 Nëse Autoriteti, nuk është i kënaqur me parametrat e Koncesionarit, Autoriteti mund:

- a) në rastin kur Autoriteti, e sheh të arsyeshme dhe të përshtatshme këtë, t'i kërkojë Koncesionarit me anë të një njoftimi me shkrim, të ndërmarrë hapat që Autoriteti i konsideron të nevojshme ose të përshtatshme për të lehtësuar dhe rregulluar gjendjen e shërbimeve të cilat i japin të drejtën e ndërhyrjes Autoritetit;
- b) të emërojë një person të punojë me Koncesionarin, për të përmirësuar të gjitha ose një pjesë të Shërbimeve (përfshirë këtu dhe ata nga ndonjë palë nën-kontraktuese); ose
- c) të ndërmarrë hapa që Autoriteti të vlerësojë si të përshtatshme përmirësimin e të gjithë ose të një pjese të Shërbimeve (përfshirë këtu dhe të palëve nën-kontraktuese).

#### **46. Ushtrimi i të Drejtave për Ndërhyrje nga Autoriteti**

46.1 Nëse Autoriteti, vepron në përputhje me nenin e mësipërm 44, Autoriteti, duhet ti lëshojë një Njoftim Ndërhyrje("Step-in Notice") ndaj Koncesionarit. Ky njoftim duhet të paraqesë si vijon:

- a) veprimet që do të ndërmarrë Autoriteti dhe Shërbimet mbi të cilat do të marrë kontrollin;
- b) arsyen dhe shkakun e marrjes së këtij veprimi;
- c) datën kur ku do të fillojë veprimi;
- d) kohëzgjatjen e nevojshme të veprimeve;
- e) informacion nëse Autoriteti, do të kërkojë akses për të hyrë në godinat dhe/ose ambientet; dhe
- f) për aq sa është e mundur, ndikimin mbi Koncesionarin dhe mbi detyrimet e tij për të pajisur Shërbimet gjatë periudhës që ndërmerret veprimi.



## 47. Garancia e Kontratës

47.1 Koncesionari, me shpenzimet e tij, do t'i sigurojë Autoritetit një Garanci Kontrate (Garanci Performance) nga një bankë serioze e miratuar nga Autoriteti, për një shumë të barabartë me \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_) në formën e përcaktuar në Aneksin 8 (Garancia e Kontratës. Kjo garanci duhet të mbetet e vlefshme dhe në fuqi gjatë gjithë kohëzgjatjes së koncesionit.

47.2 Nëse Koncesionari është në mospërbushje të detyrimeve të tij sipas këtij Neni dhe nuk e rregullon këtë brenda 60 ditësh pas marrjes së një njoftimi me shkrim nga Autoriteti, Autoriteti mund ta përfundojë këtë Marrëveshje, pa njoftim të mëtejshëm ndaj Koncesionarit.

47.3 Autoriteti do të lirojë Garancinë e Kontratës për Koncesionarin pas kalimit të një periudhe prej 30 ditësh që nga data e mbarimit të kësaj Marrëveshjes me kusht që Koncesionari të mos jetë në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshje.

47.4 Garancia e Kontratës do të zvogëlohet nga Koncesionari në përputhje me formulën në vijim:

- a) \_\_\_\_\_ Euro brenda 30 ditësh nga përvjetori i \_\_\_\_\_ i Datës Efektive;
- b) \_\_\_\_\_ Euro brenda 30 ditësh nga përvjetori i \_\_\_\_\_ i Datës Efektive;
- c) \_\_\_\_\_ Euro brenda 30 ditësh nga përvjetori i \_\_\_\_\_ i Datës Efektive;
- d) Për periudhën e mbetur të kontratës do të mbesë në fuqi si garanci, shuma prej \_\_\_\_\_ Euro, për të garantuar performancën e Koncesionarit deri në fund të Periudhës së Koncesionit.

47.5 Në rastin kur Koncesionari do të jetë në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate dhe pas njoftimit, Autoriteti do të ketë të drejtë, pa paragjykuar të drejtat dhe mjetet e tjera të tij të parashikuara këtu, që të kërkojë çdo shumë financiare nga Garancia e Kontratës të cilën Koncesionari është përgjegjës që ta paguajë ndaj Autoritetit sipas kësaj Kontrate. Garancia e Kontratës nuk do të kërkohet nga Autoriteti në rastet e Forcës Madhore apo ngjarje të Pazotësisë apo Pamundësisë që shkaktohen nga Autoriteti.

## 48. Caktimi

48.1 Përveçse për sa i përket dispozitave që lidhen me detyrimet e Shoqërisë/ve Mëmë, Garancitë dhe Mirëmbajtjen sipas kësaj Kontrate, Palët bien dakord se kjo Kontrate do t'i caktohet nga Koncesionari Shoqërisë Koncesionare (SPV) në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate. Për këtë qëllim, pas regjistrimit të Shoqërisë Koncesionare në Regjistrin Tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Koncesionari do të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktor.

48.2 Përveçse nëse parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, Palët nuk do të kenë të drejtë të caktojnë apo transferojnë këtë Kontrate apo të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga apo në vijim të kësaj Kontrate apo çfarëdo përfitimi apo interesi pa pëlqimin paraprak të Palës tjetër.

## 49. Heqja dorë nga të Drejtat

49.1 Nga të drejtat dhe rregullimet e siguruara nga kjo Kontrate mund të hiqet dorë vetëm me shkrim nga Përfaqësuesi përkatës në një mënyrë që deklaron shprehimisht se synohet çlirimi dhe se një çlirim i tillë do të jetë në veprim vetëm në lidhje me rrethanat e përcaktuara me hollësi e të referuara në njoftim.

49.2 Çdo mosarritje apo dështim për të ushtruar një të drejtë apo rregullim nga secila Palë nuk do të përbëjë një çlirim nga ajo e drejtë apo rregullim apo nga çfarëdo të drejtash ose rregullimesh të tjera.

## 50. Vlefshmëria e dispozitave

50.1 Nëse cilado nga dispozitat e kësaj Kontrate vlerësohet si e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme për çfarëdo arsye dhe nga cilado gjykatë apo juridiksion kompetent, një dispozitë e tillë do të ndahet pa sjellë pasoja për dispozitat që mbeten. Nëse një dispozitë e kësaj Kontrate që është themelore për përmbushjen e qëllimit të kësaj Kontrate gjykohet se është e pavlefshme në çfarëdo shtrirje, Koncesionari dhe Autoriteti do të fillojnë menjëherë negociatat në mirëbesim për ta rregulluar këtë pavlefshmëri.

## 51. Tërësia e Kontratës

51.1 Kjo Kontrate, së bashku me dokumentet të cilave i bëhet referim në të, përbën Marrëveshjen si një e tërë dhe mirëkuptimin e Palëve në lidhje me çështjet e trajtuara në të dhe sundon mbi, zhvlerëson dhe shfuqizon çdo marrëveshje të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me çështje të tilla pavarësisht nga termat e cilitdo rregullim apo cilësdo marrëveshje të mëparshme që kanë shprehur se nuk do të përfundojnë.

51.2 Secila nga palët njih dhe bie dakord se me hyrjen në këtë Kontrate dhe në dokumentet e referuar në të, ajo nuk mbështetet, e si rrjedhim nuk do të përfitojë asnjë dëmshpërblim në lidhje me këtë, çfarëdo deklarate, përfaqësimi, garancie apo detyrimi të marrë përsipër (qoftë e bërë nga neglizhenca apo pa faj) të ndryshme nga sa është thënë në mënyrë të shprehur në këtë Kontrate. Rregullimi i vetëm i mundshëm për secilën palë në këtë Kontrate në lidhje me deklarime, përfaqësime, garanci apo kuptime të tilla do të jetë për raste të shkeljes së kontratës sipas termave të kësaj Kontrate.

## 52. Njoftimet

52.1 Të gjitha njoftimet e dhëna sipas apo në lidhje me këtë Kontrate do të jenë me shkrim, të nënshkruara nga apo në emër të Palës që e bën njoftimin dhe do të njoftohet personalisht apo përmes dërgimit të regjistruar të parapaguar apo me postë të regjistruar në adresën dhe në vëmendjen e Palës përkatëse për këtë qëllim apo në atë adresë që Pala mund të ketë përcaktuar në përputhje me këtë Nen. Njoftimet nuk do të dërgohen me postë elektronike (e-mail).

## 53. Gjuha

53.1 Kjo Kontratë do të hartohet dhe nënshkruhet në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Në rast mospërputhjes, kontradiktash, konfliktesh e pretendimesh ndërmjet tekstit në shqip të kësaj Kontrate dhe tekstit në anglisht të kësaj Kontrate, versioni në \_\_\_\_\_ i kësaj Kontrate do të mbisundojë dhe do të jetë versioni i vetëm i detyrueshëm. Dokumentet e referuar apo dërguar në vijim të kësaj Kontrate do të jenë në gjuhët shqip dhe ose anglisht, si të kërkohet.

## 54. Ligji i zbatueshëm dhe Arbitrazhi

54.1 Kjo Kontrate do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

54.2 Konfliktet do të zgjidhen fillimisht në pajtim me Procedurën e Zgjidhjes së Konflikteve të përcaktuar në Aneksin 11 dhe nëse nuk mund të zgjidhen, ato do të zgjidhen përfundimisht me arbitrazh në përputhje me \_\_\_\_\_ (p.sh: *Rregullat e Arbitrazhit të ICC*).

54.3 Numri i arbitrave do të jetë 3 (tre). Arbitrat do të emërohen në përputhje me \_\_\_\_\_ (p.sh: *Rregullat e Arbitrazhit të ICC*). Vendi i arbitrazhit do të jetë në \_\_\_\_\_ (p.sh. *Gjenevë, Zvicër*). Gjuha e arbitrazhit do të jetë \_\_\_\_\_ (p.sh *anglishtja*). Kostot e arbitrazhit do të përcaktohen nga gjykata e arbitrazhit.

Për sa më sipër, arrihet kjo Marrëveshje midis Palëve.

STUDIM FIZIBILITETI

[EMRI I PROJEKTIT]

*Ky dokument shërben si udhëzues për përgatitjen e studimit të fizibilitetit të një projektit koncesioni/PPP në përputhje me rregullat për vlerësimin dhe dhënien e tyre.*

## Hyrje

*Përshkrimi i shkurtër i projektit dhe qëllimet kryesore.*

### Pikënisja e projektit

*Përshkrimi i pikënisjes se identifikimit projektit të mundshëm të koncesionit/partneritetit publik privat i cili mund të jetë:*

- 1.1. procesi i planifikimit kombëtar, rajonal/lokal apo në nivel sektori;
- 1.2. analiza e gjendjes infrastrukturore, identifikimi i mungesave të shërbimeve dhe/ose nevojave të investimit; ose
- 1.3. projektide të nxitura nga prioritetet e politikave.

### Situata Aktuale

*Në përshkrimin e situatës aktuale studimi i fizibilitetit mund ti referohet pikave aktuale duke i përdorur sipas llojit dhe natyrës së projektit.*

- 2.1. përshkrimin e situatës aktuale, vlerësimin e të metave kryesore apo të hapësirave të zhvillimit, kontekstin e përmirësimit dhe, nëse është e përshtatshme, një pasqyrë të tregut;
- 2.2. parashikimet afatmesme dhe afatgjata të nevojave;
- 2.3. përshkrimin e përgjithshëm të projektit;
- 2.4. legjislacionin që rregullon objektin e fushës së investimit;
- 2.5. në rastin e një projekti që përfshin kryerjen e një funksioni institucional, natyrën e funksionit institucional në fjalë dhe masën në të cilën ky funksion institucional, si ligjërishit ashtu edhe nga natyra e tij, mund të kryhet nga një palë private;
- 2.6. në rastin e një projekti që përfshin përdorimin e pronës shtetërore, një përshkrim të pronës shtetërore në fjalë, përdorimet, nëse ka, subjekt i të cilave është aktualisht një pronë e tillë shtetërore, dhe një përshkrim të llojeve të përdorimit, në të cilat mund të përfshihet ligjërishit një subjekt privat;
- 2.7. përfitimet strategjike dhe operacionale që priten nga projekti;

### Projekti Teknik

*Analiza teknike është pjesë e studimit të fizibilitetit dhe ka si objektiv kryesor të demonstrojë se projekti mund të zbatohet duke përdorur teknologjitë e propozuara dhe pa risqe të paarsyeshme teknike.*

### Analiza teknike

*Analiza teknike duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:*

3.1.1. Sfondin e projektit.

3.1.2. Vendndodhjen dhe truallin.

3.1.3. Kushtet lokale.

3.1.4. Përshkrimin konstruktiv, funksional dhe teknik të projektit.

3.1.5. Periudha e vlerësuar e ndërtimit (në muaj).

### 3.2. Ndikimet mjedisore dhe sociale

*Ndikimi mjedisor dhe social i projektit duhet të përgatitet në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

- *Studimi identifikon efektet e mundshme negative apo të kundërta në përbërësit mjedisorë por që nuk kufizohen vetëm te: popullsia, ajri, toka, uji, peizazhi, fauna, flora, aspekte të biodiversitetit, duke përfshirë speciet e rrezikuara, ekosistemet e ndjeshme dhe identifikimin e atyre që mbrohen ligjërisht. Ai duhet të tregojë, gjithashtu, edhe masat parandaluese që duhen ndërmarë për të siguruar përputhjen me standardet e BE-së për mjedisin.*
- *Studimi merr parasysh aspektet sociale, të tilla si: mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe e shëndetit të komuniteteve, siguria, çështjet e punës dhe, nëse është rasti, ndikimet mbi grupet e pafavorizuara ose në nevojë, blerja e tokës dhe risistemimi i pavullnetshëm, mbrojtja e pasurisë kulturore dhe trashëgimisë.*

### 3.3. Analiza ekonomike dhe financiare

*Analiza ekonomike dhe financiare minimalisht duhet të përbehet duke u referuar në elementet e mëposhtëm*

- *Kostot e drejtpërdrejta të investimeve*
- *Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes*
- *Kostot e drejtpërdrejta operative lidhen me funksionimin e përditshëm*
- *Kostot indirekte të projektit*

- Të ardhurat e projektit përfitohen nga:
- Analizë cilësore dhe sasiore risku në mënyrë që të identifikohet dhe të vlerësohet gama e riskut që mund të ndikojë mbi projektin.
- Analiza e ndjeshmërisë.

**PËR PRANIMIN E PROPOZIMIT TË PAKËRKUAR NË “FORMË TË ZHVILLUAR”, STUDIMI DUHET TË PËRGATITET NË BAZË TË LIGJIT 125/2013 “PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT” I NDRYSHUAR, VKM NR. 575, DATË 10.07.2013 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME KONCESION/PPP” DHE FORMATIT TË MËSIPËRM DERI NË KËTË PIKË.**

**PËR PRANIMIN E PROPOZIMIT TË PAKËRKUAR NË “FORMË TË ZHVILLUAR PLOTËSISHT”, STUDIMI DUHET TË PËRGATITET NË BAZË TË LIGJIT 125/2013 “PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT” I NDRYSHUAR, VKM NR. 575, DATË 10.07.2013 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME KONCESION/PPP” DHE FORMATIT TË MËSIPËRM DUKE PËRFSHIRË EDHE ARSYETIMIN E VENDIMIT TË PËRCAKTUAR SI MË POSHTË.**

### **Arsyetimi i vendimit koncesionit/PPP-së**

Bazuar në rezultatet e analizave të ndërmarra në përputhje VKM nr. 575/2013, studimi duhet të arsyetojë nëse është konfirmuar leverdishmëria dhe qëndrueshmëria e projektit; dhe nëse forma koncesion/PPP duket si modeli më i përshtatshëm për zbatimin e projektit.

Arsyetimi i vendimit të koncesionit/PPP-së kryhet duke filluar me Krahasuesin e Sektorit Publik dhe duke përdorur modele të përshtatshme financiare, të tilla si metodologjia e Krahasuesit Publik Privat ose modeli “Hije”.

## ANEKS 3.

## UDHËZIMET PËR HARTIMIN E RAPORTIT PËRMBLEDHËS DHE TË STUDIMIT TË FIZIBILITETIT

**ii. Raporti përmbledhës mbi projekt idenë e propozimit**

Komisioni ka për detyrë që të kryejë fillimisht një verifikim paraprak të projektit të paraqitur. Bazuar në rezultatet e këtij vlerësimi paraprak, komisioni përgatit një raport përmbledhës në lidhje me mundësinë e realizimit të projektit. Ky raport përmbledh informacionet e nevojshme të cilat lidhen veçanërisht me domosdoshmërinë e realizimit të projektit, me përshtatshmërinë e vënies në jetë të idesë së projektit si edhe konsideron mundësitë dhe alternativat për realizimin e tij.

Raporti duhet të përmbajë në brendësinë e tij, të paktën këto elementë thelbësore;

- një përshkrim të situatës aktuale të sektorit në të cilin paraqitet projekti, përshkrim i cili identifikon dhe vlerëson mangësitë e hasura si dhe nevojat dhe hapësirat për zhvillim, kontekstin e përmirësimit dhe, në raste ku është e nevojshme, përmban edhe një pasqyrë të tregut;
- parashikimet afatmesme dhe afatgjata të nevojave të sektorit specifik dhe të autoritetit kontraktor;
- një përshkrim të përgjithshëm të projektit të paraqitur;
- identifikimin e bazës ligjore që disiplinon objektin e fushës së investimit të propozuar;
- në rastin kur projekti i paraqitur parashikon kryerjen e një funksioni institucional nga ana e një partneri privat, raporti duhet të identifikojë natyrën e funksionit institucional si edhe të vlerësojë masën deri në të cilën ky funksion institucional, bazuar në kuadrin ligjor dhe në natyrën e projektit, lejohet dhe mund të kryhet nga një partner privat;
- në rastin kur projekti i paraqitur parashikon përdorimin e pronave shtetërore, raporti duhet të përshkruajë pronat shtetërore të cilat propozohet të përfshihen në projekt, duke identifikuar përdorimet aktuale të tyre, si edhe të vlerësojë dhe të përshkruajë llojet e përdorimit të këtyre pronave, për të cilat legjislacioni lejon përfshirjen e një partneri privat;
- identifikimin dhe vlerësimin e përfitimeve strategjike dhe operacionale të cilat parashikohet të realizohen nga zbatimi i projektit të paraqitur;
- bashkërendimin e projektit me politikat e përgjithshme të investimeve sektoriale apo rajonale;
- një parashikim të skenarëve teknikë dhe ekonomikë të cilët duhet të vihen në zbatim për arritjen e objektivave të projektit;



- një vlerësim paraprak të kostove të projektit dhe të qëndrueshmërisë financiare;
- analizën paraprake financiare dhe/ose ekonomike të projektit të paraqitur;
- propozimet në lidhje me alternativat e alokimit të riskut financiar, teknik dhe operacional ndërmjet parterit publik dhe partnerit privat;
- konkluzione dhe rekomandimet në lidhje me metodat e zbatimit, përfshirë edhe dhënien e direktivave operacionale dhe përshkrimin e modeleve të zbatueshme e të përshtatshme, për realizimin e projektit;
- në rastet e propozimeve të pakërkuara të paraqitura nga një subjekt i interesuar, raporti i komisionit duhet të përmbajë edhe propozimin në lidhje me oportunitetin e dhënies apo jo të bonusit në favor të subjektit propozues si të përqindjes së pikëve të këtij bonusi. Ky propozim formulohet duke u bazuar mbi rezultatet teknike dhe financiare të propozimit të pakërkuara.

Pas hartimit të raportit mbi projekt idenë e propozimit, me të gjithë elementët e përshkruar më lart, komisioni i koncesioneve/PPP, e përcjell këtë raport për shqyrtim tek autoriteti kontraktor kompetent.

Autoriteti kontraktor, bazuar në informacionin e raportit përmbledhës të hartuar nga komisioni i koncesionit/PPP, merr një vendim në lidhje me projektin e shqyrtuar. Autoriteti, pas shqyrtimit të raportit përmbledhës mund të zgjedhë njërën prej alternativave të mëposhtme;

- refuzimin e zbatimit të projektit;

Vendimi i autoritetit kontraktor për refuzimin e zbatimit të projektit zakonisht lidhen me një vlerësim negativ të projektit në diskrecion të vetë autoritetit. Ky refuzim mund të varet nga disa shkaqe dhe arsye të ndryshme, të cilat mund të jenë vlerësime negative, për shembull të ligjshmërisë, përshtatshmërisë, nevojës, fizibilitetit dhe leverdisë së projektit.

- shtyrjen e zbatimit të projektit;

Autoriteti kontraktor mund të ndërpresë dhe të shtyjë zbatimin e një projekti, si pasojë e arsyeve të ndryshme të vlerësuara prej tij. Këto arsye mund të lidhen me pamundësinë apo vështirësinë e autoritetit kontraktor për të venë në zbatim projektin në periudhën në të cilën është shqyrtuar ky propozim, me nevojën për integrimin e projektit me informacione, të dhëna apo elementë të cilët nuk janë të disponueshme për momentin, apo për arsye se projekti nuk konsiderohet si i nevojshëm për momentin, si pasojë e prioritetëve të tjera të autoritetit kontraktor.

- kthimin për plotësim të propozimit të pakërkuar

Propozimi i pakërkuar i kthehet për plotësim subjektit propozues në rastet kur nuk plotëson kushtet minimale të kërkuara nga neni 10 i VKM 575. Sipas kësaj dispozite,

për tu shqyrtuar nga autoritetet kontraktore kompetente, propozimet e pakërkuara duhet të plotësojnë këto kriteret minimale:

- projekti i propozuar, duhet ti përkasë sektorëve në të cilat legjislacioni lejon mundësinë e zbatimit të koncesioneve dhe PPP;
- propozimi i paraqitur nuk duhet të lidhet me një projekt, për të cilin në momentin e paraqitjes së propozimit, ka filluar ose është shpallur një procedurë koncesioni/PPP;
- propozimi i pakërkuar duhet ti dorëzohet autoritetit kontraktues i cili është kompetent sipas ligjit;
- propozimi i pakërkuar duhet të paraqitet në format e kërkuara nga ligji, pra ose në formën e zhvilluar<sup>13</sup> ose me studimin e plotë të fizibilitetit.

Me qëllim plotësimin e propozimit të pakërkuar, subjektit propozues i garantohet një afat prej 30 ditësh, i cili fillon nga data e kthimit të propozimit nga autoriteti kontraktor.

- vijimin e procedurave për zbatimin e projektit.

Në rastet kur autoriteti kontraktor vlerëson pozitivisht projektin e paraqitur, atëherë ky autoritet merr një vendim për vijimin e procedurave ligjore për zbatimin e projektit.

Procedurat e mëtejshme për zbatimin e projektit ndiqen nga i njëjti komision i krijuar për vlerësimin e projektit të paraqitur. Ndaj, pas përfundimit të raportit përmbledhës nga ana e komisionit të koncesionit/PPP, në rastet kur autoriteti kontraktor ka marrë një vendim pozitiv në lidhje me vazhdimin e procedurave për zbatimin e projektit të paraqitur, komisioni vijon punën e tij duke kryer veprimet e mëtejshme të parashikuar nga legjislacioni, të cilat detajohen në vijim.

### **iii. Studimi i fizibilitetit**

Veprimi kronologjik i mëtejshëm përgjatë procedurave të vlerësimit të një projekti koncesioni/PPP, është hartimi i studimit të fizibilitetit të projektit të paraqitur.

Hartimi i studimi i fizibilitetit, nga ana e komisionit, ka si qëllim si që të vendosë në dispozicion të autoritetit kontraktor, një dokument i cili përmban një analizë të të gjitha aspekteve përbërës të një projekti të propozuar, në mënyrë që autoriteti kontraktor, duke u bazuar mbi rezultatet e këtij studimi, të ketë mundësi të marrë një vendim, pozitiv apo negativ, në lidhje me angazhimin ose jo nga ana e tij, në projektin konkret.

---

<sup>13</sup> Sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 11 të VKM 575

Për sa i përket formës dhe elementëve përbërës të tij, studimi i fizibilitetit hartohet bazuar në modelin dhe sipas formularit standard të hartuar dhe të publikuar nga ATRAKO në faqen zyrtare të saj.

Në nivel praktik, për sa i përket përmbajtjes së tij, studimi i fizibilitetit është një dokument i cili përmban një analizë të plotë të projektit dhe një vlerësim të mëtejshëm të tij, i cili shqyrton në mënyrë të detajuar, informacionet dhe të dhënat e përmbajtura në raportin përmbledhës të komisionit.

Së pari, studimi i fizibilitetit duhet të vlerësojë aspektet e përgjithshme, të cilat lidhen me vlerësimin e faktit nëse ka apo jo interes publik për realizimin e një projekti konkret si dhe faktin nëse projekti harmonizohet me objektivat kombëtarë dhe sektoriale strategjike të përcaktuar në dokumentet e planifikimit, të tillë si politika, strategji apo plane të miratuara nga qeverisja qendrore apo vendore;

Gjithashtu, studimi i fizibilitetit duhet të identifikojë karakteristikat kryesore të projektit të shqyrtuar, të cilat duhet të shoqërohen me një analizë të thelluar të elementëve përbërës, të cilat përfshijnë aspektet teknike, ekonomike dhe financiare, si dhe ndikimin mjedisor e social të projektit.

Së fundmi studimi duhet të japë një vlerësim të arsyetuar, bazuar në analizimin e faktit nëse projekti i shqyrtuar, është ekonomikisht më i favorshëm për tu realizuar në formën e një koncesioni/PPP, krahasuar me alternativën tradicionale të prokurimit publik apo me mekanizma të tjerë alternativë.

- **Afatet për hartimin e studimit të fizibilitetit.**

Ndryshimet e fundit të zbatuara në legjislationin e koncesioneve/PPP, kanë synuar të përcaktojnë afate të qarta dhe të shkurtojnë procedurën e shqyrtimit të projekteve. Si pasojë e këtyre dispozitave<sup>14</sup>, studimi i fizibilitetit duhet të hartohet nga komisioni i koncesionit/PPP, brenda një afati prej 60 ditësh pune, i cili nis që nga data e krijimit të komisionit. Në rastet kur projekti i shqyrtuar rezulton tejet kompleks, ky afat 60 ditor mund të zgjatet, deri në një maksimum prej 30 ditë pune shtesë.

Përrjashtimisht, nëse objekti i koncesionit/PPP lidhet me hidrocentralet energjetike, afatet e mësipërme fillojnë nga data e marrjes së oponencës teknike shtetërore nga strukturat përgjegjëse të ngarkuara për të bërë këtë oponencë.

- **Përmbajtja e studimit të fizibilitetit.**

Për sa i përket përmbajtjes së tij, studimi i fizibilitetit duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm;

- një përshkrim të përgjithshëm të projektit të shqyrtuar;
- përmbledhjen e fazave operationale të nevojshme për realizimin e tij;

---

<sup>14</sup> Neni 4 i VKM 575, i ndryshuar me VKM nr. 313, datë 27.04.2016

- analizën e detajuar teknike;
- analizën e detajuar financiare dhe ekonomike;
- analizën e detajuar ligjore;
- studimet mjedisore, ndikimin, pasojat dhe implikimet në natyrë;
- konkluzionet dhe rekomandimet e komisionit në lidhje me projektin e shqyrtuar.

Legjislacioni i kushton një vëmendje të posaçme dhe ka detajuar me anë të dispozitave specifike, disa elementë përbërës të studimit të fizibilitetit, të cilat janë respektivisht; analiza teknike, analiza financiare dhe ekonomike dhe ndikimi mjedisor dhe social.

*i.* Analiza teknike.

Për sa i përket analizës teknike e cila duhet të jetë pjesë e studimit të fizibilitetit, dispozitat e posaçme<sup>15</sup> përcaktojnë se qëllimi i këtij dokumenti është që të vlerësojë dhe të demonstrojë nëpërmjet analizës së detajuar, se projekti i shqyrtuar, mund të zbatohet duke përdorur teknologjitë e propozuara dhe pa risqe të paarsyeshme teknike.

Në lidhje me përmbajtjen e analizës teknike, ky dokument duhet të përmbajë këto informacione:

Një përshkrim të përgjithshëm teknik të projektit, i cili tregon studimet paraprake të kryera, të tilla si studime para investimit, studime mbështetëse, hulumtime apo rilevimet e trojeve. Ky informacion duhet të përshkruajë edhe konceptin, projekt idenë, objektivat kryesorë, si edhe të identifikojë se cilët do të jenë përfituesit e projektit.

Analiza teknike duhet të përmbajë edhe informacionin në lidhje me pasuritë e paluajtshme në të cilat do të zhvillohet projekti. Në veçanti duhet të përfshihet informacion mbi vendndodhjen e propozuar të truallit apo objekteve ku propozohet të zhvillohet projekti si dhe, në rast se ka, edhe listën e alternativave të mundshme të tyre. Ky informacion duhet të përcaktojë sipërfaqen totale të tyre si edhe nëse përdorimi i pasurive të paluajtshme, parashikohet të jetë i përhershëm apo për një afat të përkohshëm. Informacioni mbi pasuritë e paluajtshme duhet të përfshijë gjithashtu të dhënat mbi statusin ligjor dhe pronësinë e pasurive të paluajtshme që do të përdoren, përfshirë edhe rastet kur parashikohet të përdoren pasuri të paluajtshme publike.

Po kështu analiza teknike duhet të ketë të dhëna që lidhen me kushtet lokale të projektit. Këto të dhëna përfshijnë informacionet në lidhje me klimën, fenomenet

---

<sup>15</sup> Neni 5 i VKM 575, i ndryshuar me VKM nr. 313, datë 27.04.2016

natyrore specifike për zonën, studimet topografike, studimet gjeoteknike, situatën e rrjetit, rrugëve dhe infrastrukturës dhe nevojat e lidhjes së shërbimeve apo përmirësimit të rrjetit dhe infrastrukturës.

Analiza duhet të përmbajë edhe një përshkrim teknik në lidhje me aspektin konstruktiv, funksional dhe teknik të projektit. Ky informacion lidhet kryesisht me rezultatet që pritet të arrihen nga projekti dhe nuk përshkruan në mënyrë të detajuar se si do të arrihen.

Ky përshkrim teknik, identifikon në veçanti punët kryesore civile që do të realizohen, metodat e tyre të ndërtimit, teknologjinë dhe pajisjet që do të përdoren, parametrat kryesorë të projektit si: kapacitetet, sipërfaqet, volumet, gjatësitë, dhe tregues të tjerë të veçantë, si dhe liston standardet teknike që duhet të zbatohen për realizimin e projektit.

Analiza teknike duhet të përmyllet nga një vlerësim i afateve dhe periudhave të parashikuara për ndërtimet sipas projektit, të cilat duhet të shprehen në muaj.

Në rastet kur parashikohet realizimi i punimeve civile, analiza teknike duhet të përmbajë, të skicuara, edhe planin e vendndodhjes së zonës në shkallën 1:25000 - 1:5000, planin e përgjithshëm në shkallën 1: 2000 - 1:500 si dhe planet e përgjithshme dhe seksionet e arkitekturës, rezistencës, instalimeve; planet e veçanta, profilet gjatësore, profilet tërthore, sipas kërkesës dhe nevojave të projektit specifik.

#### *ii.* Ndikimi mjedisor dhe social.

Një nga elementët e rëndësishëm të studimit të fizibilitetit, lidhet me identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale të projektit. Për këto qëllime, analiza e ndikimeve mjedisore dhe sociale duhet të identifikojë ndikimet, pasojat dhe efektet e mundshme, të cilat si pasojë e projektit, mund të shkaktojnë pasoja negative, alteruese apo dëmtuese në mjedis. Analiza e pasojave duhet të fokusohet në veçanti tek përbërësit mjedisore më të rëndësishëm, të tillë si popullsia, ajri, toka, uji, peizazhi, fauna, flora, biodiversiteti, speciet e rrezikuara, ekosistemet e ndjeshme dhe të mbrojtura ligjërisht.

Analiza e ndikimeve mjedisore duhet që pas identifikimit të pasojave të mundshme, të identifikojë edhe masat parandaluese që duhen ndërmarrë, për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me standardet dhe dispozitat specifike të legjislacionit shqiptar dhe të Bashkimit Europian.

Analiza duhet të integrohet edhe me identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve sociale që mund të shkaktojë projekti. Kjo analizë fokusohet tek studimi i aspekteve sociale, që përfshijnë midis të tjerash, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, shëndetin e popullatës dhe të komuniteteve, sigurinë, punësimin, pasojat mbi grupet sensitive apo kategoritë në nevojë, ndryshimet në statusin e tokës dhe risistemimin e pavullnetshëm sie dhe mbrojtjen e pasurisë kulturore dhe trashëgimisë.

#### *iii.* Analiza financiare dhe ekonomike.

Qëllimi i analizës ekonomike dhe financiare është që të përcaktojë "vlerën e parasë" së projektit. Bazuar në përkufizimin ligjor, termi "vlerë e parasë" përdoret me synimin që të përcaktojë nëse autoriteti kontraktues merr përfitimet maksimale të mundshme nga një projekt partneriteti publik privat.

Si vlerë e parasë së projekti, nuk konsiderohet thjesht vetëm vlera e punëve apo e shërbimeve publike të një projekti. Ky term përfshin gjithashtu edhe një analizë të elementëve të tjerë ekonomikë dhe financiarë të projektit, të cilët përfshijnë cilësinë, koston, shfrytëzimin e burimeve, përshtatshmërinë me qëllimin dhe objektivin e kontratës dhe kohën e nevojshme për realizimin e tij.

Vlerësimi përfundimtar i analizës financiare dhe ekonomike, shërben për të vendosur nëse të gjitha këto elemente të kombinuara përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit përbëjnë vlerën më të mirë ekonomike.

Analiza financiare dhe ekonomike, si pjesë e studimit të fizibilitetit, përfshin analizën e një shumëllojshmërie elementësh, të cilët përshkruhen në vijim;

- Kostot e drejtpërdrejta të investimeve

Këto kosto fokusohen tek ndërtimi i objekteve dhe aseteve të reja. Këto kosto përfshijnë midis të tjerash shpenzimet fillestare për përgatitjen e projektit, duke përfshirë shërbimet financiare, ligjore, të prokurimit, shpenzimet teknike dhe të menaxhimit të projektit, koston e projektimit, koston e tokës apo të blerjes së një asemi të ri, koston e përgatitjes së truallit, koston e ndërtimeve dhe të vënies në funksionim, duke përfshirë edhe lëndët e para, pajisjet, instalimet, fuqinë punëtore, menaxhimin dhe trajnimin, dhe rrethana të tjera.

- Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes

Këto kosto përfshijnë koston e mirëmbajtjes së aseteve përgjatë kohëzgjatjes së plotë të projektit, duke konsideruar nevojën për të ruajtur nivele të kënaqshme dhe të afta për të realizuar rezultatet e kërkuara të projektit. Këto kosto përfshijnë koston e lëndëve të para, mjetet dhe pajisjet, koston e personelit si dhe koston e dedikuara për mirëmbajtjen.

- Kostot e drejtpërdrejta operative

Kostot e drejtpërdrejta operative lidhen me funksionimin e përditshëm të projektit. Këto kosto përfshijnë koston e plotë të personelit, në të cilën përfshihen pagat, përfitimet, kontributet e pensioneve, kontributet e sigurimeve, koston për trajnimin dhe specializimin, pushimet vjetore, shpenzimet e udhëtimeve apo shpenzime të tjera të pritshme shtesë. Gjithashtu përfshihen edhe koston e shërbimeve, lëndët e para dhe materialet e konsumit, koston e drejtpërdrejta të menaxhimit, si dhe shpenzimet e sigurimit, gjithnjë në lidhje me operimin e projektit.

- Kostot indirekte të projektit

Kostot indirekte të projektit konsiderohen një pjesë e kostove të administrimit, të cilat përfshijnë kostot e kohës dhe të punës së drejtuesve të lartë, personelit, kontabilitetit, faturimit, shërbimeve ligjore, qirasë, komunikimet dhe burime të tjera institucionale të shfrytëzuara nga projekti.

- Të ardhurat e projektit

Të ardhurat e një projekti të partneritetit publik privat mund të përfitohen ose nga përdoruesit fundorë, në formën e pagesave për shërbimin e përfituar apo për një pjesë të tij dhe/ose nga përdorimi i aseteve të cilat janë objekt i PPP.

Përveç vlerësimit të kostove dhe të ardhurave, analiza financiare dhe ekonomike, përfshin edhe vlerësimin e disa elementëve të tjerë ekonomiko financiarë, të përshkruar në vijim.

- Realizueshmëria ekonomike e projektit

Realizueshmëria ekonomike e projektit vlerësohet nëpërmjet treguesve të performancës financiare, të cilat mund të jenë: fluksi i arkës (Cash-Flow), vlera aktuale neto (NPV), norma e brendshme e kthimit (IRR), periudha e vetëshlyerjes (PBP) dhe analiza kosto-përfitim (CBA).

- Përballueshmëria

Përballueshmëria e një projekti ka për qëllim të tregojë nëse të ardhurat e përgjithshme të projektit janë brenda mundësisë së përdoruesve dhe autoritetit kontraktor, ose e të dyve, në mënyrë që të mbulojnë pagesat e tarifave të shërbimeve apo të objekteve, që realizohen dhe shfrytëzohen sipas PPP. Ky element përfshin kontrollimin e kostos fiskale të projektit, si në aspektin e pagesave të rregullta ashtu edhe në atë të riskut fiskal, si dhe përcaktimin nëse kjo mund të rregullohet brenda buxhetit të kufizuar dhe detyrimeve të tjera fiskale.

- Përshtatshmëria financiare

Përshtatshmëria financiare duhet të përcaktojë nëse projekti ka mundësi për të tërhequr subjekte financues cilësorë, si garantues, mbështetës financiarë apo huadhënës, duke siguruar gjithashtu një kthim të arsyeshëm financiar.

- Analiza e riskut

Një element tjetër i nevojshëm për tu përfshirë në analizën financiare dhe ekonomike, lidhet me identifikimin dhe vlerësimin e elementëve të riskut të një projekti PPP. Identifikimi i risqeve të një projekti, shërben gjithashtu për hartimin e strategjive për menaxhimin e riskut si edhe për ndarjen dhe alokimin e risqeve midis partnerit publik dhe atij privat. Analiza e risqeve përfshin midis të tjerash, vlerësimin e faktorëve të mëposhtëm;

- risqet e trojeve, të cilat lidhen me disponueshmërinë dhe cilësinë e vendndodhjes së projektit, të tilla si: kostoja dhe koha e marrjes së truallit,

lejet e nevojshme ose sigurimi i së drejtës së kalimit për një rrugë, efekti i kushteve gjeologjike ose i kushteve të tjera të truallit dhe kostot e plotësimit të standardeve mjedisore;

- risqet e projektimit, ndërtimit dhe të vënies në punë të cilat lidhen me situatat ku ndërtimi zgjat më shumë ose kushton më shumë se sa pritej, ose që cilësia e projektimit apo e ndërtimit nënkupton se asetit nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e projektit;
- risqet e funksionimit të cilat lidhen me suksesin e operacioneve, duke përfshirë riskun e ndërprerjes së shërbimit ose të disponueshmërisë së aseteve, riskun që ndonjë ndërveprim rrjeti nuk punon siç pritej, ose që kostoja e operimit dhe mirëmbajtjes së objektit është e ndryshme nga sa pritej;
- risqet e kërkesës dhe risqe të tjera tregtare të cilat lidhen me situatat ku përdorimi i objektit është i ndryshëm nga sa pritej, ose që të ardhurat nuk janë mbledhur siç pritej;
- risqet ekonomike ose financiare të cilat lidhen me ndryshimet në normat e interesit, kurset e këmbimit ose inflacionit që ndikojë negativisht në rezultatet e projektit;
- risqet e pronësisë së aseteve të cilat lidhen me pronësinë e aseteve, duke përfshirë riskun që teknologjia të vjetërohet ose, që vlera e aseteve në fund të kontratës të jetë ndryshe nga sa pritej;
- risqet politike të cilat lidhen me vendimet politike që mund të ndikojnë negativisht mbi projektin;
- risqet e ndryshimit të kuadrit ligjor të cilat lidhen me rastet kur një ndryshim në ligjin ose në rregullat e përgjithshme ndikon negativisht mbi projektin, të tilla si: ndryshimet në sistemin tatimor, ndryshimet në rregullat që disiplinojnë këmbimin e monedhës, ose ndryshimet në rregullat për riatdhesimin e fitimeve;
- risqet e forcës madhore të cilat lidhen me ngjarjet përtej kontrollit të palëve në kontratë, të tilla si: fatkeqësitë natyrore, luftëra ose trazira civile, që ndikojnë mbi projektin.
- Analiza e ndjeshmërisë

Analiza e ndjeshmërisë paraqet informacionin në një mënyrë që lejon të kuptohet saktësisht se çfarë është duke u supozuar si kusht bazë, dhe se si rezultatet përfundimtare do të ndikoheshin nga ndryshimet në supozime të tilla. Kjo është arritur nëpërmjet kryerjes së testeve të ndryshme të ndjeshmërisë dhe nëpërmjet krahasimit të rezultateve me ato që bazohen në supozime të ndryshme për kushtin



bazë që rezulton në të paktën tri variacione të fizibilitetit, në veçanti kur të ardhurat e projektit nxirren nga përdoruesit.

Në rastet kur si pasojë e vlerësimeve të studimit të fizibilitetit, i hartuar sipas elementëve përbërës dhe metodologjive të mësipërme, arrihet në përfundimin se projekti i shqyrtuar, paraqet leverdi dhe qëndrueshmëri, atëherë komisioni i vlerësimit dhe dhënies së koncesionit/PPP, vijon me procedurën ligjore, sipas përcaktimeve ligjore.

### **c) Vlerësimi i modelit për zbatimin e projektit; PP apo PPP.**

Në rastet kur pas analizave të kryera sipas studimit të fizibilitetit, rezultatet rezultojnë të kënaqshme, komisioni i koncesionit/PPP vijon procedurën.

Hapi tjetër procedural lidhet me vlerësimin nga ana e komisionit, nëse modeli më i përshtatshëm për zbatimin e projektit është forma e realizmit të tij nëpërmjet një procesi prokurimi publik apo një procesi koncesioni/PPP.

Për këtë qëllim komisioni bazohet mbi Krahasuesin e Sektorit Publik, si dhe përdor modele të përshtatshme financiare, të tilla si metodologjia e Krahasuesit Publik Privat ose modeli “Hije”. Krahasuesi i Sektorit Publik kryen përlllogaritjen e vlerës aktuale neto të kostove totale neto të projektit, në rastin kur realizohet nëpërmjet një metode të prokurimit tradicional. Krahasuesi i Sektorit Publik përbëhet nga flukset e mjeteve monetare që lidhen me:

- krahasuesin bazë të sektorit publik, i cili paraqet shpenzimet totale, në të cilat përlllogariten, kostot e drejtpërdrejta të investimeve, kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes, kostot e drejtpërdrejta operative dhe kostot indirekte të projektit, minus vlerën e të ardhurave që mund të mblidhen nga projekti, të përcaktuara në studimin e fizibilitetit sipas rregullave të mësipërme.
- përshtatjen e neutralitetit konkurrues, e cila përfaqëson avantazhin konkurrues neto që i shkon sektorit publik në sajë të statusit të tij; dhe
- përshtatjen e risqeve të projektit, në varësi të alokimit të tij mes partnerit publik dhe privat.

Të gjitha flukset monetare të ardhshme të projektit shndërrohen në një kosto aktuale neto nëpërmjet zbatimit të normës së duhur të skontimit.

Në përgjithësi ndarja e riskut midis palëve bazohet në parimin që pala e cila do të mbajë riskun, është ajo e cila është në pozitën më të mirë, për të përballuar ose për të minimizuar pasojat e tij. Risku ndahet në tre kategori: “risk i mbajtur” është ai që i mbetet autoritetit kontraktues, “risk i transferueshëm” është risku që transferohen tek partneri privat dhe “risk i përbashkët: konsiderohen risqet që do të mbahen nga të dy palët, sipas përcaktimeve për të cilat është rënë dakord në kontratë.

Alokimi i riskut përdoret edhe për të vlerësuar nëse koncesioni/PPP, është klasifikuar si “brenda” ose “jashtë” bilancit të qeverisë në bazë të rregullave të Sistemit

European të Llogarive (ESA95), sipas mënyrës së kombinimit të alokimeve të tri llojeve të mëposhtme të risqeve: risku i ndërtimit, risku i disponueshmërisë dhe risku i kërkesës.

Ky vlerësim i kryer nga ana e komisionit, ka për qëllim që të tregojë nëpërmjet një analize krahasuese, se cila midis dy alternativave për zbatimin e një projekti, pra alternativa e prokurimit publik apo alternativa e koncesioneve/PPP, mundëson realizimin e projektit me vlerën më të mirë të parasë.

Për pasojë, në rastet kur analiza e kryer tregon se zgjidhja e dytë ofron vlerën më të mirë të parasë, autoriteti kontraktues mund të marrë vendimin për të përgatitur procedurën e dhënies së një kontrate me koncesion/PPP. Ndërsa në rastet kur krahasimi midis alternativës së prokurimit publik dhe alternativës së koncesion/PPP-së tregon se zgjidhja e dytë nuk ofron vlerën më të mirë të parasë, atëherë autoriteti kontraktues rishqyrton mundësinë për të realizuar projektin duke përdorur alternativën e prokurimit publik.

Shqyrtimi përfundimtar i të gjitha kërkesave ligjore për zbatimin e projektit bëhet së bashku me një vlerësim të kapacitetit të brendshëm të institucionit zbatues dhe të institucioneve të tjera që ndërmarrin detyra të ndryshme që lidhen me zhvillimin e projektit.

Pasi të ketë përshkruar në mënyrë të detajuar informacionin e mësipërm, si dhe pasi të jenë vlerësuar dhe arsyetuar rezultatet e analizave të mësipërme, në përfundimet e tij studimi i fizibilitetit duhet të përmbillet me përfundimet në lidhje me elementët mëposhtëm:

- përcaktimi i llojit dhe objektit të koncesionit/PPP që do të zbatohet;
- vlerësimet në lidhje me risqet e drejtpërdrejta financiare të projektit dhe ndikimin në buxhetin e qeverisjes qendrore dhe vendore;
- përcaktimin e vlerës së parashikuar të kontratës;
- vlerësimet në lidhje me kriteret që duhet të zbatohen për zgjedhjen dhe dhënien e koncesionit/PPP;
- kohëzgjatjen e propozuar të kontratës;
- informacionet e tjera të nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit të tenderit.

#### **d) Rezultatet e Studimit të Fizibilitetit**

Si përfundim, bazuar në informacionin, analizat dhe veprimet e mësipërme, studimi i fizibilitetit, duhet të jetë një dokument i aftë që të tregojë dhe të arsyetojë nëse;

- projekti është i përshtatshëm, i nevojshëm dhe përmbush kërkesat dhe politikat e autoritetit kontraktues;

- projekti është i realizueshëm, në aspektin e realizueshmërisë teknike, ekonomike, financiare dhe tregtare;
- projekti nuk ka ndikim negativ social dhe mjedisor;
- alternativa përmes së cilës është parashikuar të përfundojë projekti nëpërmjet dhënies së një kontrate me koncesion/PPP është më e dobishme në krahasim me alternativën e dhënies së një kontrate prokurimi publik.

Vetëm në rastet kur, si pasojë e rezultateve të studimit të fizibilitetit vërtetohet se projekti i përmbush të gjitha këto kushte dhe arrihet në një vlerësim pozitiv të tij, atëherë mund të vijohet me procedurën për dhënien e koncesionit/PPP.

Gjithashtu vetëm në rastet kur studimi i fizibilitetit vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, autoritetet kontraktore mund të përcjellin projektin për miratim në Ministrinë e Financave, në rastet kur kërkohet mbështetje financiare, në përputhje me nenin 42 të ligjit 125/2013.

## ANNEX 4

## LISTA E SHKURTIMEVE

PPP	Partneriteti Publik Privat
PP	Prokurim Publik
SPV	Subjekt për Qëllime të Veçanta
AK	Autoritet Kontraktues
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
MF	Ministria e Financës
EU	Bashkimi European
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
Ligji 125/2013	Ligji nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar
VKM 575	Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat”, i ndryshuar



Agjencia e Trajtim të  
Koncesioneve/PPP



bashkëpunimi  
gjerman

DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by

**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

HM&H



Agjencia e Trajtim të Koncesioneve

Adresa: Ministria e Zhvillimit  
Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,  
Blv "Dëshmorët e Kombit" Nr. 2 Tiranë.

tel: 04 2 22 497  
fax: 04 2 23 587

info@atrako.gov.al  
www.atrako.gov.al